

Prill 2017
Numri: 109
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Drëta
e zemrës sonë

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Ai është:

Prijësi ynë.

Udhëzuesi ynë.

Guida e udhës sonë.

Drita e zemrës sonë.

Kandili ynë.

Llamba jonë.

Thirrësi ynë për tek Allahu.

Pastruesi i zemrave tona.

Ai është Muhamedi, sal-lallahu alejhi ue sel-lem...

Të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore.

T'i kapërcejmë të gjitha kushtet në të cilat jetojmë, ta shkëpusim syrin, dorën, këmbën, mendjen dhe shpirtin tonë prej lidhjeve të kësaj bote dhe të përjetojmë e të marrim frymë në të njëjtën atmosferë me të.

Një atmosferë e transferimit të shpirtit.

Një sofër shpirtërore, një ceremoni mallëngjimi dhe takimi.

Lidhja shpirtërore...

Atmosfera e bartjes së bukurive tek vetja.

Po flasim për lidhjen tonë shpirtërore me Rasulullahun (a.s.).

Por, për të thënë "të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore", duhet të kemi një lidhje me të.

Për këtë arsye, ai, duhet të ketë një kuptim të veçantë për ne.

Duhet ta kapim atë përdore.

Duhet të jemi të vetëdijsëm për lidhjen tonë.

Dora jonë duhet të jetë në dorën e tij.

Nuk duhet të shkëputemi, nuk duhet të shkëputemi, nuk duhet të shkëputemi kurrë.

Nuk duhet ta dobësojmë lidhjen tonë shpirtërore dhe nuk duhet të shkojmë drejt rrezikut të shkëputjes.

Por, të mbajmë gjallë lidhjen shpirtërore, është një çështje edukimi shpirtëror.

Gjatë këtij edukimi, zemrat sikur lidhen me zemrën e bekuar të Rasulullahut (a.s.), sikur thithin qumësht prej aty dhe gjejnë një burim kryesor që i ushqen zemrat tona me një udhëtim të plotë të zemrës përtej shekujeve e brezave.

Një njeri i tillë, është i vetëdijsëm për zemrën e tij dhe bart zellin e brumosjes së zemrës. Po ashtu, ai është një njeri që e di shumë mirë se zemra mund të brumoset në mënyrë më të shëndetshme, kur ajo është në një atmosferë ku mbizotëron "përmendja e Allahut".

Prill 2017

VITI: XI

NUMRI: 109

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Ki respekt dhe duro!
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan


16

Përmbajtja




Dashuria ndaj Profetit (a.s.)
dhe besimi i përsosur
Dr. Adem Ergyl

7



Vëllazëria që na mësoi
i Dërguari i Allahut (a.s.)
Xhafer Durmush

11



38



46

Teubeja - Istigfari
si ripërtëritje e ndërgjegjes
Dr. Husein Rizai

- 5 Të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore
Ahmet Tashgetiren
- 9 Pa të është e pamundur
Prof. dr. Sulejman Derin
- 13 Morali shembullor i të Dërguarit të Allahut (a.s.)
Doç. dr. Mehmet Ozshenel
- 18 Ali Ëztajllan Efendiu, pastičieri nga Bandërmaja
Prof. dr. Nexhdet Tosun
- 21 Parime jetike nga Pejgamberi (a.s.)
M. Sami Ramazanollu
- 22 Disa mrekulli të Profetit (a.s.)
Dr. Murat Kaja
- 24 Shembja e Bizantit
Dr. Ardian Muhaj



54

- Big Bangu i Dijes 27
Makro Univers
- Lindje normale apo me operacion? 29
Mikro Univers
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32
- Përgëzimi i Isait (a.s.) 34
Osman Nuri Topbash
- El - Muhejmin 38
Ilir Hoxha
- A ka Europa një problem inkuzicioni? 40
Hatem Bazian
- Muhamed Hamidullah 42
Personalitete botërore Islame
- Kujtesë për kujtesën 44
Edison Çeraj
- Urtësi 45



Tre gabime
Neslihan Nur Turk

50



Universet paralele dhe teoria e fijeve
Elsad Cukali

57



Të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore

— *Ahmet Tashgetiren* —

Ai është:

Rasulullahu.

I Dërguari i Allahut.

Profeti.

Bartësi i mesazhit të shenjtë.

Zotëria ynë.

Vija e horizontit të jetës sonë. Ai, gjurmët e të cilit ndjekim dhe, sa herë që i afrohemi, vendos përpara nesh horizonte të reja njerëzore.

Ai është:

Prijësi ynë.

Udhëzuesi ynë.

Guida e udhës sonë.

Drita e zemrës sonë.

Kandili ynë.

Llamba jonë.

Thirrësi ynë për tek Allahu.

Pastruesi i zemrave tona.

Ai është Muhamedi, sal-lallahu alejhi ue sellem...

Të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore.

T'i kapërcejmë të gjitha kushtet në të cilat jetojmë, ta shkëpusim syrin, dorën, këmbën, mendjen dhe shpirtin tonë prej lidhjeve të kësaj bote dhe të përjetojmë e të marrim frymë në të njëjtën atmosferë me të.

Një atmosferë e transferimit të shpirtit.

Një sofër shpirtërore, një ceremoni mallëngjimi dhe takimi.

Lidhja shpirtërore...

Atmosfera e bartjes së bukurive tek vetja.

Po flasim për lidhjen tonë shpirtërore me Rasulullahun (a.s.).

Por, për të thënë “të mos na shkëputen lidhjet shpirtërore”, duhet të kemi një lidhje me të.

Për këtë arsye, ai, duhet të ketë një kuptim të veçantë për ne.

Duhet ta kapim atë përdore.

Duhet të jemi të vetëdijshëm për lidhjen tonë.

Dora jonë duhet të jetë në dorën e tij.

Përgjigja e prerë e pyetjes “Çfarë është Rasulullahu për ne?”, duhet të jetë “udhëzuesi i jetës sonë”.

Më pas, lidhja jonë duhet të jetë shpirtërore.

Pra, jo një lidhje mekanike.

Të jetë sikur të ndjejmë përbrenda nesh pompimin e gjakut prej zemrës sonë drejt damarëve dhe si një eliksir jete që arrin deri në caqet më të vetmuara të jetës sonë... si një qenie që konsiderohet më e shenjtë se shpirti.

Po ashtu, duhet të bartim edhe shqetësimin e shkëputjes.

Pra, duhet të pajisemi me një kujdes të veçantë sikur jemi duke kaluar midis një vendi të egër, duke i kapërcyer rreziqet e gjynahëve të krijuara prej shejtanëve të njerëzve dhe të xhindëve, duke ngritur perdet e syve dhe të zemrave tona, duke i pastruar veshët tanë nga papastërtitë, me qëllim që të dëgjojmë qartë zërat që do të vijnë prej atij (profetit), duke u kujdesur për pastërtinë e duarve tona, që të jenë të pastra kur ta mbajnë atë përdore, duke i këputur prangat që na pengojnë për të shkuar tek ai dhe duke qenë të vetëdijshëm për kurthet, me qëllim që të mos rrëzohemi në rrugën drejt tij... Me një dridhje zemre të tillë, “po sikur të rrëzohem”, “po sikur të ngelemi në rrugë”, “po sikur çdo pjesë e jona të përplasen në një vend në këtë xhungël shejtanësh që kaplon sipërfaqen e tokës”. Pra, me një shqetësim që na djeg përbrenda nga frika, duke e konsideruar shkëputjen prej tij sikur të na shkëputeshin damarët jetikë...

Duhet t’i shtrëngojmë më shumë duart e tij. Zemrat tona duhet t’i lidhim me lidhje edhe më të forta.

Nuk duhet të shkëputemi, nuk duhet të shkëputemi, nuk duhet të shkëputemi kurrë.

Nuk duhet ta dobësojmë lidhjen tonë shpirtërore

dhe nuk duhet të shkojmë drejt rrezikut të shkëputjes.

Por, të mbajmë gjallë lidhjen shpirtërore, është një çështje edukimi shpirtëror.

Pikësëpari, duhet të kemi sukses në këtë çështje.

Duhet të jemi në një shkollë të tillë shpirtërore.

Në këtë edukim shpirtëror, duhet të jesh gjithmonë me një njeri të mirë, një të sinqertë, një besnik ose një të dashuruar pas Profetit... duhet të jesh pranë tyre, në të njëjtin rreth, në të njëjtën atmosferë dhe në të njëjtën sofër të zemrës...

Gjatë këtij edukimi, zemrat sikur lidhen me zemrën e bekuar të Rasulullahun (a.s.), sikur thithin qumësht prej aty dhe gjejnë një burim kryesor që i ushqen zemrat tona me një udhëtim të plotë të zemrës përtej shekujve e brezave.

Një njeri i tillë, është i vetëdijshëm për zemrën e tij dhe bart zellin e brumosjes së zemrës. Po ashtu, ai është një njeri që e di shumë mirë se zemra mund të brumoset në mënyrë më të shëndetshme, kur ajo është në një atmosferë ku mbizotëron “përmendja e Allahut”.

Një njeri i tillë, e konsideron si dritë dhe nuk e mbanë kurrë larg syve Muhamed Mustafanë (a.s.), të cilin Allahu i madhëruar e vuri para të gjithëve dhe çdo gjëje, si shembullin më të bukur dhe prijësin e mëshirës. Po ashtu, ai përpiket të mos e ndajë prej tij syrin dhe zemrën e vet, duke u kujdesur të mos i humbë gjurmët e tij, të mos hutohet dhe të mos ndjekë gjurmë të tjera.

Pas gjithë këtyre, i vjen radha të shohim lidhjen tonë shpirtërore. A janë të forta lidhjet me Rasulullahun? A janë në harmoni lidhjet tona të ndryshme në krahasim me lidhjen tonë me të?


Si thoni, nëse e krahasojmë veten me brezin e parë të Islamit, që edukoi Profeti (a.s.) dhe që bartte më tepër bukuri prej karakterit të tij të bekuar? Për shembull, sa jemi të njëjtë apo të ndryshëm me Ebu Bekrin (r.a.)? Si thoni, sa prej gjurmëve të Rasulullahun (a.s.), ndodhen tek ne?

“Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre!..” (Enfal, 33)

Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur ta mbajmë gjithmonë të gjallë lidhjen me të Dërguarin e Allahut (a.s.), e duke na përfshirë në mëshirën e pafund të Tij, ta kalojmë me sukses sprovën e kësaj bote!

Amin!..

Si thoni, nëse e krahasojmë veten me brezin e parë të Islamit, që edukoi Profeti (a.s.) dhe që bartte më tepër bukuri prej karakterit të tij të bekuar? Si thoni, sa prej gjurmëve të Rasulullahun (a.s.), ndodhen tek ne?





Dashuria ndaj Profetit **DHE BESIMI I PËRSOSUR**

Dr. Adem Ergyl

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Nëse dikush prej jush nuk më do më shumë se veten e tij, prindërit, familjen dhe të gjithë njerëzit, nuk ka besuar ashtu siç duhet!..” (Buhari, Iman, 8.)

Si duhet ta kuptojmë kërkesën: *“Duhet të më doni më shumë se gjithçka që ken!”*, të një profeti i cili ka pasur si parim të mos kërkojë asgjë për veten e tij? A mund të jetë kjo kërkesë në emër të vetes së tij? Për çfarë shkak mund të jetë shfaqur një dëshirë e tillë tek i dashuri i Allahut, i cili ka qenë maja e ndershmërisë dhe përvulësisë? Cila mund të jetë urtësia e një thënieje të tillë të Profetit Fisnik, i cili ka bërë një jetë në botëkuptimin “mua më mjafton Allahu”? Çfarë lidhjeje ka midis të qenit “besimtar i përsosur” dhe “dashurisë ndaj Profetit”? Ja pra, kuptimi i kësaj të fshehte do t’u hapë horizonte të gjera atyre që bartin dëshirën dhe vullnetin për t’u bërë “besimtarë të përsosur”.

Zgjidhja e këtij misteri është e fshehur në konceptin e “dashurisë”. Nëse kjo kuptohet saktë, do

të bëhet e qartë se kërkesa e Profetit tonë (a.s.), për dashuri, nuk është për veten e tij, por për umetin dhe miqtë e tij. Pra, për ne dhe në favorin tonë.

Dashuria është një kanal transmetimi i ndërtuar midis dy esencave. Në këtë kanal rrjedh dija, kultura, morali, ndjenja dhe mendimi. Me një fjalë, i gjithë personaliteti. Shumë kuptime të gjera, të cilat janë të pamundura të derdhen në kallëpet e shprehjeve, barten në sajë të kësaj rrjedhe dashurie. Kjo është gjuha e të kuptuarit pa fjalë. Afërsia dhe uniteti i shpirtave mund të arrihet vetëm në sajë të këtij eliksiri. Ja pra, misteri i kësaj dashurie, është e fshehta që i afron dy qenie me njëra-tjetrën, i bashkon dhe madje i bën një trup të vetëm.

Fjalët/hadithet e bekuara të Profetit tonë (a.s.), për ne janë dije, tabelë orientuese dhe udhëzuese të rrugës së drejtë. Po të mos ishin ato, ne nuk do të kishim mundësi ta kuptonim ashtu siç duhet fjalën e Zotit tonë, Kuranin Fisnik. Si fillim, Allahu i Madhëruar kërkoi prej nesh të dëgjonim me vëmendje

të madhe fjalët e Profetit (a.s.), sepse ai nuk fliste sipas dëshirës dhe tekave të veta. Fjalët e tij ishin produkt i shpalljes hyjnore. Ne duhet t'i dëgjonim me gjithë qenien tonë fjalët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sepse dija ishte e rëndësishme. Asgjë nuk mund të ndërtohej mbi injorancën. Robërit fatlumë, pra besimtarët, iu përgjigjën me gjithë shpirt urdhrat të Allahut. Mendjet u ndriçuan, e vërteta dhe e kota dolën në shesh, errësirat u shpërndanë me këtë dritë të dijes dhe u duk qartë rruga e drejtë ku duhej kaluar.

Allahu i Madhëruar kërkoi edhe diçka tjetër prej robërve të Tij besimtarë: *“Ndiqeni Profetin, shkoni pas gjurmëve të tij, zbatojini urdhrat e tij dhe mos u largoni prej tij”*. Pa udhëzues nuk mund të ecej. Pa ndjekur liderin, nuk mund të kishte harmoni. Nëse shoqëria mbetet pa prijës, anarkia dhe kaosi ishin të pashmangshme. Mirëpo, Allahu i Madhëruar dëshironte një rregull dhe disiplinë mbi tokë. Atëherë, të dërguarit duhej të ishin persona, të cilëve u binden njerëzit. Vetëm në këtë mënyrë mund të mbizotëronte mëshira dhe drejtësia në tokë. Pa u rregulluar marrëdhëniet, pa u vendosur drejtësia, pa u treguar se çfarë do të bëhej, nuk mund të ndërtohej një shoqëri e qetë. Pra, edhe bindja që Allahu i Madhëruar priste prej besimtarëve, u pranua dhe u zbatua me përpikëri nga ata, gjë e cila lindi edhe shoqërinë e epokës së lumturisë dhe u hodhën themelet e një civilizimi të pashoq.

Krijuesi ynë i Madhëruar, përtej bindjes ndaj Profetit të tyre, kërkoi edhe diçka tjetër prej robërve të Tij besimtarë: *“Të pajisen me moralin e tij, ta marrin shembull jetën e tij dhe t'i afrohen devotshmërisë së tij”*. Dhe kjo e fundit ishte më e vështira. Mirëpo, pa u realizuar kjo, nuk ishte e mundur një besimtar i tillë. E si do të realizohej kjo? Përçimi i fjalëve nuk ishte si përçimi i gjendjes, formimi i moralit dhe përngjasimi i ndjenjave. Ndërmjet “të dish” dhe “të bëhesh”, ishte një rrugë e gjatë që duhej përshkuar. Në fakt, ajo që kërkohet, ishte bartja e qelizave të personalitetit të Profetit (a.s.), në shpirtin dhe në veten tonë, sipas mundësive personale të çdokujt. Ja

pra, këtu duhej të kishte një mjet tjetër të veçantë. Ashtu siç kishte nevojë të shihje e të dëgjoje për të marrë dije, t'u bindeshe urdhrave të tij dhe ta mbaje përdore për të ecur në rrugën e tij, ashtu kishte nevojë ta doje me gjithë shpirt për t'i përngjarë atij. Ja pra, mënyra e ngjitjes në shkallën e tretë, ishte një zemër e mbushur me dashuri.

Po, me të duhet të lidhesh me një zemër të mbushur me dashuri. Kjo, sepse ndjenja e devotshmërisë në zemrën e tij, vetëdija e përgjegjesisë, respekti, njohja, dashuria, frika, përmendja e Allahut dhe shumë më ndjenja të tjera të tij, mund të kopjohen brenda kufijve të kapacitetit tonë dhe të përçohen në personalitetin tonë vetëm në sajë të lidhjes së dashurisë.

Po ashtu, edhe moralin e tij të lartë, pra, modestinë, butësinë, mëshirën, dhembshurinë, durimin, qëndresën, zemërgjerësinë, mënyrën e botëkuptimit të jetës dhe të gjithë fushën e tij shpirtërore mund ta transferojmë në personalitetin tonë, vetëm në sajë të lidhjes së dashurisë.

Ja pra, pa arritur në këtë nivel cilësia e lidhjes sonë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), është e pamundur të arrish përsosmërinë e besimit, Islamit dhe mirësisë. E shprehur ndryshe, të bëhesh “besimtar i përsosur”. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), ka thënë se:

“Nëse dikush prej jush nuk më do më shumë se veten e tij, prindërit, familjen dhe të gjithë njerëzit, nuk ka besuar ashtu siç duhet!..”

Shkurtimisht, kërkesa për dashuri e Profetit tonë të dashur (a.s.), i cili ndodhej në majat më të larta njerëzore të ndjenjave të turpërimit, nderit dhe modestisë, nuk ishte kurrsesi për veten e tij, por për ne, umetin e tij.

I lutemi Allahut të Madhëruar, të na pajisë me dashuri ndaj të Dashurit të Tij, në përputhje me kënaqësinë e Tij. Selamet dhe salavatet qofshin për të, familjen dhe sahabët e tij fisnikë.



Moralin e tij të lartë, pra, modestinë, butësinë, mëshirën, dhembshurinë, durimin, qëndresën, zemërgjerësinë, mënyrën e botëkuptimit të jetës dhe të gjithë fushën e tij shpirtërore mund ta transferojmë në personalitetin tonë, vetëm në sajë të lidhjes së dashurisë.



PA TË ËSHTË E PAMUNDUR

Prof. dr. Sulejman Derin

Profeti (a.s.), është “shembulli më i bukur” për ne në çdo çështje. Për këtë arsye, një botëkuptim i shëndetshëm shpirtëror është i mundur vetëm kur ai është në përputhje me Sunetin e tij. Sipas sufive/mistikëve, çolloj botëkuptimi shpirtëror që nuk përputhet me Librin Madhështor që solli Profeti (a.s.) dhe Sunetin e tij, është një lodhje e kotë. Kriteri që kërkohet tek ata që pretendojnë se mund të udhëzojnë njerëzit, nuk është kerameti, ashtu siç pandehet nga shumica, por është rruga e drejtë në vijën e Sunetit të Profetit (a.s.). Një nga të mëdhenjtë e sufive, i nderuari Bejazid-i Bistami, shprehet në këtë mënyrë:

Kur dikush i tha, “filani ecën mbi ujë e fluturon në ajër”, Bejazid Bistami, tha se, “edhe peshqit notojnë në ujë, edhe zogjtë fluturojnë në ajër”. Më pas e këshilloi kështu: “Edhe nëse dikush shtron sixhaden mbi ujë apo ulet këmbëkryq në ajër, mos u mashtroni prej tij pa e parë atë të ecë në vijën e urdhrave dhe ndalesave të Allahut!”¹

Ndërsa një sufi tjetër i famshëm, Xhunejd el-Bagdadi, lidhur me këtë çështje thotë: “Të gjitha rrugët që të çojnë tek i Vërteti, janë të mbyllura për njerëzit, përveç atyre që kapen pas Sunetit të Profetit (a.s.) dhe e ndjekin atë.” Sipas Xhunejdit, rruga e tasavufit është e kufizuar nga parimet e Kuranit dhe Sunetit. Nëse shihet me kujdes tek disa prej zbatime-

ve që i bëjnë sufistët të duken ndryshe, do të shihet se ato janë marrë nga Kurani dhe Suneti.

Nëse i mbledhim thëniet e sufive në lidhje me besnikërinë e tyre ndaj Sunetit, mund të bëhen libra të tërë me vëllime. Kjo, sepse sipas sufive, tasavuf, do të thotë të jetosh jetën shpirtërore të Profetit (a.s.) dhe të mbledhësh në vetvete devotshmërinë, dashurinë, pasionin, mbështetjen tek Allahu, shkurtimisht, çdo gjendje të tij shpirtërore. Përndryshe, ashtu siç kujtojnë disa, tasavufi nuk është një shpikje filozofike që nuk ka bazë pjesë në jetën e Profetit (a.s.). Të mëdhenjtë e nakshibendive janë treguar gjithmonë vigilentë në këtë çështje dhe janë kujdesur që asnjë zbatim të mos e vënë para të Dërguarit të Allahut (a.s.). I nderuari Imam Rabbani, në komentin e ajetit fisnik: “...**më ndiqni mua, që do t’ju dojë Allahu!**...”², shprehet:

“Të përpiqesh në ndjekjen e rrugës së Profetit (a.s.), bëhet shkak i arritjes së pozitës së dashurisë. Të gjithë ata që kanë mendje dhe logjikë të shëndoshë, duhet ta ndjekin Profetin (a.s.), hapur dhe fshehtas në mënyrë absolute.” (I. Letra e 41.)

Po sipas Imam Rabbanit, pastrimi i zemrës prej papastërtive shpirtërore, arrihet vetëm nëse ndiqet me përpikëri Suneti i Profetit (a.s.). Lidhur me këtë, ai shprehet:

“Nëse njeriu është prekur nga papastërtitë e lidhjeve

1. Serrâc Tusi, Luma, trc. H. Kamil yılmaz, s.379.

2. Al-i Imran, 31.

të ndryshme të kësaj bote, ai është larg të Vërtetit. Për të arritur të vërtetën absolute, është e domosdoshme të pastrohet zemra prej ndryshkut të materies dhe ta shndrisësh atë. Dhe, ndriçimi më i mirë për ta larguar këtë ndryshk, është të ndjekësh Sunetin e Profetit (a.s.). Ndërsa ndjekja e tij, arrihet duke braktisur zakonet e errëta të egos.” (Letra e 42.)

Sipas Imam Rabbanit, kompetentët e tasavufit, në vend që të kërkojnë rrugë shpirtërore sipas dëshirave të veta, duhet të përipiqen të ndjekin me përpikëri Sunetet e Profetit (a.s.). Në një vend ku janë braktisur sunetet, adhurimet vullnetare nuk kanë asnjë vlerë:

“Të flesh gjithë natën dhe të falësh dy rekatët e nama-zit të sabahut me xhemat, që do të thotë të plotësosh një nga sunetet, është më mirë sesa të falësh gjithë natën namaze vullnetare dhe të falësh namazin e sabahut i vetëm.” (Letra 52.)

Në shumë prej letrave të tij, Imam Rabbani lutet që nxënësit e tij të lidhen plotësisht pas Sunetit të Profetit (a.s.) dhe shprehet me shembuj se, edhe detyra e mësuesve është t’i lidhin nxënësit e tyre me Profetin (a.s.):

“Allahu i Madhëruar, na nderoftë neve, robërit e Tij të humbur e të dobët, me ndjekjen e Profetit të të parëve tanë dhe mëvonshmëve dhe na e bëftë të mundur të qëndrojmë gjithë në këtë rrugë... Një grimcë e kësaj lidhjeje që e kënaq Allahun, është më e mirë sesa të gjitha kënaqësitë e kësaj bote dhe mirësitë e botës tjetër. Virtyti është i varur prej ndjekjes së Sunetit të tij (a.s.) dhe merita prej zbatimit të ligjit të tij.” (Letra e 114.)

Sipas Imam Rabbanit, edhe një punë e vogël e kësaj bote që bëhet sipas Sunetit të Profetit (a.s.), është shumë më e mirë sesa një adhurim vullnetar që bëhet pa u kujdesur për këtë çështje:

“Për shembull, gjumi i drekës që bëhet për hir të Sunetit të Profetit (a.s.), është më i mirë sesa mijëra net adhurimi vullnetar që nuk bëhen për këtë shkak. Po në të njëjtën mënyrë, mos mbajtja e agjërimit në ditën e Bajramit të Ramazanit, që buron nga ligji Islam, është shumë më i mirë sesa agjërimi i një jete të tërë e cila nuk buron prej ligjit. Dhurimi i një qindarke si urdhër i ligjit Islam, është shumë më e vlefshme sesa dhurimi i një mali me flori në kokë të vet.”

Në mënyrë të veçantë, Imam Rabbani, në këtë le-tër trajton edhe çështjen e disa zbatimeve mistike të atyre që pretendojnë se janë sufi, por që nuk e ndjekin Sunetin e Profetit (a.s.). Ai shprehet qartë se, këto zbatime jashtë ligjit të Allahut dhe Sunetit të Profetit (a.s.), nuk kanë asnjë vlerë tek Allahu i Madhëruar:

“Zbatimet e tepruara mistike të disa njerëzve të devijuar nuk kanë asnjë vlerë, sepse ata nuk sillen në përputhje me ligjet islame. Nëse ata do të kenë ndonjë shpërblim për punët e tyre të vështira, kjo do të jetë e kufizuar thjesht me disa mirësi të kësaj bote. E sa është vlera e gjithë botës, që të ketë vlerë një pjesë e saj? Gjendja e tyre është si ajo e plehra-xhinjëve, të cilët, edhe pse punojnë më tepër se të gjithë, paguhen më pak se të gjithë.

Ndërsa gjendja e atyre që punojnë në bazë të li-gjeve Islame, është si ajo e mjeshtërave që punojnë mbi diamantet e bukur dhe xhevahiret e çmueshme. Ata punojnë pak, por fitojnë shumë. Aq sa, një orë e punës së tyre, është e barabartë me një shpërblim njëqindmijësh. Sekret i kësaj, është se, nëse vepra është në përputhje me ligjin e Allahut, është një vepër me të cilën Allahu kënaqet. Ndërsa puna që nuk përputhet me ligjin e Allahut, është një vepër me të cilën Allahu nuk kënaqet. Pra, një vepër për të cilën Allahu nuk është i kënaqur, nuk të sjell shpërblime, por përkundrazi sjell dënimin e Allahut. Dëshmia e këtij fakti ekziston edhe në këtë botë metaforike dhe me shumë pak kujdes, del lehtë në pah.

I nderuari Bejazid-i Bistami, ka kërkuar përputh-shmërinë me jetën e Profetit (a.s.), edhe në duatë që do t’i bëhen Allahut, duke thënë: “Njëherë, mendova t’i kërkoja Allahut të më shpëtonte nga vështirësia në çështjen e ushqimit dhe gruas. Mirëpo më pas hoqa dorë. E si mund të kërkoja diçka të tillë, të cilën Profeti i Allahut (a.s.), nuk e kishte bërë! Kështu që edhe unë hoqa dorë nga një kërkesë e tillë.” (Serraxh Tusi, Luma, fq. 115.)

Si përfundim, udhëzuesi i vërtetë sufive, është Profeti i Allahut (a.s.) dhe Suneti i tij. Dijetarët që kanë ardhur pas tij, si trashëgimtarë të profetëve, kanë pasur si qëllim kryesor një jetë shpirtërore në vijën e Sunetit të tij. Ata që janë shfaqur në emër të shpirtërores, duke lënë mënjanë Profetin (a.s.) dhe trashëgiminë e tij profetike, devijojnë nga rruga e drejtë edhe veten e tyre por edhe të tjerët përreth. Për rrjedhojë, kohët e fundit kanë dalë disa persona me qëllim të shërbimit ndaj Islamit, por të cilët kanë pësuar fund të hidhur për shkak se kanë braktisur Sunetin e Profetit (a.s.).

I lutemi Allahut të Madhëruar, të mos na ndajë kurrë nga Suneti i Profetit (a.s.), në rrugën drejt të Vërtetit.

Le ta mbyllim letrën tonë me këtë lutje të Imam Rabbanit:

“Kapitali i të gjitha lumturive, është ndjekja e Sunetit. Ndërsa thelbi i të gjitha të këqijave, është kundërshtimi i ligjeve të Allahut. Allahu i Madhëruar na bëftë ndjekës të rrugës së Profetit (a.s.).” (letra e 114.)

Vëllazëria që na mësoi i Dërguari i Allahut (a.s.).

Në suren Huxhurat, urdhërohet:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllazër, andaj pajtojini vëllazërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Siç theksohet edhe në ajetin e mësipërm, besimi është lidhja më e rëndësishme që i bën vëllazër të gjithë besimtarët. “Kuadri i vëllazërisë” që përmendet këtu, është i çliruar nga çdo lloj kufizimi që mund të vijë në mend. Vëllazëria fetare është më superiore se vëllazëria e gjakut. Kjo, sepse nëse vëllazëria e gjakut zbehet prej dallimeve fetare, vëllazëria fetare nuk zbehet prej dallimeve të gjakut. Nisur nga kjo, kur dy individë apo dy grupe besimtarësh prishen, është urdhëruar që ata të pajtohen menjëherë.

Kornizën e përgjithshme që është përcaktuar në ajetin fisnik, e shpjegon Profeti (a.s.). Ai na bën të ditur se cilat sjellje dhe në ç’masë i japin formë vëllazërisë fetare, na mëson se çfarë duhet të kemi kujdes për ruajtjen dhe zhvillimin e atmosferës së vëllazërisë dhe po ashtu, na tërheq vërejtjen edhe ndaj gjërave që e cenojnë vëllazërinë, duke thënë:

“Besimtarët i ngajjnë trupit në dashurinë, në dhembshurinë dhe në mbrojtjen ndaj njëri-tjetrit. Kur sëmuret një organ i trupit, edhe pjesët e tjera të trupit mbeten pa gjumë dhe i kap temperatura.” (Buhari, Edeb, 27.)

“Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk i bën padrejtësi atij dhe nuk e dorëzon tek armiku. Plotësojini

nevojat e vëllait të fesë, që edhe Allahu t’jua plotësojë juve nevojën. Largojeni një vështirësi nga myslimani, që edhe Allahu t’ju largojë një prej vështirësive në Ditën e Kiametit. Mbuloni të metën e një myslimani, që edhe Allahu t’ju mbulojë të metat tuaja në Ditën e Kiametit.” (Buhari, Mezalim, 3)

“Mos e smironi njëri-tjetrin. Mos i shkaktoni dëm njëri-tjetrit nga tregtia e pandershme. Mos e urreni njeri-tjetrin. Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Mos u fusni në pazar ndërkohë që dikush tjetër është duke bërë pazar (për të njëjtin mall). O robërit e Allahut, bëhuni vëllazër! Myslimani është vëllai i myslimanit, nuk i bën padrejtësi atij, nuk e lë pa ndihmë dhe nuk e përçmon. (Duke bërë tri herë me shenjë kraharorin, tha): ‘Devotshmëria është këtu. Njeriut i mjafton si vepër e keqe përçmimi i vëllait të tij mysliman. Çdo mysliman e ka haram gjakun, pasurinë dhe nderin e myslimanit tjetër.” (Muslim, Birr, 32)

Ndërsa Imam Gazaliu i ndan në tetë pika të drejtat vëllazërore dhe thotë:

E drejta e parë është në pasuri. Dy vëllazër duhet të jenë si dy duart që lajnë njëra-tjetrën kur bëhet fjalë për plotësimin e nevojave të njëri-tjetrit. Vetëm nëse bashkohen me këtë qëllim, vëllazëria e besimtarëve mund të jetë e plotë. Dhe kjo e bën të domosdoshme që të bëhen ortakë në kamje dhe në skamje, në vështirësi dhe rehati. Madje, vëllai i fesë

duhet të vendoset para vetvetes.

E drejta e dytë është kur e sheh vëllain që ka nevojë për ndihmë, t'i shkojë në ndihmë pa pritur që ta kërkojë ai, duke shtyrë edhe punët e veta për më vonë.

E drejta e tretë është në gjuhë. Ndonjëherë, vëllai duhet të heshtë në lidhje me vëllain e vet e ndonjëherë duhet të flasë. Kjo nënkupton që ai të bëjë sikur nuk i sheh të metat e tij, si në prani ashtu edhe në mungesë të tij dhe të mos flasë fare për to. Të ruhet nga kërkimi i nënkuptimeve gjatë një debati. Kur ta shohë në rrugë, të mos e pyesë se nga vjen e ku po shkon, sepse mbase nuk dëshiron të flasë dhe detyrohet të gënjejë. Të mos nxjerrë sekretet e askujt.

E drejta e katërt është në lidhje me të folurën. Vëllazëria kërkon përdorimin e fjalëve të mira, ashtu siç nuk i pranon fjalët e këqija. Të flasësh fjalë që e shtojnë dashurinë, është një nga veçoritë e vëllazërisë. Kuptimi i vëllazërisë, është të ndash gëzimin dhe harenë, dhimbjen dhe hidhërimin.

E drejta e pestë është në lidhje me faljen e disa gabimeve të vëllait. Gabimet e mikut, bëhen ose kundrejt fesë, ose kundrejt vëllazërisë. Nëse vëllai këmbëngul në gabime dhe gjynahe, ai duhet këshilluar në atë mënyrë që t'ia drejtojë të shtrembërën dhe t'ia korrigjojë gabimin.

E drejta e gjashtë është lutja e mirë për vëllain dhe familjen e tij, si gjatë jetës ashtu edhe pas saj. Ai nuk duhet të bëjë dallim midis vetes dhe atij, sepse lutja e myslimanit për vëllain e tij, në të vërtetë është si lutje për vetveten.

E drejta e shtatë është besnikëria dhe sinqeriteti. Besnikëria kërkon vazhdimin e dashurisë dhe miqësisë derisa të vijë vdekja dhe pas vdekjes të vizitohet shpesh familja e tij. Në fakt, dashuria duhet të zgjatë edhe në botën tjetër. Nëse miqësia mbaron pa ardhur vdekja, përpjekjet e bëra do të shkojnë dëm. Për rrjedhojë, edhe Profeti ynë (a.s.), kur po numëronte shtatë grupet që do të strehohen në hijen e arshit të Allahut, përmendi edhe "ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe që bashkohen e ndahen po për hir të Tij".

E drejta e tetë është të mos i bëhesh barrë vëllait dhe të mos i bësh kërkesa të panevojshme. Madje, me aq sa është mundësia, t'i fshehësh nevojat personale prej tij. Të mos kërkojë prej tij pasuri dhe pozitë. (Ihju Ullumi'd-Din, V. 2, fq. 431-467.)

Si përfundim, mund të themi se kemi shumë nevojë për ringjalljen e të vërtetës që theksohet në Kuran, se "**të gjithë besimtarët janë vëllezër**". Kemi nevojë t'i vëmë në jetë përsëri të drejtat e vëllazërisë që theksohen në hadithet e Profetit (a.s.). Kemi nevojë të flasim përsëri për edukatën vëllazërore që kanë formuluar dijetarët, të cilët janë edhe trashëguesit e profetëve. Bota ka nevojë për Islamin dhe Islami ka nevojë për besimtarë "prej dorës dhe gjuhës së të cilëve janë të sigurt myslimanët"¹

1. -shih. Buhari, Iman, 4-5.

ÇELËSI I TË GJITHA MIRËSIVE

Në suren Dharijat, gjendet një lajm që përçon shpresë në zemrat besimtare: "**Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime, duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre...**" (Dharijat, 15-16.) Ndërsa në ajetet në vijim, jepen veçoritë e atyre që e meritojnë këtë sihariq të madh: "**...(të cilët) më parë kanë qenë punëmbarë, flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).**" (Dharijat, 16-18.) Gjithashtu edhe në ajete të tjera si këto, Zoti ynë i Madhëruar i fton besimtarët në adhurimin e natës dhe në kërkimin e faljes. (shih. Sexhde, 16; Isra, 79.)

Ndërsa Profeti (a.s.), ftesën për adhurimin e natës, e përforcon me fjalët e tij: "**O njerëz! Jepini selam njëri-tjetrit, ushqeni të tjerët dhe falni namaz natën kur të tjerët flen!** Nëse veproni kështu, do të hyni në Xhenet." (Tirmidhi, Et'ime, 45.) Po ashtu, atyre që e pyesnin se përse bënte adhurime derisa i enjteshin këmbët, megjithëse i ishin falur gjynahet e shkua-ra dhe të ardhme, Profeti ynë (a.s.), u përgjigjej: "**A të mos bëhem një rob falënderues?**" (Buhari, Tefsiru Sure, 48.) Ai i nxiste shokët e tij për namazin e natës, duke i thirrur emër për emër dhe thoshte: "**Mos u bëni si filani që nuk e vazhdon namazin e natës!**" (Buhari, Te-hexhxhud, 19.)

Pra, siç lajmërohemi prej ajeteve dhe haditheve fisnike, rruga që shkon në krye të burimeve të Xhenetit, hapet me ata që qëndrojnë zgjuar natën para agimit dhe ata që janë bujarë gjatë ditës.

Përgëzuar qofshin ata që bartin dritë prej netëve dhe ata që mbledhin mirësi që në këtë botë për botën tjetër!





Morali shembullor I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Doç. dr. Mehmet Ozshenel

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!”¹

Profeti (a.s.), i cili u dërgua si përgëzues dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin², kishte moral të lartë. Siç shprehet edhe nëna jonë Aishe (r.anha), morali i tij ishte Kurani.³

Morali i tij ishte i lartë, sepse ai ishte dërguar si mëshirë për botët.⁴ Dhe i lartë duhej të ishte morali i një Profeti që ishte dërguar si mëshirë për botët.

Morali i tij ishte i lartë, sepse Profetin që ishte dërguar si mëshirë për botët, e kishte edukuar Zoti i botëve. Në një hadith fisnik, Profeti (a.s.), ka thënë: *“Mua më ka edukuar Zoti im dhe, edukatën time e ka bërë shumë të bukur.”*⁵

Morali i tij ishte i lartë, sepse shpallësi i Islamit⁶, i cili ishte edhe hallka e fundit e zinxhirit të profetëve⁷, duhej të zotëronte një moral të lartë. Ndërsa Islami, është maja e teuhidit dhe e vetmja fe e pranuar tek Allahu.

Morali i tij ishte i lartë, sepse, nëse nuk do të ishte kështu, Islami, feja e fundit dhe më e përsosura tek Allahu, nuk do të ishte plotësuar. Allahu i Madhëruar ka urdhëruar: *“...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj!..”*⁸ Pra edhe Profeti i një feje të përsosur du-

hej të ishte i përsosur. Për këtë arsye, Allahu e kishte pajisur atë me virtytet më të bukura morale. A nuk ka thënë edhe vetë Profeti (a.s.), se: *“Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e bukur!”*⁹

Morali i tij ishte i lartë, sepse sa të ishte gjallë do të edukonte sahabët dhe pas vdekjes së tij do të ishte shembulli më i bukur për besimtarët.¹⁰

Profeti (a.s.), me mëshirën e tij shembullore, u mundua shumë për të ligjëruar fenë e Allahut. Ai u tregua shumë i duruar, delikat dhe tolerant në këtë mision, sepse e rëndësishme nuk është të humbësh njerëzit, por t'i fitosh ata. Ashtu siç është shprehur edhe vetë, ai përpiqej të shpëtonte fluturat që fluturonin drejt zjarrit.¹¹ Dhe në këtë mision punonte shumë dhe tregojë i durueshëm e delikat me aq sa mundej. Lidhur me këtë edhe Edukuesi i tij Madhështor, urdhëron kështu në Kuran: *“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje...”*¹²

Profeti (a.s.), bënte gjithçka që kishte mundësi për të fituar zemrën e njerëzve. Mirëpo, ai mbante qëndrimin e duhur atëherë kur shkeleshin ndalesat dhe urdhrat e Allahut, sepse kriteret e tij ishin *“el-Hubbu fi'l-lah ue'l-buzu fi'l-lah”*, pra, “të duash dhe të urresh për hir të Allahut”¹³ Nëna jonë Aishe (r.anha.), karakterin e

lartë të Profetit (a.s.), e përmbledh me këto fjalë: “Kur Rasulullahu i duhej të zgjidhte midis dy mundësive, ai zgjidhte më të lehtë nëse ajo nuk ishte gjynah. Por, nëse ishte gjynah, ai ishte njeriu që i qëndronte më larg saj. Rasulullahu (a.s.), nuk është hakmarrë kurrë për veten e tij, përveçse atëherë kur shkeleshin ndalesat e Allahut. Atëherë, ai merrte hak vetëm për hir të Allahut.”¹⁴

Jeta e tij është e mbushur me shembuj të tillë të panumërt. Për rrjedhojë, ai nuk i mallkoi ata që e gjakosën kur vajti në Taif, por përkundrazi, kërkoi prej Allahut udhëzimin e tyre.¹⁵ Mirëpo, kur dërgoi shtatëdhjetë hafizë tek një fis për t’u mësuar fenës dhe ky fis i vrau të gjithë, atij iu dogj zemra. Për këtë arsye, për herë të parë dhe të fundit ai mallkoi për një muaj rresht pas namazit të sabahut fisin që vranë hafizët.¹⁶ Kjo, sepse këtu nuk bëhej fjalë për veten e tij, por për të ardhmen e Islamit. Martirizimi i shtatëdhjetë personave të edukuar që e dinin mirë Islamin, ishte një humbje e madhe për të.

Profeti ynë (a.s.), kur ligjëronte Islamin, fliste me një gjuhë shumë të përshtatshme, sepse ashtu e kishte mësuar Edukuesi i tij i Lartmadhëruar: **“Thirr në rru-gën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!..”**¹⁷

Përveç ftesës me mençuri dhe këshillë të bukur, këtu të tërheq vëmendjen edhe urdhri për diskutimin në mënyrën më të mirë, nëse duhet të diskutohet me dikë. Kjo, sepse në një diskutim, e rëndësishme nuk është të kesh epërsi ndaj kundërshtarit dhe ta mundësh atë, por të nxjerrësh në pah të vërtetën e triumfit të së drejtës.

Profeti (a.s.), gjatë gjithë jetës ka vepruar me parimin e përpjekjes me mençuri dhe këshillë të bukur, duke u treguar njerëzve bukuritë e Islamit sa herë që i jepej mundësia. Njëherë, një beduin erdhi në xhaminë e profetit dhe urinoi në një vend me rërë. Sahabët që e panë, u bënë gati ta sulmonin, por Profeti (a.s.), ndërhyri dhe pasi urdhëroi të hidhej një kovë ujë në vendin e urinuar, filloi t’i tregojë me gjuhë të ëmbël beduinit se ai ishte një vend ku përmendej Allahu, falej namaz dhe lexohej Kuran.¹⁸

Po kështu, edhe kur Muauije bin Hakem, i cili ishte një mysliman i ri dhe nuk e dinte se nuk duhej të fliste në namaz, i tha “Jerhamukellah/Allahu të mëshiroftë”, një personi që teshtiu gjatë namazit me xhemat, sahabët u bënë gati ta qortonin, por Profeti (a.s.), pas namazit tregoi po të njëjtën butësi edhe me të. Muauije, i cili e tregon këtë ndodhi, thotë: “Ju bëfshin kurban nëna dhe babai im! Unë nuk kam parë as më herët dhe as më vonë një mësues që mësonte më bukur se Rasulullahu (a.s.). Ai as më qortoi, as më goditi dhe as nuk më foli me fjalë të këqija. Kur mbaroi namazi, ai më tha vetëm kaq: “Nuk është e drejtë të flasësh gjëra të kësaj bote në namaz. Namazi ka vetëm tesbih, tekbir dhe lexim Kurani”¹⁹

Një shembull tjetër tregon se si Profeti (a.s.), arrinte të fitonte njerëzit me parimin e diskutimit me mirësi. Kur një nga të parët e fisit Benu Hanife, Thumame bin

Usal, erdhi në Mekë, Profeti (a.s.), e ftoi edhe atë në Islam. Mirëpo, Thumame reagoi ashpër duke thënë: “Nëse e përsërit edhe njëherë këtë, do të të vras!” Më vonë, pas hixhretit/emigrimit, Thumame bie rob dhe sillet në Medinë. Profeti (a.s.), e njohu menjëherë, prandaj urdhëroi që Thumame të lihej në mesxhid dhe të trajtohej mirë. Madje, ai i dërgoi ushqim edhe prej shtëpisë së vet. Sa herë që vinte në mesxhid, Profeti (a.s.), e ftonte në Islam. Ndërsa Thumame tha se e kishte bërë hak të vritej, por nëse lirohej kundrejt një shpërblimi, Profeti do t’i bënte një mirësi shumë të madhe. Gjithsesi, Profeti (a.s.), vazhdoi të sillej mirë me të edhe për një farë kohe. Mirëpo, pasi gjendja nuk ndryshoi, ai urdhëroi që të lihej i lirë pa asnjë lloj shpërblimi. Në sajë të këtij qëndrimi të durueshëm e falës të Profetit (a.s.), pasi doli jashtë Medinës, Thumame vendosi të bëhej mysliman dhe u kthye prapë në Medinë. Kur u kthye, i tha Profetit (a.s.): “O Muhammed! Më parë, për mua nuk kishte fytyrë më të urreyer se fytyra jote. Por tani, fytyra jote është bërë fytyra më e dashur për mua. Më parë, nuk urreja asgjë më tepër se sa fenë tënde. Por tani, feja jote u bë feja më e dashur për mua.”²⁰

Profeti ynë i nderuar, tregoi të njëjtën sjellje fisnike edhe në çlirimin e Mekës. Për rrjedhojë, ai i fali dhe i liroi idhujtarët e Mekës, të cilët e kishin torturuar dhe ofenduar rëndë për vite me radhë. Kjo ishte vetëm një nga shfaqjet më të bukura të moralit të tij të lartë. Sjellja e tij e butë dhe falëse, ishte bërë shkak që shumë njerëz të pranonin Islamin. Në një fjalë të tij drejtuar Aliut (r.a.), shprehej se, “të bëhesh shkak i udhëzimit të një personi të vetëm, është më e çmuar se të zotërosh tufa të deveve të kuqe²¹, madje, më e çmuar edhe se të zotërosh botën dhe gjithçka ka në të.”²²

Për këtë arsye, kur Usame bin Zejdi (r.a.), vrau një person në luftë, edhe pse ai kishte shqiptuar fjalën e shehadeetit (La ilahe il-lallah), i habitur, Profeti tha: “Domethënë ke vrarë një njeri që thotë La ilahe il-lallah!” Mirëpo, kur Usame (r.a.), i tha: “Po ai e tha për shkak të frikës nga vdekja o Rasulullahu!”, Profeti (a.s.), i dha këtë përgjigje shumë të veçantë: “A mos ia hape zemrën dhe pe çfarë kishte në të?” Madje, për shkak të mërzi-së së madhe, Profeti (a.s.), e përsëriti aq shumë këtë pyetje, saqë sahabi në fjalë u hidhërua duke thënë: “Ah sikur të isha bërë përsëri mysliman e t’ia filloja nga e para (e të mos e kisha bërë këtë gabim)”²³

Profeti (a.s.), përdorte shumë mënyra për të fituar njerëzit. Një nga këto ishte edhe vlera që i jepte ai personit që kishte përballë. Amr bin As (r.a.), tregon se; Rasulullahu (a.s.), i dëgjonte, u fliste dhe përpiqej t’u fitonte zemrat edhe njerëzve më të këqij. Po ashtu, edhe me mua u interesua ngrohtësisht. Aq sa e pandeha veten më të mirin ndër të gjithë njerëzit që ndodheshin aty pranë dhe pyeta: “O Rasulullahu! Kush është më i mirë, unë apo Ebu Bekri?” Ndërsa Profeti (a.s.), u përgjigj: “Ebu Bekri”²⁴ Gjithashtu, në një transmetim tjetër thuhet se Profeti (a.s.), Amr bin Asin (r.a.), i cili sapo ishte bërë mysliman, e caktoi

si komandant të një grupi ushtarak, midis të cilëve ndodheshin edhe sahabët e mëdhenj si Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma) dhe i dërgoi në betejën e Zatu'th-Thelathil. Duke u nisur nga ky nder i madh që i ishte bërë, plus edhe kthimin me fitore të Amr ibn Asit (r.a.), i sigurt për përgjigjen, ai gjeti guximin të pyeste Profetin (a.s.) se: “Kush ishte njeriu më i dashur për të?”. Profeti (a.s.), e kuptoi gjendjen e tij shpirtërore dhe iu përgjigj: “*Aishja*”. Mirëpo, Amri këmbënguli për të marrë përgjigjen që dëshironte dhe kësaj here e pyeti: “Po prej burrave?” Përgjigja e Profetit (a.s.), ishte “*Babai i saj, (pra Ebu Bekri (r.a.))*” Më pas përmendi Omerin (r.a.) dhe shumë persona të tjerë. Mirëpo Amrit s’po i vinte radha. Më në fund, hoqi dorë nga pyetjet duke menduar se po të vazhdonte kështu do të mbetej i fundit.²⁵ Në këtë mënyrë, ai e kuptoi se kur Profeti (a.s.) e lavdëronte dikë, nuk ua ulte vlerat dhe virtytet të tjerëve.

Siç shihet, kur Profeti (a.s.), fliste me njerëzit, merrte parasysh edhe gjendjen e tyre shpirtërore. Ai tregojë i matur edhe kur i lavdëronte njerëzit dhe me këdo silleje ashtu siç e meritonte. Lidhur me këtë fakt, në një hadith fisnik, Profeti (a.s.), thotë: “*Vendosini njerëzit në pozitën që meritojnë*”²⁶ Ndërsa në një hadith tjetër, ka thënë: “*Ne jemi urdhëruar t’u flasim njerëzve sipas nivelit mendor që kanë.*”²⁷ Me këtë ai ka theksuar rëndësinë e të folurit me njerëzit në përputhje me nivelin e tyre mendor.

Përveç këtyre, ai përpigjij të mos i mërzieste njerëzit duke u mbajtur ligjërata e duke i këshilluar vazhdimisht. Ai mendohej të gjente kohën e përshtatshme për të ligjëruar e këshilluar, duke kapur momentet kur njerëzit ishin gati të mësonin diçka. Për rrjedhojë, kur njërit prej sahabëve të mëdhenj, Ibn Mes’udit (r.a.), i cili ndiqte shembullin e Profetit (a.s.), i thanë që t’u mbante ligjërata çdo ditë, ai u kujtoi atyre këtë traditë të Profetit (a.s.).²⁸

Në themel të të gjitha këtyre qëndronte mendimi i Profetit (a.s.), se feja duhet paraqitur me lehtësi dhe bukuri. Këtë e vërteton edhe shprehja e tij: “*Feja është lehtësi*”²⁹ Ai e kishte bërë parim të tregonte të lehtë dhe të njëjtin parim u ka këshilluar edhe sahabëve dhe umetit të vet: “*Lehtësoni dhe mos vështirësoni! Përgëzoni dhe mos ngjallni urrejtje!*”³⁰ Parimi i tij ishte t’ua bënte të dashur fenë njerëzve dhe këtë ia ka lënë trashëgim edhe umetit të tij. Allahu i madhëruar, urdhëron: “*...Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë!*”³¹

Një nga shfaqjet e moralit të lartë të Profetit tonë (a.s.), ishte qëndrimi i tij gjithmonë në anën e së vërtetës dhe të së drejtës. Ai nuk ndahej prej së vërtetës edhe kur bënte shaka. Njëherë, kur sahabët i thanë: “O Rasulallah po bën shaka me ne!”, ai u përgjigj: “*Po, por unë nuk them asgjë tjetër përveç së vërtetës.*”³²

Një ditë, erdhi një person dhe i kërkoi Profetin (a.s.), një kafshë për të hipur. Ndërsa Profeti (a.s.), tha me shaka: “*Do të jap një këlysh deveje*”. Personi, i cili u habit përballë kësaj përgjigjeje, tha: “O Rasulallah! E

çfarë të bëj unë me këlyshin e deveje?” Atëherë, Profeti (a.s.), ia shpjegoi se po bënte shaka duke i thënë: “*A nuk është çdo deve një këlysh deveje?*”³³ Po ashtu, një herë tjetër, një grua e moshuar erdhi tek Profeti (a.s.) dhe i tha: “O Rasulallah! Lutju Allahut që të më fusë në Xhenet?” Ndërsa Profeti (a.s.), dëshiroi të bënte pak shaka dhe i tha: “*O nëna e filanit! Gratë e moshuara nuk hyjnë në Xhenet!*” Për rrjedhojë, gruaja e moshuar filloi të qajë. Profeti (a.s.), i cili e kuptoi gjendjen e saj, duke u mbështetur në një ajet³⁴, e ngushëlloi atë duke i thënë se, edhe nëse njerëzit janë të moshuar, në Xhenet do të hyjnë të rinj.³⁵

Jeta e Profetit (a.s.), është e mbushur plot me shembuj që tregojnë moralin dhe karakterin e tij të lartë. Padyshim se ai nuk është një shembull i bukur vetëm për besimtarët, por për të gjithë njerëzimin. Dhe do të vazhdojë të jetë një shembull i tillë deri në Ditën e Kiametit. Detyra jonë është të marrim shembull nga jeta e tij dhe të mundohemi ta bëjmë jetën sipas traditës së tij profetike (Sunetit), sepse ai e ka jetuar Islamit në mënyrën më të përsosur. Ai ishte mishërimi i Islamit dhe i Kuranit.

Arritja e kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut varet nga dashuria ndaj Profetit (a.s.) dhe ndjekja e gjurmëve të tij. Në Kuran urdhërohet:

Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”³⁶

**“Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pa-
sojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj pra, bashkë me
dëshmitarët!”**³⁷

**“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e
Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe për-
shëndeteni me “selam!”**³⁸

“... Dëgjuam dhe bindemi!..”³⁹

Referencat:

- 1) Kalem, 4; 2) Sebe’, 28; 3) Muslim, Salatu’l-musafirin, 139; 4) Enbija, 107; 5) Ibnu’l-Esir, en-Nihaje fi garibi’l-hadis, Beirut, 1997, I, 8; es-Sujuti, el-Xhamiu’s-sagir, Lajlpur. (Pakistan), ts., I, 13; el-Axhluni, Keshfu’l-hafâ, Haleb-Kahire, ts. I, 72; 6) Al-i Imran, 19, 85; 7) El-Ahzab, 40; 8) Maide, 3; 9) Malik, Husnu’l-huluk, 8; Ahmed, Musned, II, 381; Buhari, el-Edebu’l-Mufred, Beirut, 1997, fq. 104; 10) Ahzab, 21; 11) Buhari, Rikak, 26; Muslim, Fada'il, 17-9; Tirmidhi, Edeb, 82; 12) Al-i Imran, 159; 13) Ahmed, Musned, V, 146; Ebu Da'ud, Sunne, 2; 14) Buhari, Menakib, 23; Muslim, Fada'il, 77; 15) Buhari, Bed'u'l-halk, 7; Muslim, Xhihad, 111; 16) Buhari, Xhihad, 184, Megazi, 28; Muslim, Mesaxhid, 297-302; 17) Nahl, 125; 18) Muslim, Tahare, 98-100; gjithashtu shih. Buhari, Udu, 57-58, Edeb, 35, 80; Tirmidhi, Tahare, 112; 19) Muslim, Mesaxhid, 33; Ebu Daud, Salat, 167; Ahmed Onkal, “*Rasulullah'in islâm'a Davet Metodu, Konya*”, 1984, s. 163-164; 20) Ahmed, Musned, II, 246-247, 452; Buhari, Megazi, 70; Muslim, Xhihad, 59; Ebu Daud, Xhihad, 114; Ahmed Onkal, “*Rasûlullah'in islâm'a Davet Metodu*”, s. 163; 21) Buhari, Xhihad, 102, 143; Müslim, Fada'ilul'-ashab, 34; 22) Në një transmetim, është edhe shprehja: “*Çdo gjë mbi të cilën lind dhe perëndon dielli*”. Shih. el-Hejthemî, Mexhmau'z-zeuaid, Kairo, ts., V, 334; 23) Buhari, Megazi, 45; Muslim, Iman, 158; Ebu Daud, Xhihad, 95; 24) Tirmidhi, esh-Shemailu'n-nebeu'ijje, Beirut, 1996, fq. 419; 25) Buhari, Megazi, 63; 26) Ebu Daud, Edeb, 20; 27) Dejemli, el-Firdeus bi me'suri'l-hitab, Beirut, 1986, I, 398; el-Axhluni, Keshfu'l-hafa, I, 225-226; 28) Buhari, Ilm, 12; 29) Buhari, Iman, 29; 30) Buhari, Ilm, 11; Muslim, Xhihad, 6; 31) Bekare, 18; 32) Buhari, el-Edebu'l-mufred, fq. 102; Tirmidhi, Birr, 57; 33) Buhari, el-Edebu'l-mufred, fq. 102; Ebu Daud, Edeb, 84; Tirmidhi, Birr, 57; 34) Uakia, 35-37; 35) Tirmidhi, esh-Shemail, s. 298; 36) Al-i Imran, 31; 37) Al-i Imran, 53; 38) Ahzab, 56; 39) Bekare, 285.



Ki respekt dhe duro!

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

NGJARJA:

Sipas transmetimit të Enes Ibn Malikut (r.a.), Rasullullahu (a.s.), kaloi pranë një gruaje e cila po qante duke bërtitur në krye të një varri dhe i tha:

“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”

Gruaja u përgjigj:

“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’ të ka rënë ty!”

Gruaja nuk e kishte njohur Profetin (a.s.). Mirëpo më pas, kur i thanë se ai që e këshilloi të ketë respekt dhe durim, ishte vetë Profeti (a.s.), ajo nxitoi për tek shtëpia e Rasullullahut (a.s.), hyri brenda dhe tha duke kërkuar falje:

“Unë nuk ju njoha.”

Ndërsa Profeti (a.s.), tha:

“Durimi i vërtetë, është të durosh në momentin e parë të fatkeqësisë.”¹

RESPEKTI DHE DURIMI

Në këtë hadith fisnik nuk është përmendur emri i gruas në fjalë. Gjithashtu, nga sa kuptohet prej trans-

metimeve, kjo grua qante se kishte humbur fëmijën e saj. Madje, qante me të madhe. Kjo kuptohet nga fakti se Profeti (a.s.), e ftoi atë të tregonte respekt ndaj Allahut dhe të bënte durim. Po ashtu, këtu kuptohet se edhe gratë mund të vizitojnë varrezat, sepse Profeti (a.s.), nuk e paralajmëroi atë për faktin se kishte ardhur në varreza, por sepse po qante me të madhe.

Siç dihet, Profeti (a.s.), interesohej për njerëzit përreth dhe aty ku ndihej nevoja, kryente detyrën e tij të **“urdhërimit për të mirë dhe të ndalimit nga e keqja”**, në mënyrën më delikate dhe pa i thyer zemrën askujt. Pra, edhe në këtë hadith fisnik, Profeti (a.s.), ka urdhëruar për të mirë, duke i thënë: *“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”*. Edhe pse në mënyrë indirekte kjo nënkuptohet si “mos qaj duke bërtitur!”, ai nuk i tha kështu. Ky paralajmërim është një shembull i zbatimit të metodës dhe delikatesës së udhëzimit dhe urdhërimit për të mirë edhe kur tërhiqet vërejtja.

Gruaja e shkretë, në atë gjendje të përhumbur, pa bërë kujdes se kush e këshillonte të kishte respekt dhe durim, reagoi mjaft ashpër, duke thënë: *“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’ të ka rënë ty!”*. Përndryshe, kushdo qoftë, burrë apo grua, asnjë prej sahabëve nuk do të thoshte kurrë “më lër rehat”, po ta kishte njohur Profetin (a.s.).

1. Buhari, Xhenaiz 32, 43; Ahkam 11; Muslim, Xhenaiz 14-15. Shih edhe Ebu Daud, Xhenaiz 23; Tirmidhi, Xhenaiz 13; Nesai, Xhenaiz 22.

Meqë ra fjala, është me dobi të themi diçka edhe për një çështje aktuale. Ka disa njerëz, që përballë disa haditheve të Profetit (a.s.), thonë: “Nuk më duket si thënie e profetit. Por edhe nëse e ka thënë, unë s’mund ta pranoj këtë!”, gjë që nuk është aspak e hijshme. Kjo bie në kundërshtim me të vërtetën e besimit, mënyrën e të kuptuarit të Profetit (a.s.) dhe respektin ndaj tij. Për rrjedhojë, atyre që kanë rënë në një injorancë të tillë ose kanë zgjedhur këtë mënyrë kuptimi, është e domosdoshme që t’u bëhet thirrje dhe paralajmërim, duke i këshilluar për respekt dhe durim.

Për shkak të gjendjes së përhumbur të gruas që reagoi ashpër, Rasulullahu (a.s.), nuk e zgjati shumë dhe vazhdoi rrugën. Nëse ai do ta kishte përsëritur këshillën e tij, gruaja mund të fliste fjalë më të rënda dhe më të ashpra. Dhe kjo mund ta shpinte atë grua në një gjendje më të keqe dhe më të rrezikshme nga gjendja që ndodhej. Thelbi i këshillës dhe urdhërimit për të mirë, është se nuk duhet që personi i cili këshillohet, të detyrohet me zor ta pranojë këshillën apo paralajmërimin. Kjo, sepse realizimi i detyrës së këshillimit për të mirë, nuk e ka si kusht pranimin e këshillës nga personi. Është e mjaftueshme të bëhet e ditur e vërteta.

Kjo është edhe metoda që duhet ndjekur sot. Pra, kur këshillohet e urdhërohet për të mirë dhe merren përgjigje si; “më lër rehat, shiko punën tënde, ç’të duhet ty etj.”, nuk duhet të hyjmë në debat apo në grindje me njerëzit. Neve na mjafton të themi të vërtetën dhe të këshillojmë të drejtën.

Një (apo disa) prej sahabëve, të cilët nuk përmenden me emër, mendoi se gruaja e bëri këtë veprim për shkak se nuk e njohu Profetin (a.s.). Për këtë arsye, ai ia bëri të ditur duke i thënë:

“Ai që të këshilloi të tregosh respekt dhe durim, është Profeti (a.s.)” Pas kësaj, gruaja u mërzi jash-të mase dhe duke harruar edhe dhimbjen që kishte për fëmijën e vet, mori rrugën për tek Profeti (a.s.), që t’i kërkonte falje. Ky është rezultati i natyrshëm i një myslimani që e ka të drejtë botëkuptimin e tij për Profetin (a.s.) dhe respektin ndaj tij.

Sipas transmetimeve, gruaja e shkretë mendoi se tek dera e Profetit (a.s.), do të kishte roje dhe ajo nuk do të kishte mundësi ta takonte atë. Mirëpo, nuk ndodhi ashtu. Ajo shkoi dhe u takua direkt me Profetin (a.s.).

Sipas transmetimit, thuhet se gruaja u betua se “Unë nuk të njoha!” dhe i kërkoi të falur. Mirëpo, Profeti ynë (a.s.), si një edukues i pashoq, e kuptoi se gruaja nuk kishte shumë njohuri në lidhje me durimin. Për rrjedhojë, ai ia shpjegoi menjëherë aty se çfarë është durimi i vërtetë, duke ia bërë të ditur

edhe të gjithë umetit të tij. “*Durim i vërtetë, është të durosh në momentin e parë të fatkeqësisë.*” Madje, ai nuk u ndal fare tek fjalët që i tha gruaja: “Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’të ka rënë ty! E rëndësishme ishte që gabimi të pranohej dhe myslimanët të mësonin të vërtetën e durimit.

Dihet se njeriu mësohet dhe duron gjithçka me kalimin e kohës. Por është shumë e vështirë të jesh i durueshëm në momentet e para kur përballësh me fatkeqësitë dhe belatë. Pasi të kesh duruar goditjen e fatkeqësisë në momentin e parë, më pas ndikimi i saj do të pakësohet dalëngadalë. Mirëpo, të jesh i zbrazët nga besimi në ato momente, Zoti na ruajttë, mund të bëhet shkak i përfundimeve të padëshirueshme e të hidhura, që tek humbja e mendjes, e deri tek vetëvrasja. Për këtë arsye, është e domosdoshme që në momentet e para të fatkeqësisë të tregohemi të fortë, të respektueshëm dhe të durueshëm.

Siç kuptohet edhe nga kjo ngjarje, momentet e hidhërimit, janë momente të rrezikshme, të cilat mund të bëjnë të harrosh respektin ndaj Allahut dhe të bësh veprime të tepëra. Dhe përjetimi i momenteve të tilla është një realitet i jetës së kësaj bote për të gjithë. Momentet e hidhërimit dhe gëzimit, janë çaste kur vullneti dhe qëndresa e njeriut janë të dobëta. Një fjalë apo një fjali që mund të dalë nga goja e njeriut në momente të tilla, mund ta turpërojë njeriun dhe mund ta nxjerrin edhe myslimanin nga besimi i tij. Për këtë arsye, rreziku është shumë i madh.

Respekti ndaj Allahut dhe durimi duhen më tepër përballë ndodhisë së vdekjes. Pjekuria e besimit të myslimanit matet pak edhe me anë të durimit që tregon gjatë ndodhive të vdekjes. Në fakt, vaji dhe kuja që përdor populli dhe në mënyrë të veçantë gratë, nuk janë virtyte ashtu siç pandehet. Virtyti i vërtetë është ta kalosh atë moment të hidhur duke e pranuar caktimin e Allahut. Rreziku që e pret njeriun në momente të tilla, është përdorimi i fjalëve që nënkuptojnë refuzimin e Profetit (a.s.), e madje edhe të Allahut të Madhëruar. Për shkak se durimi i njeriut është i dobët në çastet e hidhërimit, është shumë e vështirë që ai t’i kontrollojë fjalët që nxjerr prej goje. Allahu i Madhëruar, urdhëron: “**...Përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”** (Bekare, 155-156)

Në këtë ndodhi tregohet se jo gjithmonë këshilla dhe paralajmërimet marrin gjithmonë falënderime. Atëherë, neve na duhet të jemi të përgatitur ndaj reagimeve të papritura që mund të bëhen ndaj këshillave që bëjmë. Madje, kjo duhet vlerësuar si një detyrë që kërkon “respekt dhe durim”.



Ali Ezzajllan Efendiu

PASTIÇIERI NGA BANDËRMAJA

Prof. dr. Nexhdet Tosun

Ali Ezzajllan Efendiu lindi në një familje shqiptare në Shkup me 1331 / 1913 ose 1914. Ai ishte një njeri besimtar që u shpërngul nga Shkupi për në Turqi që në moshë të vogël dhe u vendos në Bandërma. Të afërmit e tij i thonë Pasticieri vëlla Aliu. Për sa i përket arsimit, ka vetëm shkollën fillore. Jetesën e siguronte me anë të pasticërisë që kishte ndërtuar në Bandërma. Kur gjente kohë të lirë në rininë e tij, shkonte në Stamboll dhe njihej me dijetarët, artistët dhe mistikët e mëdhenj të kohës. Ai vazhdimisht përfitoi prej kuvendeve të tyre.

Ali Efendiu në rininë e tij u bë nxënës i Ali Hajdar Efendiu, i cili ishte prej dijetarëve të asaj kohe. Siç shprehet edhe vetë, një herë Ali Hajdar Efendiu i kishte thënë Ali Efendiu: “Bir! Tahiru’l-Mevlevi ka shkruar një poezi në “Divanin” e tij për ju. Në poezi përmendet edhe emri juaj. “Divani” duhet të jetë ky libri në këtë raft, a mund të ma jepni, ju lutem? Pasticieri Ali Efendiu nga njëra anë mori librin në raft dhe nga ana tjetër filloi të shqetësohej duke menduar: “Mos vallë Efendiu do të më kritikojë duke thënë: A bën të jesh edhe Nakshibendi, edhe Mevlevi? Por

pasi Ali Hajdar Efendiu e gjeti atë poezinë dhe e lexoi, e lavdëroi duke i thënë: “Tahiru’l-Mevleviu është shoku im i burgut. (Ai ka qëndruar në të njëjtën qeli me Atif Efendiu nga Shkupi në periudhën e dënimit për kapelën.) Ai është një njeri shumë i nderuar dhe fisnik. Fakti që keni fituar konsideratën e një njeriu të tillë është një lumturi e madhe.

Pasticieri Ali Efendiu, pasi ndërroi jetë shehu i tij Ali Hajdar Efendiu, u lidh me Mahmud Sami Ramazanogllu Efendiu. Ai u bë mik i veçantë i Prof. Suhejl Ynverit, Samiha Ajverdit, Hasan Basri Çantajit dhe Nejzen Tevfikut. Një ditë Nejzen Tevfiku pasi mbajti një ligjëratë të gjatë shkencore në lidhje me muzikën dhe nejin (lloj instrumenti si fyell) në një kuvend në të cilin gjendeshin burra dijetarë të zgjedhur si Prof. Dr. Fuad Këprly dhe pasi i ra nejit, tha: “Kjo është hera e fundit që po i fryej nejit.” Pastaj i la një amanet Ali Efendiu duke i thënë: “Ti do të ma falësh namazin e xhenazes.” Edhe pse Ali Efendiu i tha: “Unë nuk kam arsim.”, ai prapë se prapë nuk pranoi. Pas një jave ndërroi jetë dhe xhenazen ia fali Ali Efendiu.

Ali Efendiu, siç tregon edhe vetë, në rininë e tij kishte shkuar nëpër mejhane dhe nuk kishte pirë alkool, por kishte pirë dhallë vetëm e vetëm për t'i ftuar njerëzit në udhëzim duke dialoguar me ta. Ai tregon: “Në dyqan punoja deri në orët e vona të mbrëmjes ngaqë shisja ëmbëlsira dhe pasta. Pastaj e pastroja dyqanin dhe shkoja në shtëpi. Përgjatë rrugës kaloja nga një vend ku kishte shumë mejhane dhe shikoja nëse kishte ndonjë që ishte dehur dhe kishte ngelur aty. Një njeri që ngelte deri në atë orë në mejhane ose ishte një njeri që kishte frikë nga meghanexhiu ngaqë nuk kishte para për të paguar llogarinë, ose ishte një njeri që kishte frikë bashkëshorten duke menduar se do t'i fliste kur të kthehej në shtëpi. Unë ua paguaja borxhin këtyre, por ngaqë këta lloj njerëzish nuk ecnin dot në këmbë, pajtoja një karrocë, i paguaja detyrimin dhe i thosha karrocierit që t'i çonte deri në shtëpinë e tyre. Përveç të tjerash, atyre që ishin të dehur u jepja një paketë me ëmbëlsirë nga pasticeria dhe u thosha: “Këtë jepja bashkëshortes, në mënyrë që të të mos nxehet.”

Kjo butësi, mëshirë dhe tolerancë që Ali Efendiu kishte ndaj njerëzve i dha frytet e saj. Disa njerëz që u ndikuan nga kjo sjellje e pjekur e tij, me kalimin e kohës e lanë pijen dhe gjetën rrugën e drejtë.

Tregohet se një herë dikush i kishte rënë gabim numrit të telefonit dhe kishte telefonuar te dyqani i Ali Efendiu duke pandehur se i kishte telefonuar stacionit të taksive. Ai kishte kërkuar një taksì. Ali Efendiu, në vend që t'i thoshte se i keni rënë gabim, i kishte thënë: “Në rregull zotëri. Taksia do të vijë menjëherë. Ma jepni adresën!” Pastaj kishte gjetur një taksì, e kishte dërguar në adresën e dhënë dhe ia kishte paguar detyrimin.

Ali Efendiu shkonte për t'i vizituar shtëpitë publike në ditët e bajrameve dhe netëve të mira. Ai u çonte dhurata grave që gjendeshin aty. Një njeri që bën mëkat, nuk del nga Islami, por bëhet vetëm mëkatar. Ali Efendiu së pari u jepte vlerë si njerëz atyre grave dhe pastaj përpiquej t'ua kujtonte përsëri dritën e Islamit që kishin në zemrat e tyre duke u dhënë dhurata në ditët e festave fetare apo netët e mira. Të gjitha gratë që gjendeshin aty shpreheshin se nuk ishin të kënaqura me jetën e tyre dhe se ishin shumë të pikëlluara. Ali Efendiu sillej me tolerancë ndaj myslimanëve mëkatarë, madje edhe ndaj njerëzve që nuk ishin myslimanë. Ai mendonte se ata mund të pendohen dikur deri në fund të jetës së tyre dhe mund të shpërnguleshin në Ahiret si

njerëz të penduar e të devotshëm. Ali Efendiu nuk kishte tolerancë vetëm kundrejt atyre që e luftonin Islamin.

Ali Efendiu ka vuajtur shumë në periudhën e sistemit një partiak. Ngaqë në dyqanin e tij ka pasur fotografinë e Fatih Sulltan Mehmedit dhe tablo me besmele, etj. u akuzua si “dashamirës i osmanëve” dhe me “kundërshtim të reformës së shkronjave”. Shtëpia e tij u mbajt nën kontroll për një kohë të gjatë. Kur ngrihej në mëngjes dhe ndizte dritën për të falur namazin, e merrnin në pyetje se përse e ndizte llambën. Ai u kritikua ngaqë fali namazin e mëngjesit në shtëpi të tij edhe pse ishte përgjigjur: “Fëmija ishte sëmurë. Prandaj llambën e ndeza për t'i dhënë ilaçet.” Librat fetarë që kishte në shtëpi dhe veçanërisht veprat në osmanisht iu sekuestruan përgjatë kontrolleve që iu bënë dhe asnjëherë nuk iu kthyen më.

Ai tregon: Kur Behxhet Qemal Çagllari kishte shkuar në Bandërma për të mbajtur një fjalim në një konferencë, kishte shkuar edhe te dyqani i Ali Efendiu. Kur aty kishte parë tablo me fotografi dhe kaligrafi osmane, kishte thënë: “Me sa duket, pronari i këtij dyqani qenka admirues i osmanëve. Le të njihemi me të!” Behxhet Qemali bashkë me një grup mësuesish që ishin kolegë të tij kishin marrë në telefon shtëpinë e Ali Efendiu dhe i kishin thënë se dëshironin të shkonin te shtëpia e tij për vizitë. Ali Efendiu u kishte thënë se mund të urdhëronin pas një ore, por brenda tij kishte ndjerë disa dyshime. Prandaj kishte marrë abdest dhe kishte filluar t'i priste. Mysafirët kishin shkuar dhe ishin pritur me nderime. Në bisedë e sipër nuk ishte thënë asnjë fjalë e keqe siç pati dyshuar Ali Efendiu dhe kishte mbi-zotëruar respekti. Ndër të tjera, Ali Efendiu i kishte thënë: “Zoti Behxhet Qemali! Unë jam një njeri i varfër dhe me arsim të mangët që mezi kam mbaruar edhe filloren. Por sidoqoftë i kam në memorie disa nga poezitë tuaja. Në një poezi tuajën me titull “Himni i vitit të dhjetë”, thoni: “Në dhjetë vjet kemi krijuar pesëmbëdhjetë milion të rinj nga çdo moshë.” A nuk do të ishte më mirë sikur shprehjen “kemi krijuar” ta ndërrojmë në “kemi edukuar”? Krijimi i përket vetëm Allahut Teala. Kjo fjalë e juaja mund ta zemërojë Allahun (xh.sh.)” Behxhet Qemali i kishte thënë: “Le ta mbyllim këtë temë!” Këtë fjalë e kishte përsëritur rreth dhjetë herë. Pastaj ishte kapluar nga një gjendje gjysmë xhindosjeje dhe ishte rrëzuar përtokë. Për shkak se ishte rrëzuar në tokë, i kishte dalë gjak nga hunda. Kolegët e kishin marrë, por ajo

gjendja gjysmë e xhindosur nuk i kishte kaluar dhe pas dhjetë ditësh kishte ndërruar jetë.

Ali Efendiu kishte shkuar në Ankara në periudhën kur partia demokratike e Menderesit erdhi në pushtet, kishte qëndruar rreth një javë aty, iu ishte lutur politikanëve që bënin naze dhe kishte arritur të nxirrte ligjin e varrezave, sepse para se të dilte ky ligj, gurët e varreve që kishin ngelur nga koha osmane dhe të cilët ishin vepra shkencore, historike dhe artistike, thyheshin dhe copëtoheshin një nga një. Pasi doli ky ligj, Ali Efendiu shprehet se shumë shehlerë si Merkez Efendi dhe Symbyl Efendi e kanë uruar në ëndërr.

Njëri prej njerëzve që Ali Efendiu donte më së shumti ka qenë pedagogu i tasavufit në fakultetin e teologjisë të universitetit të Marmarasë, Doç. Dr. Selçuk Erajdëni. Ali Efendiu gjithmonë thoshte: “Kur ndërroi jetë Selçuku, sikur më vdiq gjysma e trupit.” Kur zoti Selçuku po kthehej nga vaza në një natë të mirë në Stamboll, pësoi aksidente dhe ndërroi jetë. Në ato momente, Ali Efendiu i cili gjendej në shtëpinë e tij në Bandërma, dëgjoi një zë që i thoshte: “Selçuku ra dëshmor!” Pas një ore, ai i telefonoi vajzës së zotit Selçuk dhe i dha lajmin për vdekjen e babait të saj.

Ali Efendiu ua puthte dorën njerëzve në moshën e nipërve të tij dhe në vitet e fundit të jetës i përcillte mysafirët vetë deri te dera duke u mbështetur në paterica ngaqë këmbët nuk e mbanin më. Në kuvendet e tij fetare sundonte metoda osmane e ëmbël dhe plot hijeshi. Ai nuk përdorte fjalë perëndimorë që janë futur në turqisht. Në të gjitha sjelljet e tij kishte edukatë dhe madhështi. Ai ishte një osman i nderuar me të gjithë kuptimin e plotë të fjalës.

Ky osman i nderuar ndërroi jetë ditën e hënë më 4 Gusht 2008. Veçanërisht kur fliste për zotëri Selçukun, thoshte: “Shumica e miqve të mi shkuan në botën tjetër. Trupi tashmë me duket i rëndë.” Tashmë ka shkuar te Zoti (xh.sh.), miqtë e tij dhe zotëri Selçuku. Ai u varros pranë oborrit të Xhamisë Teqe në Bandërma më 6 Gusht 2008. Edhe pse tre vjet pasi ndërroi jetë iu shkrua në gurin e varrit të tij “me ixhazet nga tarikati Nakshibendije dhe Mevlevije”, ai në të vërtetë nuk ka pasur ixhazet, por prapë se prapë ka qenë një dervish modest dhe i sinqertë. Allahu e bëftë prej banorëve të Xhenetit!

Disa fjalë të tij:


- Që në kohën e fëmijërisë kam pasur një dashuri të thellë ndaj librave dhe leximit. Gjithmonë më ka

pëlqyer të lexoj, të shkruaj dhe të njihem me edukatorët dhe shehlerët. Falënderimet qofshin për Allahu i Cili ma mundësoi mua të varfrit që të njoh shumë prej profesorëve të kohës sonë. Duke filluar që nga Hakkari e deri në Edirne kam pasur mundësinë të njoh shumë shehlerë dhe edukues Kadiri, Mevlevi dhe Nakshibendi duke filluar që nga Sheh Selim Efendiu e deri te Ragip Efendiu.

- Mësimin e Kuranit Fisnik e kam marrë në xhami nga hoxhë Zekerija Efendiu në dritë të qiriut në periudhën kur kjo vepër ishte e ndaluar. Ndërmjet namazit të akshamit dhe të jacisë përpiqeshim të mësonim diçka fshehurazi. Madje, një ditë hoxhën e kishin raportuar në polici me akuzën se na mësonte Kuranin. Sigurisht se në gjendje të tilla vazhdimisht merrnim masa dhe bënim kujdes. Këpucët nuk i vishnim. Në xhami gjendeshin dy raftë të mëdhenj. Kur xhandarët hynin në xhami duke bërë bastisje, ne menjëherë hynim në raft. Gjithashtu i fshihnim edhe qirinjtë. Atyre nuk u shkonte në mendje për të parë brenda në raftë. Në këtë mënyrë kemi shpëtuar prej dorës së xhandarëve.

- Një ditë në Stamboll po shkoja te biblioteka e Stambollit nga tatëpjeta Babiali. Papritur vura re se faqet e Kuranit Fisnik ishin përhapur në të gjithë rrugën. Ato po shkeleshin nga gomat e makinave. Me të vërtetë u përballa me një pamje mjaft tronditëse. Menjëherë shkova te zotëri Eshrefi që e kishte vendin e punës diku aty. Atë e pyeta se çfarë po ndodhte kështu. I gjithë problemi ishte ky: Pronari i librarisë Maarif, zotëri Axhem Naxhi kishte botuar Kuranin Fisnik dhe në fund kishte vendosur edhe katër faqe për mësimin e leximit të Kuranit. Këtë e kishin parë dhe menjëherë ia kishin bastisur shtypshkronjën akoma pa i futur faqet ndërmjet kopertinave. Në këtë mënyrë, ia kishin sekuestruar të gjithë librat e Kuranit. Ato i kishin futur në kamionët që mbledhin mbeturinat dhe po i çonin për t'i djegur. Kur po i ngarkonin te kamionët, faqet ishin shpërndarë nëpër rrugë për shkak të erës që frynte.

- Çdo gjë duhet ta shohim me butësi. Çdo gjë duhet ta shohim në mënyrën që e ka pas parë edhe Muhamedi (a.s.). Për të gjithë duhet të mendojmë mirë duke thënë: “Unë nuk jam i ngarkuar me detyrën për të vërtetuar kufrin apo mirësinë e të tjerëve.” Nuk duhet të paragjykojmë asnjë njeri. Asnjëherë nuk duhet të themi: “Filan person është kështu e ashtu.” Ku i dihet?! Ndoshta pas pesë minutash mund të heqë dorë nga të gjitha cilësitë e këqija.



Parime jetike nga Pejgamberi (a.s.)

Halid bin Velidi (r.a.), transmeton një hadith:

Një ditë erdhi një burrë tek Pejgamberi (a.s.) dhe i tha:

- O Resulullah! Do t'ju lutesha të më tregoni për disa gjëra që mund të më mjaftojnë si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

- Urdhëro, çfarë dëshiron?

Dhe pastaj, vijoi ky dialog:

- Dua që të bëhem më i dituri në botë.

- *Ki frikë nga Allahu, atëherë do të bëhesh më i dituri në botë.*

- Dua të bëhem më i pasuri në botë.

- *Ji i vetëmjaftueshëm, atëherë bëhesh më i pasuri në botë.*

- Dua të bëhem më i miri në mesin e njerëzve.

- *Ai që është më i dobishëm për njerëzit është më i miri në mesin e njerëzve.*

- Dua të bëhem më i drejti në mesin e njerëzve.

- *Atëherë, atë çfarë dëshiron për vete, dëshiroje edhe për të tjerët.*

- Dua të bëhem më i veçanti në mesin e njerëzve.

- *Kujtoje shumë Allahun (bëji dhikër), atëherë bëhesh më i veçanti në mesin e njerëzve.*

- Dua që të jem nga bamirësit.

- *Atëherë zbukuroje edukatën tënde, që të përsoset imani yt.*

- Dua të bëhem nga njerëzit që janë të bindur.

- *Kryeji gjërat që Allahu ka obliguar për njerëzit, atëherë bëhesh i bindur.*

- Dua të bëhem më i fuqishmi në mesin e njerëzve.

- *Mbështetu tek Allahu dhe bëji tevekkul Atij; bëhesh më i fuqishmi në mesin e njerëzve.*

- Dua që të më pranohet duaja.

- *Largohu nga harami.*

- Dua që Allahu të mos më bëjë rezil në mesin e njerëzve.

- Nëse nuk dëshiron që të bëhesh rezil në mesin e njerëzve, atëherë ruaje gjuhën dhe organin gjenital. Dhe sipas një tjetër transmetimi; rregulloje nderin dhe veset e këqija. (Kurtubiu)

* * *

Në një hadith është thënë:

"Allahu i Madhëruar në Ditën e Kiametit mbledh të gjitha krijesat dhe dikush thërret kështu:

- *Ku janë ata që bënë bamirësi pa shpërblime?*

Nga mesi i njerëzve çohet një grup njerëzish dhe me shpejtësi i drejtohen Xhenetit. Ndërkohë engjëjt i zënë ata dhe i thonë:

- *Kush jeni ju që po shpejtoni për të hyrë në Xhenet?*

- *Ne jemi ata që kemi bërë bamirësi pa u kërkuar shpërblim njerëzve. – i thonë ata.*

- *Cilat janë veprat që keni bërë pa shpërblime ju? – pyesin engjëjt.*

- *Ne, kur na u bë padrejtësi, duruam. I falëm ata që na bënë keq. – i thanë ata.*

- *Hyni në Xhenet, atëherë! Lum për ata që bëjnë vepra të tilla! – thanë engjëjt.*

Pastaj një dikush tjetër thirri:

- *Ku janë njerëzit e durueshëm?*

Sërish nga mesi i njerëzve u ngrit në këmbë një grup njerëzish dhe me shpejtësi iu drejtuan Xhenetit. Engjëjt sërish i zënë ata dhe i pyesin:

- *Kush jeni ju, që po hyni me kaq shpejtësi në Xhenet?*

- *Ne jemi të durueshmit. – i thanë ata.*

- *Kundrejt kujt keni duruar ju? – i pyetën engjëjt.*

- *Ne duruam lidhur me bindjen ndaj Allahut. Rezistuam që të mos kundërshtonim Allahun e Madhëruar. – thanë ata.*

Atëherë, atyre u thuhet:

- *Hyni në Xhenet!*



Dr. Murat Kaja

Asnjë ndodhi nuk është pa shkak. Para çdo ndodhie ekziston një shkak që e nxjerr atë në pah. Edhe gjërat të cilat shihen si rastësi, kanë një shkak që nuk është zbuluar ende.

Ndërsa mrekullia është një ndodhi që nuk ngjan me të zakonshmen dhe ndryshon prej saj. Pra, është ndryshimi i të zakonshmes. Padyshim se edhe në këtë rast ekziston një shkak që e ndryshon atë. Nëse ky shkak nuk është një prej shkaqeve që përdor Krijuesi i Madhëruar, pra, ligjeve (të natyrës) që ka vendosur Ai, atëherë është vetë Krijuesi shkak i parë dhe i vërtetë.

Në fakt edhe ndër individët e një lloji, të cilët jemi mësuar t'i shohim gjithmonë të njëjtë, ekziston ndonjë mrekulli. Kjo, sepse çdo krijesë që lind, ka aspekte të veçanta prej të ngjashmëve të vet. Për shkak se këto veçori dalluese të saj janë jashtë të zakonshmes, kjo na ofron ne një shembull të mrekullisë. Për shembull, nëse shohim portokaj të ndryshëm, do të vërejmë se çdonjëri prej tyre është ndryshe nga tjetri. Dhe çdonjëri prej tyre është një mrekulli në vete. Edhe fillimi i krijesave apo ndodhive që jemi mësuar t'i shohim gjithmonë të njëjta, ka qenë një mrekulli për njerëzit, derisa ata janë mësuar me to. Madje edhe fundi i tyre do të jetë një mrekulli më vete. Atëherë, jeta jonë qëndron midis dy mrekullive dhe gjatë kësaj kohe, herë pas here ndodhin edhe mrekulli të tjera.

Ja pra, edhe në jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), kanë ndodhur shumë mrekulli të mëdha. Disa persona që ndiqnin gjurmët e idhujtarëve, herë-herë shpreheshin se Profeti (a.s.), bënte një jetë krejtësisht larg mrekullive. Madje, duke e paraqitur atë me cilësi, si “gjeni”, “hero” apo “komandant”, përpiqeshin të mohonin “profecinë” e tij. Mirëpo, para së gjithash, Rasulullahu (a.s.), ishte profet dhe, veçoria më e rëndësishme e profetëve ishte shfaqja e mrekullive. Nisur nga kjo, edhe Profeti ynë (a.s.), ka shfaqur shumë mrekulli, të cilat janë transmetuar me zinxhir të saktë. Në fakt, shpallja e Kuranit dhe profecia, ishin mrekulli më vete. Po ashtu, edhe ndodhia e Isras dhe Miraxhit, është një nga mrekullitë, e cila është lajmëruar në Kuranin Fisnik dhe hadithet e sakta.

Përveç Kuranit Fisnik, që ishte dhe mrekullia më e madhe e Profetit tonë (a.s.), një pjesë e mrekullive për të cilat kanë dëshmuar njerëzit e asaj kohe, janë edhe këto:

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

“Ishte afruar koha e namazit të ikindisë. Njerëzit po kërkonin ujë për të marrë abdest, mirëpo nuk mundën të gjenin. Rasulullahut (a.s.), iu soll pak ujë (aq sa mund të merrte abdest një person). Ai e futi dorën e tij të bekuar në enën me ujë dhe u tha njerëzve të merrnin abdest prej aty. Unë pashë

se poshtë gishtave të Rasulullahut (a.s.), rrodhi ujë derisa morën abdest të gjithë sahabët e pranishëm.” (Buhari, Vudu’, 32, Menakib, 25.)

Kjo ndodhi ka ngjarë në vendin e quajtur Zeura, që ishte edhe vendi i pazarit të Medinës. Aty ishin të pranishëm rreth treqind vetë prej sahabëve. (Buhari, Menakib, 25; Muslim, Fedail, 6.)

* * *

Përsëri **Enesi** (r.a.), tregon:

“Në kohën e Profetit (a.s.), në Medinë ra një thatësirë e madhe. Kur Profeti (a.s.), po mbante hutben në një ditë xhumaje, një person u ngrit në këmbë dhe tha:

“O Rasulallah! Tufat e kuajve dhe të deleve u shuan. Lutuni Allahut të Madhëruar që të na falë shi!”

Rasulallahu (a.s.), ngriti menjëherë duart dhe filloi të lutej.

Atë moment, filloi të frynte një erë dhe në qiell, që pak më parë ishte xham i pastër, filluan të formoheshin retë. Më pas, retë u mblodhën dhe filloi të binte shi me gjyma. Ne dolëm nga mesxhidi dhe shkua në shtëpitë tona duke kaluar nëpër ujë. Shi vazhdoi të binte pa pushim deri në xhumanë tjetër. Gjatë kohës së xhumasë, u ngrit përsëri ai person (ose dikush tjetër) dhe para Rasulullahut (a.s.), tha:

“O Rasulallah! Po na shemben shtëpitë. Sikur t’i luteshit Allahut që ta ndalonte shiun!”

Rasulallahu (a.s.), buzëqeshi dhe më pas u lut duke thënë:

“O Allah! Lësho shi përreth nesh, e jo mbi ne!”

Unë pashë retë që filluan të hapeshin dhe formuan një kurorë përreth Medinës.” (Buhari, Menakib, 25.)

* * *

Xhabir bin Abdillahi (r.a.), tregon:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), zakonisht e mbante hutben e xhumasë i mbështetur në një dru apo trung hurme. Një person prej ensarëve tha:

“O Rasulallah! A t’ju bëjmë një minber?” Rasulullahu (a.s.), tha:

“Bëjeni nëse dëshironi!”

Ata bënë një minber për Profetin (a.s.) dhe, kur ai hipi në minber për hutben e xhumasë, trangu i hurmës filloi të rënkonte si fëmijë.

Profeti (a.s.), zbriti poshtë dhe e përqafoi trangun. Ndërsa ai qante si një fëmijë të cilin të tjerët mundohen ta qetësojnë.

Rasulallahu (a.s.), tha:

“Ai qau për shkak se mbeti larg dhikrit/përmendjes së Allahut, që bëhej afër tij!” (Buhari, Menakib, 25; Ahmed, III, 300.)

* * *

Djali i **Ebu Bekrit, Abdurrahmani** (r.anhuma), tregon:

“Gjatë një udhëtimi, ishim njëqind e tridhjetë vetë së bashku me Rasulullahun (a.s.), i cili tha:

“A ka dikush prej jush diçka për të ngrënë?”

Kërkuam dhe gjetëm diçka për të ngrënë tek njëri prej nesh. Ne e bluam atë dhe e bëmë brumë. Më pas, aty u shfaq një idhujtar me flokë e trup të gjatë dhe i shpupurishur, i cili kishte me vete një tufë delesh. I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti:

“A i shet delet, apo i solle si dhuratë?”

“Jo janë në shitje!” – tha idhujtari.

Profeti (a.s.), bleu një dele prej atij dhe e therëm. Si fillim, Profeti na urdhëroi të skuqim mëlçinë e deles. Beto hem në Allahun se Profeti (a.s.), priste nga një pjesë prej kësaj mëlçie dhe ua ndante të njëqind e tridhjetë personave që ndodheshin aty. Madje, pjesën e atyre që nuk ndodheshin aty, e ruajtën dhe ua dhanë kur erdhën. Më pas, Profeti (a.s.), e futi delen në dy enë dhe e poqi. Edhe pse të gjithë personat që ndodheshin në udhëtim hëngrën e u ngopën, ushqimi mbeti e teproi. Prandaj, ne e ngarkuam mbi deve ushqimin e mbetur dhe e morëm me vete. (Buhari, Hibe, 28; Buhari, Buju, 99.)

* * *

Xhabir bin Abdillahi (r.a.), tregon se babai i tij vdiq duke lënë borxhe pas. Për këtë arsye, ai shkoi tek Profeti (a.s.) dhe i tha:

“Babai im ka lënë borxhe pas. Mirëpo, unë nuk kam asgjë tjetër përveç prodhimit që do të japë kopshti me hurma që kishte ai. Dhe prodhimi që do të japë ky kopsht me hurma për disa vite me radhë, nuk mjafton për ta larë borxhin. Prandaj, ejani me mua të shkojmë tek dhënësit e borxhit që të mos më flasin keq e të mos më bëjnë presion!”

Rasulullahu (a.s.), erdhi përreth një grumbulli me hurma që kisha mbledhur dhe u lut. Pastaj të njëjtën gjë e bëri edhe me një grumbull hurmash të tjera. Më pas u ul në krye të hurmave dhe tha:

“Merrni prej këtyre hurmave dhe paguani borxhin!”

Xhabiri (r.a.), i pagoi të gjitha borxhet dhe mbetën po aq hurma sa u dha atyre.” (Buhari, Menakib, 25.)

SHEMBJA E

MË 1204 DHE FILLIMI I PRAPAMBETJES EKONOM

✦ *Dr. Ardian Muhaj* ✦

Në gjysmën e dytë të shekullit XII perandoria Bizantine përjetoi kriza të cilat e dobësuan si shtet. Këtyre iu shtuan synimet e kryqtarëve evropianë të cilët e panë Perandorinë Bizantine si objektiv të ekspansionizmit të tyre. Goditja më e rëndë ishte kryqëzata e katërt e viti 1204, si pasojë e së cilës forcat kryqtare morën Kostandinopojën dhe përmbyshën Perandorinë Bizantine. Mes fuqive evropiane që kishin organizuar kryqëzatën u nënshkrua një marrëveshje për ndarjen e kësaj perandorie si plaçkë lufte, ku pjesën e luanit e mori Venediku. Me këtë rast Venediku merr edhe Durrësin me rrethina. Ndërkohë shumë me rëndësi është fakti që latinët që shpërbënë Perandorinë Bizantine mbajtën një qëndrim ekstremist fetar, duke mos e njohur patriarkanën ortodokse dhe duke shpallur ribashkimin e të dy kishave nën autoritetin e Romës, kudo ku shtrihej pushteti i tyre.¹

Edhe Durrësi si kryepeshkopatë lindore nuk i shpëtoi ekstremizmit të tillë fetar. Rezistenca e popullsisë së Durrësit për të mos iu nënshtruar një politike të tillë nuk ia arriti të ndalonte që më 1208 pas katër vite rezistence kryepeshkopata ortodokse e Durrësit të konvertohet në arqipeshkvi katolike pas pesë shekujsh kryepeshkopatë lindore me në krye një arqipeshkëv nga Trevizo, i cili pikërisht pse nuk ishte venedikas u pengua të merrte detyrën.² Në këtë rast vijmë tek një tipar thelbësor i politikës venedikase që do të qëndrojë i pandryshuar për shekuj të tërë dhe që ndikoi aq shumë në politikën e saj koloniale. Venediku nuk njihte asnjë autoritet lokal në kolonitë që pushtonte dhe krejt zinxhiri i pushtetit i takonte vetëm qytetarëve të Venecias, ndërsa popullsitë lokale përjashtoheshin nga çdo hallkë e pushtetit. Madje edhe në hierarkinë kishtarë kleri vendas synohej të përjashtohej tërësisht.

Kryqëzata e vitit 1204 apo kryqëzata e katërt siç njihet ndryshe, solli pasoja afatgjata të cilat do të përcaktonin në mënyrë të qartë dekadencën e mëtejshme të Bizantit edhe pas rikthimit të Kostandinopojës nën pushtetin bizantin. Deri në kryqëzatën e katërt Bizanti ishte një perandori, mbas kësaj kryqëzate, nga 1204-1261 ishte një koloni evropiane, dhe nga restaurimi i pjesshëm i pushtetit bizantin, u shndërrua thjesht në një qytet. Dekadencia e Perandorisë Bizantine nga kryqëzata e katërt deri në marrjen e Kostandinopojës nga osmanët, pati pasoja të rënda për krejt zonën e shtrirjes së kësaj perandorie, si edhe për vendet fqinje që kishin kontakte e kryenin shkëmbime tregtare e kulturore me këtë perandori.

Fillimi i shekullit të XIII që përkon me kryqëzatën e katërt dhe shembjen e Perandorisë

1. J. V. A Fine, *The Late Medieval Balkans: Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest*, Michigan, 1987, f. 62-63.

2. *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, bot. L. Thalloczy, K. Jirek, M. Šufflay, Vjenë, 1913, vëll. I, nr. 139.

E BIZANTIT


HIKE E KULTURORE TË BALLKANIT NË MESJETË

Bizantine shënon edhe fillimin e divergjencës në zhvillimin ekonomik të Ballkanit dhe Evropës. Deri në këtë kohë Ballkani ishte më i zhvilluar se sa Evropa katolike por natyrisht më pak i zhvilluar se sa Evropa myslimane. Pra në krahasim me pjesët e tjera të kontinentit evropian, gadishulli Ballkanik bizantin dhe gadishulli Iberik mysliman ishin pjesët më të zhvilluara ekonomikisht dhe kulturalisht.

Nga shembja e Perandorisë Bizantine zë fill dekadencia dramatike e gadishullit Ballkanik. Për këtë arsye mund të pohojmë se për tre shekuj, nga fillimi i shekullit të XIII e deri në mesin e shekullit XV Ballkani shndrohet në një hapësirë qytetëruese në krizë dhe dekadencë të vazhdueshme ekonomike e cila pasqyrohet edhe në kontributin e pakët, për të mos thënë minimal të popujve ballkanikë në qytetërimin evropian dhe mesdhetar gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë që jugu i Ballkanit i populluar nga grekët lëngonte nga anarkia dhe shkretimi demografik, forcimi i pushtetit serb në veri të gadishullit nuk pati ndonjë kontribut qytetërues të veçantë dhe madje ajo që në historiografi njihet si Perandoria Serbe e car Dushanit, nuk ishte kurrfarë perandorie por një shtet që njohu një ekspansion të befasishtëm dhe një rënie po aq të befasishme mbas vdekjes së Stefanit Dushanit. Edhe territoret shqiptare, apo jugperëndimi i Ballkanit nuk përfituan nga kjo dekadencë tragjike. Të gjendur ndërmjet pushtimit serb në veri, ndërmjet kolonizimit italian në perëndim dhe ndërmjet shtetit bizantin në krizë të thellë, shqiptarët do të vuajnë pasojat e kësaj dekadence dhe krize të thellë. Rishfaqja e shqiptarëve në skenën historike përkon pikërisht me këtë situatë dekadence të vazhdueshme. Për pasojë, shqiptarët nuk mundën të zhvillojnë një kulturë erudite të tyren, dhe as madje të nisin të shkruajnë gjuhën e tyre të lashtë. Gjuha shqipe do të fillojë të lëvrohet vetëm mbas rënies së territoreve shqiptare në sundimin osman dhe rigjallërimin ekonomik e kulturor të gadishullit që e pasoi.

Është thënë e përsëritur nga autorë të ndryshëm se shqiptarët dhe gadishulli ballkanik në përgjithësi kishin një nivel qytetërimi me Evropën perëndimore në mesjetë. Kjo është më se e vërtetë, por është e vërtetë vetëm për mesjetën e hershme, pra deri në shekullin XIII, dhe nuk është e vërtetë për mesjetën e vonë, pra ndërmjet shekujve XIII-XV. Shekulli XIII është shekulli i zhvillimit më të madh ekonomik dhe demografik të Evropës perëndimore deri në periudhën e revolucionit industrial të shekullit XIX. Nga ana tjetër pikërisht ky shekull përbën shekullin e dekadencës më dramatike të Ballkanit bizantin. Kjo dekadencë thellohet në shekujt XIV e XV. Vetëm në shekullin XVI Ballkani rifillon kurbën e ringritjes së shpejtë, e karakterizuar nga një zhvillim ekonomik dinamik dhe i qëndrueshëm që vazhdon pandërprerë deri në shekullin e XIX.

Dekadencia e perandorisë Bizantine dhe prapambetja e Ballkanit në përgjithësi në shekujt XIII-XV vërehet askund më mirë se sa në urbanizimin e pakët, dhe në kontributin e





pakët kulturor në tërësinë e kulturave mesdhetare të kohës. Kostandinopoja që deri në shekullin XIII, pra deri në kryqëzatën e katërt ishte qyteti i dytë më i madh në Evropë pas Kordovës myslimane, u shndërrua në një qytet të rëndomtë, dhe në shekullin e XIV nuk hynte as në 10 qytetet më të mëdha të Mesdheut.

Edhe në rrafshin kulturor Ballkani mbeti prapa pikërisht në këta shekuj. Ndërsa në Evropë hapen universitete sipas shembullit të universiteteve myslimane të Andaluzisë, ndërsa në Spanjën myslimane lulëzojnë shkencat e arti, ndërsa ky zhvillim përthihet gradualisht edhe nga Evropa e përtej Pirenejeve dhe ndërsa Afrika e Veriut dhe Lindja e Mesme gjithashtu vazhdojnë pandalshëm zhvillimin e tyre ekonomik, artistik dhe kulturor, Ballkani dhe Bizanti shembullojnë gjithnjë e më shumë me një hapësirë boshe kulturore në mesin e kulturave mesdhetare e evropiane.

Në këta shekuj të dekadencës tragjike të Ballkanit e Bizantit, ndërsa në Evropë dalin emra të tillë si, Ibn Haldun, Ibn Rushd, (Averroes), Ibn Arabi, Dante, Petrarka, Shën Toma i Aquinit, El Idrizi, në Ballkan e Bizant emra e kontribute të tilla mungojnë tërësisht.

Për territoret shqiptare, përveç aspektit ekonomik e kulturor që solli kjo dekadencë e Bizantit, edhe në aspektin politik e etnik, rënia e Bizantit nën sundimin kolonial evropian do të sjellë daljen në skenë dhe forcimin e shtetit mesjetar serb, që duke filluar nga ardhja në krye të tij e Stefan Nemanjës do të nisë pushtimin e trojeve të banuara etnikisht nga shqiptarët. Në vitin 1189 shteti serb i Rashës, me qendër në Sanxhakun e sotëm pushton edhe Doklenë dhe Shkodrën, si edhe pjesën më të madhe të Kosovës dhe një pjesë të Maqedonisë. Kjo do të rezultojë në një presion të madh asimilues që do të sjellë pasoja për ngjizjen dhe formësimin e identitetit etnik shqiptar. Kjo dinamikë asimiluese do të vazhdojë të shtohet përgjatë gjithë shekullit XIII, pavarësisht prej faktit se pushteti bizantin u rikthye në Kostandinopojë në gjysmëne dytë të shekullit XIII. Madje pikërisht nga fundi i shekullit XIII e deri në gjysmën e dytë të shekullit XIV, dinamika asimiluese e shtetit serb ndaj shqiptarëve do të shndërrohet në dhunë të hapur dhe e sanksionuar edhe në një tërësi ligjesh e aktesh të mbretërve mesjetarë serbë, veçanërisht të Stefan Uroshit II (1282-1321) dhe Stefan Dushanit, të vetëshpallur perandor. (1331-1355). Krijimi i kishës së pavarur serbe në vitin 1219 që më pas do të ketë si qendër Pejën, ishte një faktor më shumë në këtë proces asimilimi të dhunshëm etnik e fetar.³ Dushani pushtoi të gjitha trojet shqiptare deri në Vlorë, Janinë e Thesali. Kjo u shoqërua me konvertimin e dhunshëm në ritin pravosllav të ortodoksëve të ritit bizantin, por edhe të atyre që konsideroheshin si “heretikë”, pra të katolikëve dhe bogomilëve.

Kjo u sanksionua edhe me ligj në kodin e njohur si Kodi i Stefan Dushanit. Dënimet për ata që nuk pranonin të konvertoheshin në ritin pravosllav ushtroheshin në krejt territoret e banuara nga shqiptarët dhe përfshinin masa të tilla si konfiskimin e pasurisë, shpërnguljen dhe dëbimin, prerjen e gjymtyrëve e deri në dënimin me vdekje. Dënimi për katolikët dhe bogomilët në rast se zbuloheshin se mbas konvertimit në ritin pravosllav kishin ushtruar ritin latin ose fenë bogomile, ishte që të damkoseshin me hekur të skuqur në fytyrë dhe të dëboheshin. I njëjti dënim i jepej edhe atyre që kishin dijeni për ta dhe nuk i kishin raportuar tek autoritetet⁴. Natyrisht asnjë ipeshkëv katolik nuk guxonte të qëndronte në këtë shtet dhe të gjithë që nuk ishin detyruar të konvertohen kishin marrë arratinë dhe jetonin si refugjatë kryesisht në Dalmaci.

3. Kjo situatë e vështirë situatë veçanërisht në raporte të bashkëkohësve evropianë siç janë dëshmia anonime e vitit 1308 *Anonymi descriptio Europae orientalis*, bot. Olgierd Gorka, Krakov, 1916; dhe ajo e vitit 1332 e Guljelm Adamit, “Directorium ad passagium faciendum per Phillipum regem Franciaie in terram sanctam anno 1332”, në *Recueil des historiens des Croisades. Documents arméniens* II, Paris, 1906.

4. Neni 10 i Zakonikut apo Kodit të Stefan Dushanit. A. V Solovjev, *Zakonik cara Stefana Dušana 1349. i 1354. godine*, Beograd, 1929.

Big Bangu

i Dijes

Jetojmë në një univers shumë kompleks. Ne nuk kemi as mendje dhe as fuqi të mjaftueshme për të peshuar, matur, kontrolluar dhe vëzhguar çdo gjë. Duket sikur çdo gjë lëviz zakonshëm në mënyrë monotone me pakontrollueshmërinë e saj. Ndërkohë që na ka ardhur në majë të hundës nga njerëzit që nuk arrijnë të komandojnë qoftë edhe disa persona që i kanë nën përgjegjësi, brenda këtij universi ku lëvizin me miliarda nëpunës. Mjafton vetëm një “urdhër” që të funksionojë sistemi që vazhdon prej miliarda vitesh... Ja pra, kjo është historia e “Kun fejekun / Bëhu, e ajo bëhet!” dhe “Ikra-s / Lexo!”... Bëhu, që të lexohet...

Shkrimtarëve që harrojnë të hapin kllapat në fund të fjalisë “materia ka tri gjendje”, duhet t’u hapësh kllapat, sepse ka edhe një gjendje, e cila ngjall universin dhe nuk e lë në errësirë të plotë. E ajo është “Dija”. Në ADN-në tonë nuk ka qoftë edhe një germë të vetme. Gjithçka përbëhet vetëm prej disa atomeve. Lulet janë thjesht disa modele ndërtesash që janë bërë brenda farave prej “Firmës së ndërtimit”. Ndërsa duartrokitjet dhe lëvdatat që bëhen nga entuziazmi që ndihet ndaj disa veprave të artit, nuk janë për punëtorët që punojnë në atë firmë, por për arkitektin që mban në dorë planin e atyre ndërtesave delikate. Ajo që kapim, që mbajmë erë dhe që shohim (që pandehim), është vetëm informacion që formohet në trurin tonë.

CEREMONIA MORTORE E SHKENCËS DHE VARREZA E VRIMËS SË ZEZË...

Shpresa e astronomëve të cilët i kthejnë teleskopët e tyre nga qielli, është informacioni/dija brenda një tufe drite. Aty ku nuk ka dritë apo ndryshim, është e pamundur të flasim për dije. Përndryshe, a do të mund ta kishim kuptuar këtë univers të gjerë dhjetë miliard vite dritë? Njerëzit pandehin se mund të



shpjegojnë gjithçka me shkencën e tyre. Mirëpo, kur shohin vrimat e zeza, përballen mbase me formën më absolute të urdhrit “çdokush do ta shijojë vdekjen”. Kjo, sepse edhe drita që është burimi i dijes, pranë një vrime të zezë është me një këmbë në varr dhe ashtu si e dehur, nuk mund t’i shpëtojë tabutit të mosnjohjes. Për këtë arsye, shkenca, në fakt është një “dallim” që shënohet nga rezultatet që shkaktojnë ndryshimet e vogla të cilat realizohen në kushtet që i shohim gjithmonë...

Ato që bëjnë të mundur të dëgjojmë zërin e njëri-tjetrit, që bëhen oksigjen dhe na mbushin mushkëritë, që shëtitin lehtësisht “si të ishin zot shtëpie” në aparatet e komplikuar të luleve dhe që sigurojnë çdo ditë komunikimin në telefonat tanë, nuk janë gjë tjetër përveçse grimca të vogla. World Wide Web (www), na tregon vetëm faktin se merimanga e informacionit/dijes e ka mbuluar botën me rrjeta. Ndërsa kurorën e “dijes”, mund ta vendosë vetëm Një Qenie që di të fshehtën e çdo gjëje, e jo grimcat që nuk kanë as sy, as mendje dhe as vullnet. Pikërisht këtu fillon edhe udhëtimi i dijes. Big Bang-u (shpërthimi i madh), nuk është një term që na tregon shpërthimin e një pike me një masë pafundësisht të vogël, por shpjegon shndërrimin në gjendjen “Bëhu!” të dijes së fshehur në të... Derisa artet të njohin Artistin me gjuhën e tyre, ta duan dhe ta përmendin Atë...

TEORIA E INFORMACIONIT (DIJE-VETËDIJE)...

Nëse shkencëtarët arrijnë të bëhen piktorë, meri-

tojnë çmimin Nobel. Zbulimet që kanë bërë ata që kanë mundur të shohin nga një dritare e gjerë, nuk ndryshon prej pikturave të bëra mbi kanavacë. Detajet duhen menduar, por çështja kryesore është të numërosh planetët si rruaza tespihesh, të shohësh prej së larti e të zhytesh në thellësi. Natyrisht, pa u harruar “imameja”¹...

Mirëpo, ne përsëri jemi të detyruar të shkojmë në vende të largëta për të shëtitur “ekspozitat e ideve”! Tom Steiner, në librin e tij që botoi para shumë vitesh me titull, “Information and The Internal Structure of the Universe- Informacioni dhe Struktura e brendshme e Universit, 1990), sikur na bën të dëgjojmë kërcitjen e rruazave të tespiheve në duart tona... Grimca më e vogël në univers, është quajtur “foton”. Steiner, këtij termi i ka shtuar edhe informacionin, duke u përpjekur të shpjegojë se edhe grimca më e vogël në univers përmban informacion. (“infor” simbolizon bashkimin e fjalës foton dhe informacion). Ja pra, ky përkufizim, e shpjegon në mënyrën më të bukur faktin se përse drita që nuk i shpëton vrimës së zezë, nuk arrin t’i ftojë shkencëtarët në ceremoninë e vet mortore. Sepse, nëse s’ka dritë, nuk ka as informacion...

Tani ndodhemi në kohën kur kemi marrë biletën e “ekzistencës” pa paguar ende asgjë dhe hyjmë në sallonin e ekspozitës. Në këtë univers nuk ka vend për indiferencë. Jetojmë në një univers të stërm bushur me informacion. Po ashtu, nuk duhet të na marrë gjumi duke parë mrekullitë e krijimit...

1. -Imame: Koka ku lidhen të gjitha rruazat e tespiheve.

Lindje normale apo me operacion?

Ishin vitet e universitetit... përsëri të tensionuar hymë në një mësim... Shkaku i tensionit, nuk ishte se ishim të dobët në atë mësim, por sepse një pjesë e atyre që thuheshin në atë mësim, përçmonin vlerat në të cilat ne besonim dhe se ne ishim të detyruar të qëndronim aty. Mësimi i evolucionit...

Nuk ishin bërë as disa minuta, kur profesoresha jonë hapi temën e "lindjes normale" dhe duke qeshur bëri këtë pyetje: "Meqenëse Krijuesi bën çdo gjë në mënyrë të përsosur, atëherë përse gratë janë të detyruara të lindin fëmijë në një formë që u sjell dhimbje të mëdha?" Më pas, aludoi se nga një anë, lindja me operacion ishte më e lehtë, pa dhimbje dhe për rrjedhojë më e drejtë. Në këtë mënyrë, ajo donte të tregonte si me tallje se, "lindja normale" që u është caktuar grave që në krijim, ishte vetëm që t'u shkaktonte dhimbje atyre. Pas disa të qeshurave që nuk zgjatën shumë, ne treguam në lidhje me rezultatet e studimeve të fundit: "Studimet që janë bërë, kanë treguar se foshnjat që vijnë në jetë me lindje normale, janë më rezistentë ndaj sëmundjeve sesa foshnjat që lindin me operacion." Profesoresha ndaloi për pak çaste dhe, duke thënë se do ta shikonte këtë çështje, vazhdoi të shpjegojë mësimin.

Mirëpo, të vërtetat ishin aq të rëndësishme, sa nuk mund të kaloheshin me një përgjigje, sepse urtësitë e lindjes normale, ishin edhe më shumë se aq sa njihnim ne atëherë. Por këtë e kuptuam me kalimin e viteve...

Enigma midis nënave dhe foshnjave: Prekja...

Krijimi është thurur aq bukur, si një dantellë, saqë asnjë çast i jetës, madje asnjë gjethë peme, nuk bie në tokë pa dijen e Allahut. (shih. En'am, 59.) Në të njëjtën mënyrë, edhe një fetus që ngjizet në mitrën e nënës, që prej shndërrimit në foshnjë, e deri në momentin e lindjes normale, përmban në vete shumë urtësi. Për këtë arsye, në një farë mënyre, me anë të metodës me operacion, procesi i fundit i lindjes normale kalohet pa u realizuar, duke e përfunduar

lindjen në rrugë të shkurtër. Mirëpo, procesi i daljes në jetë të një foshnjë që është ngjizur me urtësinë hyjnore, është shumë të rëndësishëm dhe nuk duhet kaluar pa u realizuar ashtu siç duhet.

Foshnjat që lindin me operacion janë më të prira për t'u sëmurë nga rrugët e frymëmarrjes dhe astma në krahasim me foshnjat e lindura në rrugë normale, gjë e cila është vetëm një prej efekteve të lindjes me operacion.¹

Përveç kësaj, edhe bakteriet që u ngjiten foshnjave që lindin në rrugë normale, luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e sistemit themelor mbrojtës të foshnjave.²

Studimet kanë treguar se, aktiviteti i trurit tek foshnjat e lindura në rrugë normale, është më i mirë se sa ai tek foshnjat e lindura me operacion. Shkaku i kësaj, është se prodhimi i një proteine në qelizat e trurit të foshnjave të lindur në rrugë normale, është më i lartë se ai i foshnjave të lindura me operacion.³

Gjithashtu, studimet tregojnë se nëse krahasohet psikologjia e foshnjave, vihet re se foshnjat e lindura në rrugë normale i përballojnë më lehtë situatat e stresit, ndërsa foshnjat e lindura me operacion reagojnë ashpër ndaj kushteve të vështira.⁴

Përveç kësaj, është vërtetuar me statistika se kontakti i foshnjës me nënën menjëherë pas lindjes, bën që foshnja të qajë më pak, e forcon lidhjen e foshnjës me nënën dhe foshnja e ka më të lehtë të ushqehet me qumështin e nënës.

Jo më kot Xheneti është nën këmbët e nënës...

1. CC Buhimschi et al. Advantages of Vaginal Delivery, Clinical Obstetrics and Gynecology, Volume 49, Number 1, 167-183.

2. Prof. Patricia Conway, School of Biotechnology and Biomolecular Sciences at the University of NSW.

3. Julia Simon-Areces et al. Ucp2 Induced by Natural Birth Regulates Neuronal Differentiation of the Hippocampus and Related Adult Behavior. PLoS One. 2012.

4. Hannah Dahlen, Australian College of Midwives.



“Ata thanë: ‘Mos i lini kurrsesi zotat tuaj!
Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin,
as Jaukën, as Nesrin!’” (Nuh, 23)

Megjithëse profetët kanë qenë njerëz, ata kishin pozitë të veçantë tek Allahu, ishin të zgjedhur dhe u vinte shpallja prej Tij. Statusi i tyre njerëzor dhe hyjnor, është përcaktuar qartë nga vetë shpalljet e Allahut. Për shembull, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’i njoftojë njerëzit se ai është vetëm një njeri si gjithë të tjerët.¹ Përveç kësaj, Kurani e urdhëron Profetin (a.s.), t’ua bëjë të ditur njerëzve, se thesaret e Allahut nuk gjenden në dorën e tij, se ai nuk e di të shkuarën dhe të ardhmen dhe nuk është melek.²

Në këto ajete, Profeti (a.s.), urdhërohet qartë që t’u thotë njerëzve se ai nuk zotëron cilësi të shenja, sepse arabët e kohës së injorancës, nuk besonin se një profet mund të ishte njeri normal.³ Ata dëshironin me patjetër që të shihnin tek ai cilësi të jashtëzakonshme dhe të mrekullueshme.

Në fakt, nëse studiohet historia e feve, do të shihet se në imagjinatën e njerëzve, një prijësi fetar i atribuohet gjithmonë cilësi të jashtëzakonshme. Po ashtu, shihet se në këtë pikë, njeriu i kalon kufijtë dhe u atribuon atyre disa cilësi hyjnore. Dhe pikërisht kjo gjendje është edhe një nga shkaqet më të rëndësishme të shfaqjes së shirkut. Shembulli më i spikatur i këtij fenomeni në aspektin e historisë së profetëve, është Isai (a.s.).

Ai ishte një prej profetëve të mëdhenj dhe natyrisht që ishte dërguar që në radhë të parë t’u predikonte njerëzve teuhidin. Por për fat të keq, pas vdekjes së tij, për shkak të ndodhive që u zhvilluan, ai u shndërrua në një figurë të shenjtë i cili besohet se është biri i Zotit. Madje, ata që i besojnë kësaj feje, shkojnë aq larg sa pretendojnë se Isai (a.s.), është Vetë Zoti.

Ky devijim, nuk është vetëm në lidhje me profetët, por vlen edhe për të mëdhenjtë e fesë siç janë shenjtorët, evliatë, njerëzit e mirë etj. Disa prej tyre

u konsideruan se kishin cilësi mbinjerëzore kur ishin ende në jetë, e disa të tjerë pas vdekjes. Njerëzit u luteshin, u kërkonin ndihmë dhe i merrnin si ndër-mjetës të Allahut.

Gjatë gjithë historisë, gjithmonë ka pasur njerëz të cilët kanë ecur në vijën e drejtë të teuhidit, kanë qenë të devotshëm dhe njerëz të mirë, të cilët ndiqeshin nga njerëz të shumtë. Por për fat të keq, ka pasur edhe prej atyre të cilëve u janë atribuar cilësi mbinjerëzore, duke u shenjtëruar nga ana e ndjekësve të tyre të devotshëm. Kurani bën fjalë për idhujt Vedd, Suva, Jeguth, Jauk dhe Nesr.⁴ Shpjegimet në lidhje me këtë ajet në librat e tefsirëve, janë shumë të rëndësishme për të treguar se si me kalimin e kohës njerëzit e mirë janë shndërruar në idhuj.

Emrat e idhujve që përmenden në ajet, janë emrat e disa njerëzve të mirë që kanë jetuar më parë. Pas vdekjes së këtyre njerëzve, admiruesit e tyre kanë ngritur statuja në shenjë nderi dhe respekti ndaj tyre. Por për fat të keq, me kalimin e një kohe të gjatë, qëllimi i vërtetë i ndërtimit të këtyre statujave u harrua dhe ata filluan të shihen si zota të shenjtë. Po ashtu, Kurani na bën të ditur se edhe hebrenjtë dhe të krishterët i kanë idhujtarizuar të mëdhenjtë e feve të tyre, gjë e cila në fakt përbën një devijim shumë serioz. Ky nuk është vetëm një evidentim, por në të njëjtën kohë, është bërë edhe një paralajmërim i rëndësishëm për ne si përfaqësuesit e fundit të teuhidit/monoteizmit të vërtetë mbi tokë.

Shfaqja e një respekti të tepruar ndaj njerëzve dhe madhërimiti i tyre, është një nga llojet e shirkut. Për rrjedhojë, edhe Profeti (a.s.), nuk e ka aprovuar respektin e tepruar ndaj njeriut, përfshi edhe ndaj vetë atij dhe, lidhur me këtë na ka paralajmëruar: “Mos më lavdëroni në mënyrë të tepruar ashtu siç e lavdërojnë të krishterët Isain birin e Merjemes! Unë jam vetëm rob i Zotit. Prandaj thoni, “Robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij”” (Buhari, Enbija, 48.)

1. shih. Kehf, 110; Fussilet, 6.

2. shih. En’am, 50.

3. shih. Furkan, 7.

4. shih. Nuh, 23.



Ky veprim i Profetit (a.s.), na jep këto kritere: Asnjë njeri nuk është në nivelin e profetëve dhe, përderisa as profetëve nuk mund t'u jepet një status i mbinatyrshtëm, atëherë duhet qëndruar larg edhe shenjtërimit të njerëzve të tjerë. Për rrjedhojë, respekti dhe madhërimi që tregohet ndaj Allahut, nuk mund të tregohet për asnjë krijesë tjetër. Lidhur me këtë çështje, ne duhet t'i mbajmë nën kontroll të gjitha mendimet, ndjenjat dhe sjelljet tona. Ashtu siç sillemi me maturi ndaj atyre që jetojnë, ashtu duhet të sillemi edhe ndaj atyre që kanë vdekur. Varret e tyre duhet t'i vizitojmë për të kujtuar vdekjen dhe për të marrë shembull prej jetës së tyre shembullore. Por asnjëherë nuk duhet t'i lutemi atyre duke prituri ndonjë dobi prej tyre, apo duke i bërë ata ndërmjetës të Allahut. Kjo, sepse ne adhurojmë vetëm Allahun dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë. Gjithashtu, duhet theksuar se mendimet e tilla si, "filan elvija i di veprat e njerëzve", nuk përputhen aspak me besimin e teuhidit. Ky besim i gabuar, me vetëdije apo pa vetëdije, nënkupton se përveç Allahut ka edhe të tjerë që dinë të fshehtat. Për fat të keq, këto lloj besimesh, pranohen si normale në disa rrethe të caktuara. Por në fakt, ky është një devijim shumë serioz, sepse të fshehtën/gajbin e di vetëm Allahu i Madhëruar. Dija, shikimi dhe dëgjimi i Tij, janë të pakufishëm. Për këtë arsye, besimtarët e dinë mirë se ata ndodhen vetëm nën kontrollin e Tij. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik, urdhërohet: **"...Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni!"** (Hadid, 4)

Përveç këtyre, myslimanët besojnë se vetëm profetët janë të mbrojtur nga gjynahet. Për rrjedhojë, një person mund të jetë shumë i devotshëm dhe i virtytshëm. Njerëzit mund të përfitojnë prej moralit të tij të lartë dhe personalitetit të tij shembullor. Por

të gjitha këto virtyte nuk nënkuptojnë se ai është i ruajtur prej gabimeve dhe gjynaheve. Një besimtar mysliman nuk duhet të veprojë kurrë në mënyrë të atillë, që të tregojë respekt të tepruar ndaj ndokujt apo diçkaje. Ai nuk e konsideron të ruajtur prej gabimeve një person për shkak të mendimeve dhe virtyteve të tij të larta, sepse e di mirë se edhe nëse një person është shumë i devotshëm, ai mund të bëjë gjynahe dhe mund të gabojë në zgjedhje dhe mendime. Për rrjedhojë, myslimani nuk duhet të kërkojë asnjë urtësi pas mendimeve dhe sjelljeve të një personi të tillë.

Gjithashtu, ky person nuk konsiderohet si dikush që nuk mund të kundërshtohet dhe t'i vihen në diskutim mendimet dhe sjelljet. Përndryshe, kjo do të thotë që njeriu të mohojë veten e tij. Nga ana tjetër, përveç sahabëve që janë përgëzuar me Xhenet, askujt nuk i është garantuar shpëtimi i përjetshëm. Mbi të gjitha, a nuk është vetëm Allahu Ai që i njeh robërit e Tij në mënyrën më të përsosur!? Për këtë arsye, besimtari nuk dyshon aspak në këtë të vërtetë.

Nëse besimtari është i sigurt për virtytet e larta të një personi, ai mund të mendojë se ky person mund të jetë prej të dashurve të Allahut. Madje ai ushqen mendime të mira në lidhje me të dhe përpiqet të përfitojë prej jetës së tij shembullore. Por ai kursesi nuk mund t'i aprovojë besimet e gabuara që pretendojnë se Zoti është mishëruar apo është shfaqur tek dikush që pranohet si njeri i mirë. Gjithashtu, besimtari i konsideron si të gabuara edhe besimet që i atribuojnë dikujt cilësi mbinatyrore, saqë po ta thërrasë dikush në ndihmë ai i shkon menjëherë në ndihmë kudo që të ndodhet. Sepse kjo nuk përputhet aspak me besimin në parimin e teuhidit të cilin e përsëritim në çdo rekat të namazit kur themi: **"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!"**



Profeti (a.s.), ka thënë:

“Padyshim se shejtani shëtit
si gjaku në trupin e njeriut!”

(Muslim, Selam, 24)

Ishin ditët e fundit të Ramazanit të Bekuar. Si për çdo vit, i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte hyrë në itikaf në xhami dhe i ishte përkushtuar edhe më tepër adhurimit. Një natë i erdhi për vizitë gruaja e tij Safijja (r.anha). Pasi biseduan për një farë kohe, nëna jonë Safijja (r.anha), u ngrit për t’u kthyer në shtëpinë e saj në lagjen e Usame bin Zejdit. Profeti (a.s.) u ngrit bashkë me të për ta përcjellë. Kur arritën tek dera e xhamisë, dy persona që kaluan aty pranë, dhanë selam dhe i shpejtuan hapat e tyre. Mbase kanë menduar që të mos e shqetësojnë Profetin (a.s.), ndërkohë që ishte bashkë me gruan e tij. Mirëpo, i Dërguari i Allahut (a.s.), ndjeu një farë sikleti prej kësaj dhe pasi i thirri dy personat pranë vetes, bëri një shpjegim që ata nuk e prisnin: “*Kjo grua pranë meje, është Safijje binti Hujej (pra është gruaja ime, nuk është e huaj).*”

Të dy personat u habitën jashtë mase dhe thanë me një gojë, “subhanallah, si mund të mendojmë ndryshe për ju o i Dërguar i Allahut!?” Me këtë, ata deshën të tregonin se Profeti (a.s.), nuk kishte pse të bënte një shpjegim të tillë, e mbase edhe u fyen disi. Mirëpo, ky Profet i mëshirshëm, të cilin Allahu e ka lavdëruar për kujdesin e madh që tregon ndaj umetit të vet, dëshironte të pengonte shejtanin që të dëmtonte besimin e tyre me vesveset dhe dyshimet që mund t’u hidhte. Për këtë arsye ai ua shpjegoi këtë veprim me këto fjalë: “*Padyshim se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut. Unë u shqetësova se mos shejtani hedh ndonjë dyshim të keq në zemrat tuaja!*” (Muslim, Selam, 24; Buhari, Fardu’l-humus, 4.)

Profeti ynë (a.s.), i cili i është ofruar njerëzimit si shembulli më i bukur i një robi të zgjedhur prej Allahut të Madhëruar, nuk u mbështet as në pozitën e lartë që ka tek Ai dhe as në konsideratën e pashoqe që gëzonte midis sahabëve, të cilët qëndronin përreth tij duke i thënë “të qofshin falë nëna dhe babai ynë!”.

Por edhe pse ishte pajisur me virtytet më të bukura, ai u përpoq t’u tregonte dy sahabëve se nuk po bënte asnjë punë të gabuar. Ky veprim dhe shpjegimi që i bëri ai këtij veprimi, tregon se sa e rëndësishme është kjo çështje.

Në këtë hadith, ku marrëdhënia e shejtanit me njeriun shprehet me fjalët e çuditshme, “*Padyshim se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut.*”, tërhiqet vëmendja në faktin se duhet pasur një kujdes i madh ndaj shejtanit, sepse ai vepron në mënyrë tinëzare. Ashtu si gjaku që shëtit gjithë trupin nga koka deri tek këmbët dhe rrjedh në heshtje dhe në mënyrë të vazhdueshme, ashtu edhe shejtani e rrethon njeriun me njëmijenjë hile dhe vesvese, duke e ftuar atë vazhdimisht në të keqe. Kjo, sepse ditën kur ai u mposht nga mendjemadhësia e vet dhe kundërshtoi Allahun e Madhëruar, me ç’rast edhe u dëbua prej pozitës së lartë pranë Tij, u bë armik i hapur i njeriut, të cilin e konsideroi si shkaktarin e mallkimit të vet. Për rrjedhojë, ai u betua se do të përdorte të gjitha mënyrat për ta bërë njeriun të qëndrojë larg mëshirës hyjnore:

“...Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!” (A’raf, 16-17)

Nisur nga kjo, shejtani i cili e fton njeriun në gjynahe duke iu qasur në mënyra të ndryshme, përpiqet me të gjitha forcat që ta bëjë atë të shkelë kufijtë që ka vendosur Zoti i tij. Ndihmësit më të mëdhenj të tij, janë dëshirat e egos dhe dobësitë e njeriut, sepse në një trup ku egoja egërsohet, dobësitë shtohen dhe ai nuk e dëgjon dot zërin e ndërgjegjes dhe të mendjes, nxitjet e tij nuk vonojnë shumë të kthehen në veprim. Për këtë arsye, nga një anë shejtani e nxit

njeriun të zhytet në dëshirat e kësaj bote si epshi, ngrënia, pirja, etj., ndërsa nga ana tjetër e pengon atë të ndaj mirësitë me të tjerët, të bëjë bamirësi dhe të dhurojë, duke e frikësuar me uri dhe varfëri. Nga një anë ia forcon egon duke e nxitur për mendjemadhësi dhe krenari, ndërsa nga ana tjetër e shtyn atë të mendojë dhe të sillet negativisht ndaj të tjerëve. Ai thotë gjithmonë se thotë të vërtetën dhe ia zbukuron njeriut çdo të keqe që bën.¹ Dhe për më shumë, ai e mashtron njeriun me premtime boshe.² Në këtë mënyrë, ai përpiket që njeriu të shndërrohet në një qenie egoiste, të dhënë pas kësaj bote, të pangopur, koprrac dhe lakmitar nën robërinë e ndjenjave armiqësore si dëshirat e ulëta, urrejtja, zemërimi dhe smira, në vend që ai të jetë një qenie me virtyte morale si dashuria, vëllazëria, durimi, drejtësia, solidariteti, sakrifica dhe vetëmohimi.

Ai nuk kënaqet kurrë prej veprave të mira të robit, si pendimi, dhikri, adhurimet, pastrimit prej gjynaheve dhe afrimit ndaj Zotit. Për këtë arsye, ashtu siç përpiket ta largojë atë prej veprave të mira, ai e shtyn njeriun të tregojë edhe përtaci në detyrat e tij ndaj Zotit të vet. Ndërsa, kur njeriu fillon të kryejë adhurimet, ai ia shton vesveset që synojnë ta largojnë atë nga shpirti i vërtetë i adhurimit. Gjatë faljes së namazit, ai i kujton njeriut gjëra që më parë as që nuk i ka menduar, duke i thënë “kujto këtë, e atë!..”, me qëllim që t’i largojë përqendrimin dhe më në fund ta bëjë që të mos e dijë se sa rekate ka falur gjithsej.³

Gjurmët e shejtanit është e mundur t’i shohësh

1. shih. En’am, 43.

2. shih. Nisa, 120.

3. shih. Buhari, Ezan, 4.

në çdo ngjarje negative që është përjetuar gjatë gjithë historisë, që prej nxjerrjes së Ademit (a.s.), prej xhenetit, vrasjes së Habilit nga vëllai i tij Kabili, pretendimeve të Faraonit për Zot, e deri tek ngjarjet e fitneve midis myslimanëve. Shumë njerëz të pafajshëm që u kapluan prej nxitjeve të tij, u gremisën në gropën e gjynaheve, duke u kthyer në makina gjynahesh dhe duke kryer masakra të tmerrshme. Me pak fjalë, për shkak të farave të fitnes që mbolli ai, u shkatërruan dhe u copëtuan familjet, vendet dhe shtetet. E megjithatë, shejtani nuk ka asnjë fuqi kundra besimtarëve që strehohen tek Zoti dhe mbështeten tek Ai.⁴

Njeriu është i lirë të përdorë vullnetin e tij në të mirë, ose në të keq dhe të ndjekë ose jo shejtanin. Pikërisht për këtë arsye, kur Profeti (a.s.), thotë se shejtani shëtit si gjaku në trupin e njeriut, dëshiron që para së gjithash, të na bëjë të vetëdijshëm se vesveset e shejtanit kundër njeriut janë të pafundme. Kjo vetëdije, do ta bëjë njeriun të jetë i kujdesshëm në fjalë dhe në sjelljet e tij, me qëllim që të mos i japë mundësi nxitjeve të shejtanit, njësoj siç veproi edhe Profeti (a.s.). Në të njëjtën kohë, kjo vetëdije do të parandalojë sjelljen e nxituar në dhënien e gjykimeve ndaj të tjerëve dhe, duke menduar rolin e shejtanit në të këqijat që të bëhen, në vend që të ushqesh urrejtje, do të bëhet më e lehtë t’i falësh njerëzit. Padyshim se njeriu që e fiton këtë vetëdije, duhet të ketë një vullnet të fortë dhe ndihmën hyjnore që të mos e ndjekë shejtanin në rrugën që ai i ofron. Lidhur me këtë, Zoti ynë i Madhëruar na udhëzon: **“Nëse shejtani fillon të të joshë, kërko mbështetje të Allahu!..”** (Fussilet, 36)

4. Nahl, 99.



PËRGËZIMI I ISAIT عليه السلام

BESIMI NË PEJGAMBERËT

Filozofët i themelojnë sistemet e tyre filozofike duke i kritikuar dhe kundërshtuar filozofët e tjerë para tyre.

Ndërsa pejgamberët i themelojnë sistemet e tyre të besimit duke vërtetuar njëri-tjetrin.

Njëri prej principeve të një besimi të drejtë është edhe besimi në të gjithë pejgamberët e Allahut.

Nga ky aspekt, nuk ka asnjë pejgamber i cili nuk ka pranuar apo nuk ka besuar një pejgamber tjetër. Çdo pejgamber i ka besuar patjetër qoftë pejgamberëve para tij, qoftë atyre të cilët kanë jetuar në të njëjtën kohë me të.

Gjithashtu për arsye të shpalljes dhe përgëzimit nga ana e Allahut (xh.sh.), pejgamberët ishin të urdhëruar të besonin pejgamberët që do të vinin më pas dhe të përgëzonin njerëzit për ardhjen e tyre. Kështu që, çdo pejgamber i ri, konsiderohej edhe si një përgëzim i ri hyjnor.

Shembullin e fundit të të cilit e shikojmë në pejgamberin Isa (a.s.).

Në shpalljen e Zotit, në Inxhil, flitet për pejgamberin e fundit të dërguar për njerëzimin mbarë. Lajmin e ardhjes së Muhamedit (Perikli) e ka lajmëruar Isai u dhe i ka ftuar njerëzit që t'i besojnë atij.

PERIKLI / AHMED

Në lidhje me përgëzimin e Isait (a.s.), për ardhjen e pejgamberit Muhamed (a.s.), gjejmë të shkruar kështu në Inxhil (Bibël).

“Edhe unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një Mbrojtës tjetër (Perikli), që të jetë me ju përgjithmonë.” (Gjoni, 14/ 16)

Pastaj Isai, ardhjen e pejgamberit të fundit Ahmetit (a.s.), e kushtëzoi me largimin e tij nga kjo botë duke thënë:

“Por, unë po ju them të vërtetën: është më mirë për ju të shkoj, sepse po s'shkova, Mbrojtësi nuk do të vijë te ju, kurse, po shkova, do ta dërgoj te ju. E kur të vijë Ai, do ta vërtetojë se bota e ka gabim në lidhje me mëkatin, me drejtësinë dhe me dënimin. Në lidhje me mëkatin pse nuk besojnë në mua. Kam edhe shumë të tjera për t'ju thënë por tani s'mund t'i kuptoni. E kur të vijë ai Shpirti i së Vërtetës Ai do t'ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën. Ai s'do të flasë prej vetvetes, por do të flasë çka të dëgjojë dhe do t'ju zbulojë të ardhmen.” (Gjoni, 16/ 7-9, 12-13.)

Fjala “Faraklit” e përdorur në tekstin e mësipërm e ka kuptimin “hamd” falënderim.

Disa nga teologët kristianë kanë thënë se kjo fjalë do të thotë “muhal-lis” (shpëtimtar), ndërsa disa të tjerë e kanë komentuar në kuptimin “hammâd” dhe “hamîd”.

Kështu që kuptimi i saktë i fjalës “Faraklit” është tejet i qartë, që do të thotë Ahmed dhe Muhamed.

Përgëzimi i Isait për ardhjen e Muhamedit (a.s.), tregohet kështu në Inxhilin sipas Barnabas, kapitulli 39:

Dishepujt e Pyetën Jezusin (a.s.);

“Si e ka emrin Mesihu për të cilin na fole dhe si do ta kuptojmë ardhjen e tij?”

Jezusi (a.s.), u përgjigj kështu:

“Emri i Mesihut (të Dërguarit) është shumë i bukur. Kur i Madhi Zot e krijoi nurin (dritën) e tij, i dha këtë emër dhe e atë e vendosi në mes të mrekullisë qiellore. Pastaj urdhëroi dhe tha;



“Për hatrin tënd Unë krijova Xhenetin, botën dhe shumë krijesa të tjera. Të gjitha këto po t’i dhuroj ty. Ai që të vlerëson, do të ketë mirësi nga Unë; ai që të mohon, do të gjejë mallkimin Tim. Unë do të të dërgoj në tokë si të Dërguarin Tim. Fjala jote do të jetë vetëm e vërteta. Toka dhe qielli mund të zhduken, porse imani (besimi) yt do të qëndrojë përgjithmonë.”

Emir i tij do të jetë Faraklit (Ahmed).”

Në atë moment besimtarët të cilët gjendeshin përreth Jezusit (a.s.), thirrën me zë të lartë:

“O Ahmed! Hajde sa më shpejt të shpëtosh botën.”

(këtë version dhe të ngjashme me të mund t’i gjeni edhe në Ungjillin sipas Barnabas, kapitujt 41 dhe 97)

Gjithashtu Kurani Famëlartë e tregon kështu përgëzimin e Isait (a.s.), për ardhjen e Muhamedit (a.s.):

“Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: “O bijtë e Izraelit, unë jam i dërguari i Allahut tek ju, për t’ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t’ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje”. Por, kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e hapur!” (Saff, 6)

Për këtë arsye Muhamedi (a.s.), thotë:

“Unë jam duaja (lutja) e babait tim Ibrahimit, përgëzimi i vëllait tim Isait (Jezusit) dhe ëndrra e nënës sime Amine.” (Ahmed bin Hanbel, V, 262)

PATI QË E BESUAN DHE QË NUK E BESUAN

Ashtu siç e treguam edhe në shembujt e mësipërm, emri dhe cilësitë e Profetit (a.s.), përmendeshin në librat e shenjtë përpara se ai të nderonte botën me ardhjen e tij.

Lajmet për ardhjen e Pejgamberit (a.s.), janë të

qarta si në Tevrat, ashtu edhe në Inxhil.

Domethëne se dijetarët hebrej dhe të krishterë kishin informacione të qarta në lidhje me këtë temë. Pati prej atyre njerëzve të mirë, të cilët i besuan Pejgamberit (a.s.), menjëherë sapo ai shpalli profecinë e tij dhe e transmetuan atë. Në krye të këtij grupi fatlum ishte edhe mbreti i Etiopisë, Nexhashiu.

Kurani Famëlartë flet me përgëzim për atë grup prej Ehl-i Kitabit (çifutësh dhe të krishterësh), të cilët i besuan të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“...Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill.” (A’raf, 157)

Por në mesin e Ehl-i Kitabit pati edhe prej atyre që, megjithëse ishin të sigurtë për ardhjen e Pejgamberit (a.s.), vendosën të mos i besojnë. I Madhi Zot e përshkruan kështu në Kuranin e Shenjtë gjendjen e atyre që ishin të mirëinformuar për profecinë e Muhamedit (a.s.), por që nuk i besuan:

“Atyre që u kemi dhënë Librin, e njohin atë, ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë.” (Bekare, 146)

Në fakt fshehja e kësaj të vërtete dhe mohimi i mesazhit të Pejgamberit r ishte thjesht një vendim i atyre që po vepronin duke bërë një gabim të tillë. Të gjitha kontradiktat, mospranimet, konfliktet dhe qëndrimet larg nga e vërteta, ishin produkt i vetë gabimeve të tyre.

Ata le të mendojnë dhe të flasin atë çka dëshirojnë, edhe pse Isai (a.s.), e ka përgëzuar ardhjen e Ahmedit r dhe i ka besuar përpara se ai të nderonte njerëzimin me ardhjen e tij në këtë botë.

Edhe Muhamedi (a.s.), e ka vërtetuar profecinë e Isait u dhe kur fliste për të thoshte “vëllai im”.

E NJËJTA DUA, I NJËJTI PËRGËZIM I ALLAHUT

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në një hadith;

“Unë jam përgëzimi i vëllait tim Isait...” Që do të thotë se në thelb mesazhi i Pejgamberit (a.s.), mesazhi i Isait u dhe mesazhi i të gjithë pejgamberëve, të tjerë, është plotësisht i njëjtë. Vetëm se, pasuesit e pejgamberëve të mëparshëm e ndryshuan librin e Allahut dhe mesazhin e profetit të dërguar tek ata dhe për këtë arsye i Madhi Zot zgjodhi si mëshirë për të gjithë botërat pejgamberin e fundit Muhamed Musatafanë së bashku me një libër të ri, Kuranin, dhe për të gjithë njerëzimin përcaktoi si fe Islamin.

Prandaj themi se koncepti i tevhidit si për pejgamberët e mëparshëm, ashtu edhe për Isain (a.s.), ishte në përputhje të plotë me konceptin e tevhidit të Muhamedit (a.s.).

Një ditë i Dërguari i Allahut (a.s.), përsëriti fjalët e Ibrahimit t:

“O Zoti im, ata kanë shman-gur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime, ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë.” (Ibrahim, 36)

Më pas përsëriti fjalët e Isait (a.s.):

“Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Maide, 118)

Pastaj ngriti duart lart dhe qau duke u lutur:

“O Allah, ruaje ymetin tim, mëshiroje ymetin tim!”

Atëherë i Madhi Zot e urdhëroi Xhebrailin dhe i tha;

“O Xhebrail! Shko dhe pyete Muhamedin se përse qan!” (E Allahu e din më së miri çdo gjë).

Xhebraili erdhi tek Pejgamberi r dhe ai i tha se qante për shkak të shqetësimit që ndjente për ymetin e tij. Kur u kthye Xhebraili dhe tregoi përse qante Pejgamberi (a.s.), atëherë i Madhi Zot (xh.sh.), tha:

“O Xhebrail! Shko tek Muhamedi dhe jepi atij lajmin e mirë se “në lidhje me ymetin tënd do të të bëjmë të ndjehesh gjithmonë i kënaqur me të dhe kurrë nuk do të lejojmë që të mërzitesh.” (Muslim, Iman, 346.)

Ebu Dhërri (r.a.), shprehet kështu:

“Një natë, i Dërguari i Allahut (a.s.), fali namaz dhe lexoi ajetin 118 të sures Maide (ajetin e përmendur

më lart) deri në mëngjes. E lexoi këtë ajet madje edhe në ruku e në sexhde...” (Ahmed, V, 149.)

Muhamedi (a.s.), i cili me mirësinë e Allahut përmban cilësitë më të bukura të të gjithë profetëve, me përsëritjen e lutjes së Isait (a.s.), shpreh shpirtin dhe zemrën e unifikuar me vëllain e tij pejgamber.

LOTËSIMI I MORALIT TË BUKUR

Siç dihet, Isai (a.s.), ishte dërguar për t'i mësuar njerëzimit moralin e lartë dhe jetën mistike në këtë botë. Kështu që, gjatë gjithë jetës së tij, u mësoi dhe u predikoi njerëzve moralin e bukur.

Kjo e vërtetë është gjithashtu një nga shkaqet e dërgimit të Muhamedit (a.s.). Ai (a.s.), urdhëron dhe thotë:

“Allahu (xh.sh.), më ka dërguar për të plotësuar moralin e bukur.” (Muvatta, 904; Bejhaki, es-Sunnetul-Kubra, X, 192.)

Muhamedi (a.s.), jetoi i veshur me petkun e një morali aq të bukur, sa që kush e shikonte fytyrën e tij nuk ia ndante dot sytë, sikur të kishte parë hënën e plotë në një natë të pastër pa re.

Një nga dijetarët hebenj të asaj kohe, Abdullah bin Selami (r.a.), kur e kishte parë fytyrën e ndritur të Dërguarit të Allahut (a.s.), kishte thënë:

“Kjo fytyrë nuk gënjen!” Më pas kishte pranuar Islamin.

BETIMI HYJNOR...

Për shkak të moralit të lartë që kishte, Pejgamberi r u cilësua në

Kuranin Famëlartë si “usve-i haseneh/she-mbulli më i mirë”

Në suren Kalem i thuhet “me betimin hyjnor”;

“S’ka dyshim se ti je me virtyte madhështore.”

Në këtë mënyrë u vërtetua përgëzimi hyjnor për të cilin lajmëronte Isai (a.s.), me fjalët “Profeti i lavdëruar/Ahmedi”

AJO ÇKA I TAKON NJERËZIMIT

Ajo çka i takon njerëzimit është përqafimi fort i kësaj mirësie hyjnore, përlulja me respekt e bindje përpara mesazhit dhe mësimëve të tij profetike.

Përlulja dhe respekti përpara këtij përgëzimi hyjnor është detyrë për të gjithë njerëzimin... Sidomos për Ehl-i Kitab (pasuesit e Librit), të cilët duhet të garojnë të parët për t'i besuar Pejgamberit të fundit të Zotit (a.s.), si domosdoshmëri e përgëzimit të Isait (a.s.), për ardhjen e tij.

*Muhamedi (a.s.), është
pejgamberi i fundit për mbarë
njerëzimin dhe mundësia e
patjetërsueshme e fitimit të kësaj
bote dhe Ahiretit. Ajo që i takon
të gjithë njerëzimit mbarë është,
përqafimi fort pas kësaj mirësie të
madhe të Zotit; përlulja me zemër
e me shpirt përpara urtësisë dhe
begatisë që ai solli.*

Ndërsa ata të cilët nuk e shikojnë këtë domosdoshmëri dhe zgjedhin mohimin, paralajmërohen kështu nga i Madhi Zot në ajetet e Kuranit:

“O ithtarë të Librit! Përse i mohoni shpalljet e Allahut (Kurandin), edhe pse jeni dëshmitarë se ato janë të vërteta?” (Ali Imran, 70)

“O ithtarët e Librit! Përse e pësjtjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?” (Ali Imran, 71)

Megjithëse këto ajete kanë zbritur si shkak i mosbesimit të Ehl-i Kitabit (Pasuesëve të Librit), në kohën kur atyre u ishte bërë e qartë vërtetësia e Pejgamberit (a.s.), por nuk e pranonin për shkak të egoizmit të tyre, ato (ajete) përfshijnë të gjithë ata të cilët gjenden në të njëjtën gjendje mosbesimi.

Kjo do të thotë se qëllimi i vërtetë i çdo pune është sinqeriteti.

Shumica e atyre që e mohonin të Dërguarin e Allahut (a.s.), nuk kishin asnjë fije dyshimi në profecinë e tij, por nuk dëshironin ta pranonin për shkak të interesave të tyre. Domethënë treguan mungesë të sinqeritetit në karakterin e tyre. E devijuan rrugëtimin e tyre të drejtë dhe përfunduan në humbje të përvetshme.

RRUGA E DREJTË ËSHTË E LIDHUR NGUSHT ME SINQERITETIN

Në çfarëdo gjendje që të ndodhet njeriu, rëndësia e devotshmërisë dhe sinqeritetit në adhurimet ndaj Zotit është shumë e lartë.

Nëse njeriu ka një zemër të pastër dhe të sinqertë në rrugën e Allahut, ai vazhdon të ecë në rrugë të drejtë. Nëse nuk e ka, atëherë humbet drejtimin dhe mbetet larg Allahut dhe të Dërguarit të tij.

ÇDO MUAJ DUHET KONSIDERUAR SI RAMAZAN

Bukuritë fizike dhe shpirtërore që përjetuam gjatë muajit të begatë të Ramazanit, klimën e bereqetit dhe mirësisë që përjetuam këtë muaj, duhet ta vazhdojmë edhe gjatë muajve të tjerë të vitit. Me adhurimet dhe me veprat tona të mira, duhet ta bëjmë ramazan gjithë jetën tonë. Ashtu sikurse edukonin të parët tanë me moton:

“Çdonjërin që sheh konceptoje Hidër, ndërsa çdo natë si Kadër.”

Është obligim për ne të mbartim në çdo muaj dhe në çdo stinë, cilësitë tona të larta të bujarisë, mikpritjes, ndihmës për të tjerët, strehës për të varfrit, udhëzimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

Gjatë Ramazanit ne e kemi të ndaluar madje edhe ushqimin hallall, sepse po agjërojmë. Atëherë, le të mendojmë thellë se sa e rëndësishme është të qen-

drojmë larg harameve dhe gjërave të dyshimta...

Mos të harrojmë se agjërimi është një mundësi e madhe mirësie e cila forcon tek njeriu anën shpirtërore, duke na afruar me melekët e Zotit. Njeriu agjëruar përfiton një gradë të lartë të anës shpirtërore të melekëve, sepse për shkak të agjëritit fuqia fizike e njeriut ulet e si përfundim edhe gjynahet pakësohen. Asnjë adhurim (ibadet) nuk është kaq ndikues në kontrollin e nefsit (egos) sa ç’është agjërimi.

Kjo formë, është forma më e bukur njerëzore, e cila i nevojitet atij për gjatë gjithë jetës.

Kështu që detyra jonë si robër të Zotit dhe kujdesi që duhet të tregojmë në kryerjen e adhurimeve, nuk duhet të jenë të kufizuar vetëm përgjatë muajit të Ramazanit. Begatia e Ramazanit duhet të përfshijë të gjitha momentet e jetës. Ajo krijon një urë të fortë lidhëse të trupit përmes sprovës së urisë, që lufton egoizmin, që frenon gjynahet dhe përsos zemrën përmes përmendjes në çdo moment të Madhësisë së Zotit (xh.sh.).

Përpjekjet për të qenë pjesë e mëshirës, faljes dhe banorëve të Xhenetit, kurrsesi nuk duhet të kthehen në një përpjekje e cila tregohet vetëm në muajt e Ramazanit. Momentet e fundit të jetës tonë nuk dihen se në cilin muaj apo në cilën ditë do jenë. Kështu që për t’u përgatitur përballë kësaj fshehtësie, na duhet të ecim në rrugëtimin tonë me vepra të mira, me sinqeritet e me zemër, me po atë begati shpirtërore, e cila na pushton gjatë muajit të Ramazanit.

Derisa të bashkohemi me njerëzit e sinqertë dhe të devotshëm. Derisa sinqeriteti të shndërrohet në kandilin e rrugëtimin tonë. Derisa të radhitemi në mesin e atyre të cilët fituan dashurinë dhe ndërmjetësimin e Profetit (a.s.). Derisa të bëhemi pjesë e karvanit të thirrjes së të Madhit Zot;

“O ti shpirt i qetësuar!

Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!

Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27-30)

O Allah! Mundësoja secilit nga ne besimin e pastër, dashurinë, përkushtimin dhe shërbimin në rrugën e të Dashurit Tënd, të cilin e dërgove si myzhden më të madhe për mbarë njerëzimin!

Udhëzoji edhe ata të cilët nuk e kanë njohur akoma mesazhin Tënd madhështor! Atyre që u mundësove udhëzimin dhe mirësinë Tënde, dhuroju një jetë të pastër, të sinqertë dhe të devotshme!

Amin!..



EL-MUHEJMIN

AI QË SHEH DHE MBIKËQYR

Ilir Hoxha

Emri “Muhejmin”, i cili rrjedh prej rrënjës “hejme-ne”, që në fjalor ka kuptimin, “*të marrësh diçka nën mbikëqyrje, ta mbrosh dhe ta drejtosh*”, do të thotë, “*Ai që drejton të gjitha çështjet e gjithësisë*”.

Ai që mbikëqyr diçka dhe e mbron atë, ai është “muhejmini” i saj. Allahu i njuh të gjitha kushtet për të ruajtur vazhdimësinë e ekzistencës së asaj që ka krijuar, kujdeset për të, e mbikëqyr, ia di veprat, rrizkun e shpërblimin e saj dhe e mbron atë. Dhe mbrojtja e tyre prej rreziqeve që kërcënojnë ekzistencën e tyre, është pjesë e manifestimit të këtij emri. Në sajë të këtyre manifestimeve, ne mund ta ruajmë ekzistencën tonë në formë të plotë, duke shpëtuar prej shpërbërjes dhe humbjes. Ashtu siç është mbrojtja e tërësisë sonë fizike kusht për vazhdimin e jetës sonë materiale, ashtu edhe mbrojtja e tërësisë së shpirtit, është e njëjtë për jetën tonë shpirtërore.

Pra, mendimet, ndjenjat, synimet, dëshirat dhe kërkesat tona duhet të jenë në përputhje dhe në mbështetje të njëra-tjetrës, me qëllim që të arrijmë të ruajmë shëndetin tonë mendor dhe shpirtëror. Për këtë arsye, ky emër ka një marrëdhënie të ngushtë me qetësinë e zemrës.

Të dish se kemi një Zot, që është i vetëdijshëm për gjithçka, që i di të gjitha nevojat tona dhe i plotëson ato, që na mbikëqyr e na ruan nga afër dhe që i di gjërat që ne dëshirojmë të realizohen, na ndihmon t’i pranojmë si mirësi të Tij kur ato realizohen dhe si caktim të Tij kur ato nuk realizohen, duke qenë në një harmoni të përsosur me gjithësinë. Ky është burimi i paqes.

Ashtu siç mbikëqyr dhe drejton “të gjitha çështjet e gjithësisë”, Allahu mbikëqyr dhe mbron vazhdimisht

edhe njerëzit, të cilët janë elementi më i dalluar i kësaj gjithësie. Mistikët, trajtojnë më tepër këtë kuptim të këtij emri fisnik, sepse vetëm kjo vetëdije mund ta ngrejë njeriun në shkallën e “mirësisë”. Të jetojmë gjithmonë me vetëdijen se gjithçka që bëjmë e veprimë është vazhdimisht nën mbikëqyrje, jo vetëm që do të na çojë përpara, por përfshi edhe kohën pasi të ketë përfunduar kjo jetë, vetëdija se nuk do të humbasë qoftë edhe një mirësi apo një e keqe e vogël, është garancia më e mirë e vazhdimësisë së veprave tona. Kjo, sepse vetëm nëse ne besojmë se Allahu sheh çdo gjendje tonën dhe mbikëqyr edhe qëllimet tona më të fshehta, ne mund të vazhdojmë bamirësitë pa pasur nevojë që njerëzit t’i vënë re, t’i dinë apo t’i lavdërojnë. Madje, mund të zhvillojmë vetëdijen e ruajtjes edhe prej të këqijave më të fshehta. Këtë, e quajmë vetëdijen e të qenit në paqe.

Vetëdija se ndodhemi gjithmonë nën mbikëqyrjen e Allahut, nuk e devijon “njeriun Islam” në drejtime të sëmura siç ndodh në botëkuptimet e tjera ku disa prirje të pashmangshme të natyrës njerëzore, shihen si shkak i gjynahut të parë. Kjo, sepse sipas Islamit, Zoti që e krijoi njeriun, të gjitha gjendjet njerëzore -brenda kufijve legjitimë- i ka bekuar si adhurime. Shembuj të njohur të kësaj, janë edhe parimet si, “çdo kafshatë që vendos në gojën e familjes konsiderohet sadaka”, “kur e mban dorën e bashkëshortit/es me dashuri gjynahet rrjedhin dhe bien midis gishtave”, “edhe trupi ka të drejta mbi ty”, etj...

Sipas Gazaliut, ekzekutimi i efektit të Muhejminit, është në sajë të përsosmërisë në gradën e dijes, fuqisë dhe veprës hyjnore. A është e mundur të mbrosh e të kujdesesh ashtu siç duhet pa pasur dije dhe forcë



për të drejtuar? Këtë e dimë të gjithë nga përvoja jetësore.

Ndonjëherë e shohim se punët ecin gabim dhe na e merr mendja se çfarë duhet të bëjmë, por nuk kemi asgjë në dorë për të bërë diçka. Mirëpo, për Allahun, nuk mund të mendohet pamjaftueshmëri në asnjë lloj çështjeje. Ashtu siç është edhe tek të gjithë emrat e tjerë hyjnorë, edhe “dija” dhe “fuqia” vetëm tek Allahu gjenden në mënyrë absolute dhe gjithëpërfshirëse, madje në të gjitha aspektet që imagjinata njerëzore nuk mund t’i arrijë.

Sipas këtyre të dhënave, elementët e cilësisë së Muhejminit janë:

- Dija
- Mbisundimi me fuqi të mbështetur në dije
- Mbrojtja e çdo gjëje që ndodhet nën sundim

Suksesi në këto tre çështje, arrihet me dije, fuqi, mendje dhe urtësi. Dhe, personi tek i cili manifestohet ky emër, i menaxhon të gjitha punët e tij sipas këtyre cilësive. Ashtu si Allahu, i Cili e mbikëqyr dhe e ruan vazhdimisht këtë botë, duke e drejtuar me një rregull të përsosur, ashtu edhe njeriu duhet t’i bëjë punët e tij brenda një sistemi, me vëmendje, rregull dhe kujdes të madh, duke u përpjekur të ruajë të drejtat dhe vendin që i takon çdo gjëje dhe çdokujt.

Sipas Gazaliut, që ky emër të manifestohet tek një njeri, duhet që pikësepari ai njeri të njohë mirë botën e tij të brendshme (të njohë veten) dhe të përpiket që të gjitha aftësitë dhe fuqitë, moralin dhe ecurnë e jetës që i ka dhuruar Allahu, t’i përqendrojë në rrugë të drejtë. Në këtë mënyrë, robi që arrin të mbizotërojë zemrën e tij (mendimin dhe ndjenjat), fillon t’i zgjerojë kufijtë e botëkuptimit të tij, duke u përpjekur të ndikojë që edhe njerëzit e tjerë të jenë në rrugë të drejtë. Ai kujdeset për rrethin e vet dhe

e mbron atë (vetëdija për kujdesin dhe përgjegjësinë shoqërore). Kjo, do të thotë se, në këtë pikë atij i është shtuar manifestimi i emrit Muhejmin. Tashmë, një njeri i tillë zotëron intuitë dhe, duke u nisur prej pamjes së jashtme, mund të hyjë në botët e brendshme (aftësia për të interpretuar). Në këtë mënyrë, ai nuk mjaftohet vetëm me shpëtimin e vetvetes, por bëhet edhe shkak i shpëtimit të të tjerëve.

Cilësia “Muhejmin”, përmendet në dy vende të Kuranit Fisnik. Njëherë përmendet së bashku me emrat e tjerë të Allahut të Madhëruar midis ajeteve 22-24 të sures Hashr dhe njëherë tjetër përmendet në ajetin 48 të sures Maide, si cilësi e Kuranit Fisnik, që është Libri i Allahut. Nisur nga kjo, Kurani është libri i Allahut që ka fituar cilësinë “muhejmin”, si manifestim i emrit “Muhejmin” të Allahut. Në komentimin e këtij ajeti, Elmallëllë thotë: *“Ky ajet tregon se Kurani gjendet nën mbikëqyrjen e Allahut, i Cili është Muhejmin dhe është i mbrojtur nga çdo manipulim dhe tjetërsimi. Në të njëjtën kohë, ai është një argument dhe dëshmitar për të gjithë librat e tjerë para tij, duke treguar se është një gjykyes i cili do të nxjerrë në shesh të vërtetën dhe do të anulojë manipulimin. Kjo është edhe arsyeja që është e pavlefshme të veprohet me gjykimet e librave dhe ligjeve që nuk e kalojnë aprovimin e tij ose janë në kundërshtim me të.”*

Sipas mistikëve, gjithësia ekziston si rezultat i manifestimeve të emrave të Allahut në kombinacione të ndryshme. Për këtë arsye, çdo emër është i lidhur fort me të tjerët. Ndërsa sipas shpjeguesve të Esmau’l-Husna/Emrave të bukur të Allahut, emri Muhejmin, ka afërsi kuptimi me emrat e tjerë të Allahut, si Mumin, Rakib, Hafidh, Halik dhe Shehid. Madje, për shkak të rëndësisë që ka në njohjen e Zotit tonë, thuhet se është një prej emrave të Allahut edhe në librat e mëparshëm hyjnorë.



A KA EUROPA NJË PRO

— Hatem Bazian —

Zvicra ndaloi ndërtimin e xhamive, Spanja dhe Italia kanë vendosur kufizime të rënda për lejet mbi ndërtimin e xhamive të reja, dhe Austria adoptoi një ligj për të ripërkufizuar statusin e Islamit dhe të myslimanëve në vend.

Franca i ka shtrirë ndalesat te hixhabi, nikabi, e tani te burkini, dhe mbikëqyrja masive e myslimanëve në tërë kontinentin ngre një pyetje të rëndësishme: A do të ketë gjithmonë Europa një problem inkuizicioni kur merret me shtetasit e vet myslimanë?

Rrjedha aktuale e politikave që i vënë në shenjë myslimanët anekënd Europës të kthen prapa, në një periudhë më të hershme dhe më të errët në historinë e gjatë të kontinentit, në inkuizicionin spanjoll.

KUJTIM I SË SHKUARËS

Sigurisht, Inkuizicioni përfshiu konvertimin e detyruar në Krishterim për myslimanët, hebrenjtë dhe ca të krishterë, të cilët Kisha Katolike i pa si heretikë, si dhe përjashtimin për ata që refuzuan apo që në fshehtësi vazhduan të praktikojnë.

Inkuizicioni ishte një strukturë shtypëse rregullatore që i qeverisi hapësirat dhe trupat e myslimanëve dhe hebrenjve, me kufizime të vëna në veshje, në ushqim, higjienë dhe lëvizje.

Rregullimi përfshinte konsumimin e shtrënguar publik të mishit të dërrit për të demonstruar një ndarje nga mbajtja e kërkesave *kosher* dhe *hallall*.

Kërkesën për t'i mbajtur hapur dyert dhe dritaret e shtëpive të premtën dhe të shtunën, kështu që mbikëqyrësit e inkuizicionit të mund të shihnin që nuk po kryeshin aktivitete fetare apo larje rituale për falje.

Në kulm të kësaj, hebrenjtë dhe myslimanët iu

nënshtuan dhunës së organizuar të shtetit, torturës dhe sundimit të terrorit, që pati si përfundim dëbimin masiv nga Spanja në vitin 1492.

Moriskot, myslimanët të cilët e përjetuan konvertimin katolik me forcë por qëndruan në Spanjë, u dëbuan në 1609-n, dhe përfunduan në Afrikën e Veriut.

Përgjigjja e pritshme e industrisë së islamofobisë ndaj krahasimit të ngjashmërive midis Inkuizicionit dhe asaj që po ngjet sot do të jetë mospranimi, dhe ndoshta konsiderimi i gabuar, sepse Europa po përballet me terroristët myslimanë dhe me kërcënimet për sigurinë.

Ndërsa pranoj se Europa po përballet me sulme terroriste, përqendrimi vetëm te myslimanët, kur të tjerë terroristë janë njëlloj kërcënim, është problematik. Ai tregon një tendenciozitet të qartë përzgjedhës mbi bazën e identitetit të supozuar evropian.

RREGULLIMI I TRUPAVE

Politika shtypëse dhe struktura rregullatore të adoptuara nga vendet evropiane u diktuan gjithashtu gjatë periudhës së gjatë koloniale.

Si një femër apo mashkull mysliman duhet të vishet, të vepronte, të hante e të “që i civilizuar” u shkrua me gjakun e shumë shtetasve myslimanë në Afrikën e Veriut, në nënkontinentin indian, në Afrikën Nënahariane, e në pjesën qendrore të sotme të botës arabe.

Rregullimi i hapësirës dhe trupit të shtetasit mysliman është ndërthurur në mënyrë epistemike në ligjërimet e shkuara dhe të tashme evropiane.

Vlerësimi i Europës se rregullimi dhe administrimi i hapësirave dhe trupave të tyre po ndërmerret në mbrojtje të shekullarizmit dhe demokracisë është i gabuar kur matet me parimin e lirisë dhe zgjedhjes individuale.



PROBLEMI INKUIZICIONI?

Këtu stereotipet historike mbi myslimanët dalin në sipërfaqe edhe një herë, duke i lejuar europianët ta legjitimojnë rregullimin në mbrojtje të një të drejte të femrës myslimane për të zgjedhur, si dhe të çlirimit të saj nga shtypja e mashkullit të keq dhe të paqytetëruar.

Ky argument evropian i vjetëruar dhe i tejpendorur po i mëshon përsëri tropit të meshkujve të bardhë që i shpëtojnë femrat zijoshe nga e keqja dhe dhuna e meshkujve zijoshtë. Debatet rreth hixhabit të femrave myslimane në Europë janë kapitulli i fundit i një libri racist të mirëdokumentuar që u mohon femrave lirinë e zgjedhjes në jetën e tyre normale të përditshme.

NDRYSHIM SHOQËROR

Këtu, ashtu si në kohën e inkuizicionit spanjoll, Europa është në mesin e kundërshtimit masiv demografik, politik, social, ekonomik dhe fetar, që po projektohet me myslimanët si tjetri dallues.

Hebrenjtë qenë vënë në shenjë për një kohë të gjatë në Europë si koka turku për sfidat dhe dështimet e brendshme apo të jashtme, dhe tani myslimanët po fajësohen me shpresën që të bëhen të heshtin të gjitha pikëpamjet kundërshtuese mbi atë se ç'loj shoqërie do të ketë Europa në të ardhmen.

Kufizimet sot janë imponuar në emër të shekullarizimit evropian apo të mbrojtjes së tij, por objektivi mbetet shtetasi mysliman, ashtu si 60 vite më parë ishte shtetasi hebre. Nisja e një inkuizicioni fundamentalist shekullar ndryshon pak nëse pasoja është e njëjtë për viktimat.

Fundi i kryqëzatave, vdekja e një të tretës së popullsisë europiane gjatë Murtajës së Madhe, paqëndrueshmëria politike dhe konfliktet fetare ishin faktorët kyç shtytës për valët e ndryshme të inkuizicionit anembanë Europës.

Tani nxitjet përfshijnë emigracionin, ndërhyrjen e Irakut, luftën civile siriane, paqëndrueshmërinë ekonomike dhe idetë e ndryshme mbi projektin evropian. Inkuizicioni mbi subjektin mysliman është një mënyrë e lehtë për ta vënë në diskutim identitetin e Europës në mes të krizave shoqërore, politike dhe ekonomike.

NJË IDENTITET EUROPIAN?

Inkuizicioni dëshmoi ndërtimin e një identiteti të dalluar evropian, të sjellë rreth bardhësisë dhe të bashkuar me Krishterimin, që nënkuptonte flakjen jashtë të tjetrit, hebreut dhe myslimanit, për të arritur te “pastërtia e racës”, apo te “i pastër për burimin” epistemik.

Europa kaloi më pas nëpër luftëra të mëdha fetare, politike dhe ekonomike, midis Protestantizmit dhe Katolicizimit për atë se vizioni i cilës shoqëri do të mbizotëronte. Inkuizicioni ishte një instrument për të mbrojtur rendin ekzistues dhe për t'i dhënë mbështetje ortodoksisë katolike.

Europa e sotme është në mesin e një krize identiteti të përqendruar rreth projektit të Bashkimit Evropian dhe pyetjeve se cili duhet t'i përkasë atij dhe cili duhet lënë jashtë.

Ortodoksia shekulare dhe ekonomike po përdoren për të përcaktuar anëtarësinë dhe përkatësinë në projektin evropian.

Pyetja e vërtetë që mund të bëhet kërkon të sqarojë në është Europa në gjendje të jetojë me një tjetër të brendshëm të ndryshëm e ta përfshijë atë?

Historia e Europës deri tani është dëshmi e paafësisë për të bërë kështu për çdo periudhë të vijueshme. Myslimanët e sotëm janë hebrenjtë e Europës të një të shkuare jo aq të largët, dhe koha ka për të treguar nëse e njëjta pasojë është rrjedha e diktuar për të ardhmen. Shpresoj të mos jetë kështu!

MUHAMMED HAMIDULLAH

Muhamed Gamidullah lindi në vitin 1908 në zonën e quajtur Hajdarabad (sot qendra e krahinës Anda Pradesh të Indisë), një vend në jug të gadishullit indian. Dijet e para fetare Hamidullahu i mori nga familja e tij që kishte rrënjë të forta në botën e diturisë, më pas vazhdoi shkollën nëntëvjeçare në Darululum, duke marrë edhe dije shkencore krahas atyre fetare. Gjatë kësaj kohe mësoi arabisht, persisht dhe anglisht. Ai ndoqi universitetin në Fakultetin e Juridikut në Universitetin Osmanije të Hajdarabadit, dhe bëri master në të njëjtin fakultet, në degën Jurisprudenca e shteteve. Gjatë kësaj kohe ai shkoi në qendrat e qytetërimit si Meke/ Medine, Bejrut, Damask, Kairo dhe Stamboll për të bërë studime në bibliotekat e tyre dhe punoi me dorëshkrime të ndryshme. Në vitin 1933, në sajë të një burse që fitoi, ai shkoi në Gjermani dhe më pas mbrojti tezën e tij me titull “Die Neutralitat im Islamischen Wölkerrecht/ Neutraliteti në Ligjin Internacional të Islamit.” në universitetin e Bonit duke marrë titullin “Doktor i së drejtës publike”. Më pas shkoi në Francë, në Universitetin Sorbonë të Parisi dhe përgatiti tezën e doktoraturës së dytë me titull: “La Diplomatie musulmane a l'epoque du prophete et des khalifes orthodoxes/ Diplomacia Myslimane në kohën e Profetit dhe kalifëve ortodoksë” (Paris, 1935), në fushën e histori-letërsisë. Gjatë studimeve për doktoraturë ai u njoh me disa orientalistë të mirënjohur si Paul Kahle, Fritz Krenkow, Christiaan Snouck-Hurgronje, Maurice Gaudefroy-Demombynes dhe Louis Massignon. Me to pati shkëmbime të vlefshme njohurish. Përveç dorëshkrimeve të Gjermanisë dhe Francës, ai shkoi edhe në bibliotekat e vendeve të Afrikës dhe bëri studime të gjera.

Pas studimeve dhe kërkimeve në perëndim, Ha-

midullahu u kthye në vendlindjen e tij në Hajdarabad. Në vitin 1936 filloi të jepte mësim të Historisë Islame dhe të Drejtës Penale në Fakultetin Juridik të Universitetit Osmanije. Këtë detyrë e kreu për 10 vite rresht duke edukuar nxënës në nivelin universitar dhe pasuniversitar.

Muhamed Hamidullah kryente edhe detyrën e përfaqësuesit të krahinës së Hajdarabadit në Kombet e Bashkuara, prandaj në vitin 1948 ai ndodhej në Paris tekta Hajdarabadi u pushtua nga forcat indiane. Ai nuk u kthye dot në vendin e vet, prandaj u vendos në Francë pasi mori vizë emigranti. Si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme për çlirimin e vendit të vet, qeveria indiane ia anulloi pasaportën dhe i ndaloi kthimin në atdhe. Hamidullahu nuk arriti të kthehej më në atdhe por ai nuk e humbi asnjëherë shpresën për zgjidhjen e problemit prandaj gjatë gjithë jetës nuk pranoi të merrte asnjë kombësi tjetër, por jetoi me atë që quhet: “Heimatlos” (pa-shtetësi).

Hamidullahu i kaloi pothuajse 50 vitet e fundit të jetës në Paris dhe dha kontributin e vet në hapjen e Qendrës Franceze së Kulturës Islamike, si dhe publikoi revistën mujore me emër Franca-Islami. Gjatë viteve 1954-1978 ishte studiues në Qendrën Franceze Kërkimore Shkencore dhe vizitoi shumë vende si Turqia, Egjipti dhe Pakistani në të cilat dha konferenca e seminare.

Në vitin 1932 Hamidullah shkoi në Turqi për të kryer kërkime, pas një kohe të gjatë u kthye në Stamboll në vitin 1951 për Kongresin Ndërkombëtar të Orientalistëve dhe tërhoqi vëmendjen e Prof. Dr. Zeki Velidi Togan. Ky i fundit i bëri një ftesë të cilën Hamidullahu e pranoi dhe erdhi në Universitetin e Stambollit, në fakultetin e Letërsisë, ku jepte mësim për një semestër ndërsa pjesën tjetër të vitit bënte kërkime dhe botonte studimet e veta.

Hamidullahu, që për 25 vite me radhë (nga viti 1952 deri në vitin 1977) i vazhdoi aktivitetet shkencore në Universitetin e Stambollit, mori ftesa edhe nga Universiteti i Ankarasë, fakulteti i Teologjisë dhe Universiteti Atatürk i Erzurumit, fakulteti i Shkencave Islame. Në këtë shkollë ai dha konferenca efektive dhe edukoi breza të tërë nxënësish.

Pasi doli në pension nga puna në Qendrën Françeze të Kulturës Islamike, si pasojë e shqetësimeve të pleqërisë, në vitin 1996 shkoi në Pensilvani të SHBA-së. Për një periudhë kohe ai qëndroi edhe pranë familjarëve të vet në Jacksonville, Florida. Me datën 17 dhjetor të vitit 2002, ai vdiq në shtëpinë e nipit të vet, Sedide Ataullah; pasi e kishte falur namazin e sabahut. Prof. Dr. Jusuf Zija Kavakçë i fali namazin e xhenazes dhe ai u varros në Jacksonville, në varrezat myslimane.

Muhamed Hamidullah ishte një dijetar i gjithanshëm. Ai bëri studime në fushat e jurisprudencës islame, Historisë Islame, Hadithit, Tefsirit dhe fusha të tjera. Duke qenë autori i rreth 700 artikujve shkencorë, ai u citua nga njerëz të ndryshëm. Pjesën më të madhe të veprave të veta i shkroi në gjuhët arabe, indiane, angleze, frënge dhe gjermane, por ai dinte edhe persisht, turqisht, italisht dhe rusisht. Një prej cilësive të tij më të dalluara ishte zakoni i të kontrolluarit herë pas here të materialeve që kishte shkruar duke shtuar dhe duke përmirësuar shkrimet e tij të përparshme. Tek Hamidullahu ishin bashkuar mirësjellja, zemërgjerësia, devotshmëria dhe edukata e një shkencëtari islam. Gjithsesi ai nuk u martua asnjëherë dhe nuk mori të drejtën e autorit për asnjë prej veprave të tij.

Disa prej veprave të transmetuara nga Hamidullahu janë këto:

- Revista e haditheve me titull: “Hemmam b. Munnebih es- Sahifetus- sahiha” (Hajdarâbâd 1955, 1956, 1961, 1967, Paris 1979)

- Libri në lidhje me jetën e Hz. Pejgamberit me titull: “Belazuri’nin ensabul – esraf” (Kahire 1959)

- Vepra me titull: “Reshid b. Zubejr’in ez- Zehair ve’t tuhaf” (Kuvejt 1959)

- Vepra me titull: “el- Mu’temed fi usuli’l – fikh” që flet për teologun dhe dijetarin e fikhut, Ebul Husejin el- Basriu (I – II, Damask 1385/1965)

- Një pjesë e enciklopedisë botanike me titull: “Kitabun Nebat” të Ebu Hanife ed-Dineveri. (Kairo 1973, Karaçë 1993)

- Libri: “ibn ishak’in Siretu ibn ishak’in Siretu ibn ishak’1” (Rabat 1976; Konja 1981)



Kujtesë për kujtesën

Edison Çeraj

“Kujtesa jonë është fëminore dhe ajo ruan vetëm atë që kemi nevojë.” (Milosz)

“Bradley thotë se një nga ndikimet e poezisë do të duhej të ishte ky: të na krijonte përshtypjen se po na kujton diçka të harruar, dhe jo të na zbulojë një gjë të re. Duke lexuar një poezi të bukur ne mendojmë se edhe ne mund ta kishim shkruar; se kjo poezi ka paraekzistuar tek ne. Kjo na shpie te përkufizimi që jep Platoni për poezinë: “kjo gjë e lehtë, flatrore dhe e shenjtë.” (Borges)

Marrëdhënia mes kujtesës dhe harresës është e mahnitshme dhe enigmatike në të njëjtën kohë. Po ashtu, është enigmatike ngaqë është e mahnitshme, dhe është e mahnitshme ngaqë është enigmatike.

Vazhdimësia apo pafundësia e njeriut është e lidhur ngushtë me të kujtuarit, dhe këtu bën pjesë qoftë kujtesa në kuptimin e gjurmimit të kujtimeve, qoftë kujtesa që i tejkalon këto kujtime.

Me sa duket, një nga plagët tona është edhe fakti se “harrojmë shpejt”, apo “kemi kujtesë të shkrutër”, siç dëgjojmë të thuhet herë pas here.

Harresa në këtë rast, natyrisht, nuk është ajo harresë që është e brendashkruar në natyrën njerëzore, për të cilën do flasim në vijim të kësaj eseje, por një trajtë krejt tjetër e harresës: harresa e çështjeve apo e disa prej problemeve që e kanë ndjekur njeriun që në agshol të historisë së tij, ku kujdesi apo shqetësimi ndaj tyre përcaktonte qenien si të tillë, ose, nga ana tjetër, patillësinë që shënjn shndërrimin e papërbalueshëm, që vë në pikëpyetje vetë thelbin.

Pak a shumë këtë gjurmon një vepër si ajo e Kafka-s, sidomos novela *Metamorfoza*, ku subjekti bëhet më i kapshëm. Një dukuri tipike e kohës sonë është tkurrja e aftësisë sonë për të komunikuar qenësishëm (rrjedhojë: vetmia me njerëz) dhe, nga ana tjetër, zhvillimi i aftësisë për të komunikuar me kafshë të ndryshme të buta apo të egra (rrjedhojë: kafsha është pjesëtar, me emër, me personalitet).

Kur flasim për kujtesën, njëkohësisht jemi duke folur edhe për harresën, si dhe *vice versa*. Është e pamundur të ndodhë ndryshe – nuk mund të ndahen, megjithëse janë dy gjendje krejt të ndryshme. Kjo

shënon anën enigmatike të çështjes.

Ekuilibri i mundshëm dhe jo i përsosur që duhet pasur parasysh mes kujtesës dhe harresës është i mundur vetëm duke ndrequr dhe përmirësuar marrëdhënien tonë me kujtesën: për aq sa do jemi të prirë të kërkojmë përmbushjen e vazhdueshme qenësore, e jo vetëm atë lëndore, po aq do jemi në harmoni edhe me harresën. Ndër të tjera nuk do kemi ngërçe, të llojit të harros të harros, apo të kujtohes të kujtos.

Por, Borges-i pikas edhe këtë: “Defekti më i madh i harrimit është se nganjëherë përfshihet në kujtesë.”

Lloji i harresës që po trajtojmë nuk është pasojë e jetesës në “hartën e realitetit”, por kjo e fundit është pasojë e harresës sonë.

Një pasojë tjetër për t’u përmendur (kujtuar) është edhe lloji i njeriut Funes, një personazh i Borges-it, i cili kujton gjithçka, “një njeri me kujtesë totale, i paaftë që të arsyetojë, sepse është i paaftë që të filtrojë.” (Eco)

Kështu, është fare e kuptueshme ajo që thotë Borges-i, se të gjithë mësuesit e mëdhenj të njerëzimit, kanë dhënë mësimë gojarisht, sepse kujtesa ruhet duke i përmendur vetes dhe njëri-tjetrit të tjera gjëra nga ato që i takojnë rrjedhës së përditshme, pra jo vetëm duke shkruar ato, por duke i biseduar.

“Në lashtësi nuk kishin një kult të librit siç e kemi ne – dhe kjo nuk më befason; ata shihnin te libri një surrogato të fjalës së folur. Shprehja që përdoret shpesh, *scripta manet verba volant*, nuk ka kuptimin që fjala është jetëshkurtër, porse shkrimi ka diçka të ngurosur si vdekja. Në të kundërt, fjala ka diçka të lehtë, flatrore; diçka flatrore e të shenjtë, siç thotë Platoni.” (Borges)

Trajtimi i një çështjeje drejtpërdrejt/ballë për ballë kishte një rëndësi shumë më të madhe sesa trajtimi i saj me shkrim. Të jetosh është më e rëndësishme sesa të mendosh. Gjërat zgjidhen duke vepruar, jo duke menduar.

Do ishte vërtet mirë që kur të kujtonim t’i harronim gjërat e parëndësishme, si çlirim prej tyre; dhe kur të harronim, të riktheheshim me një kujtesë edhe më të freskët.



Një mbret kishte një kalë të bardhë të cilin e donte shumë. Një ditë u tha vartësve:

Atij, që më sjell lajmin e vdekjes së këtij kali të bardhë do t'i fluturojë koka, prandaj bëni shumë kujdes, sepse këtë kalë e dua si sytë e ballit.

Një ditë, si çdo gjallesë tjetër edhe kalit i erdhi koha e vdekjes. Por askush nuk guxonte të lajmëronte mbretin për vdekjen e kalit. Më në fund kryenallbani çohet në këmbë dhe vendos të shkojë të lajmërojë mbretin për vdekjen e kalit. Kryenallbani, pasi del në audiencë të mbretit, i thotë:

Shkëlqesi! Kali juaj i bardhë është shtrirë, ka mbyllur sytë, është fryrë dhe nuk merr frymë fare.

Mbreti i thotë: Thuaj që kali ka vdekur.

Kryenallbani: shkëlqesi! Ka vdekur po thoni ju, jo unë.

Në këtë mënyrë kryenallbani shpëtoi veten nga vdekja e sigurt.

Mënyra si flasim ndryshon shumë gjëra.

Kali i bardhë dhe mbreti



NJË LUTJE

“Askush prej jush të mos dëshirojë vdekjen për shkak të vështirësive. Nëse patjetër dëshiron vdekjen, atëherë të thotë: O Zoti im! Nëse jeta ime është më e mirë për mua mos ma merr jetën.

Nëse vdekja është më e mirë për mua atëherë më merr shpirtin”

(Buhari, Merda,19)

AFORIZËM

“Fytyra tregon ngjyrën e zemrës.”

Dante Aligheri

FAKTE INTERESANTE

Presioni që ushtron zemra mjafton për ta ngritur gjakun në 10 metra lartësi.

Shkretëtira e Saharasë është shkretëtira më e madhe në botë. Ajo është një sipërfaqe gjigante prej 9.000.000 km²

Geopardi arrin shpejtësinë 103 Km/h për 3 sekonda.

TEUBEJA-ISTIGFARI

si ripërtëritje e ndërgjegjes

Dr. Husein Rizai

Pendimi është begati e dhuruar prej Allahut Fuqiptotë, e cila ruan shoqërinë nga shkatërrimi. Pendimi është dhunti e madhe prej Allahut, sepse sikur të mos ishte mëshira dhe butësia e Tij me njerëzit dhe ligjësimi i pendimit (teubes) dhe i kërkimit të faljes (istigfarit) për njerëzimin, njerëzit do të shkatërroheshin ose do ta shkatërronin njëri-tjetrin dhe kështu do të shkaktonte kaos, trazirë, turbullirë dhe çrregullim i paparë. Pendimi në mënyrë të sigurtë dhe nga brendësia e shpirtit, është adhurim dhe njëkohësisht është një mjet për rikthimin e vlerave të humbura më parë. Është mënyra për ripërtëritjen e jetës fetare dhe të besimit, si dhe rruga për riparimin e marrëdhënieve/raporteve

të prishura me Zotin (xh.sh.). Allahu i madhërishëm e ka krijuar njeriun me një natyrë të ndryshme nga krijesat e tjera; me potencial për t'u orientuar edhe kah e mira edhe kah e keqja. Njeriu i krijuar në formën më të bukur, nëse orientohet drejt së keqes, mund të bjerë në një shkallë më të ulët se kafshët. Ajo që kërkohet nga njeriu është që ai gjithmonë të orientohet kah e mira dhe, duke jetuar një jetë në përputhje me urdhëresat dhe ndalesat e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, ta fitojë lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Megjithatë, nga dobësitë që ngërthen në vete dhe nga ndikimet mjedisore, me vetëdije apo pa vetëdije, njeriu kohë pas kohe zhytet në mëkate. Allahu i madhërishëm, duke i falur robërit e vet nëpërmjet “pendesës dhe kërkimit të faljes”, ka hapur një “derë të mëshirës” për t'i shpëtuar. Teubeja-istigfari do të thotë: të ndjerit keqardhje apo pendim nga gjynahu

i vepruar, vendosmëri për të mos u kthyer më në të dhe kërkim i faljes nga Allahu (xh.sh.). Në fakt, meqë teubeja gjithnjë shprehet bashkë me istigfarin, sikur është bërë sinonim i tij. Kur këto dy fjalë, teube dhe istigfar, përdoren së bashku (gjithmonë istigfari duke u pasuar nga teubeja), atëherë e para (istigfari) do të thotë kërkim i sigurisë nga e keqja dhe nga dëmi i asaj që ka ndodhur, dhe e dyta (teubeja) do të thotë kthim tek Allahu dhe lutje për sigurim nga e keqja e asaj për të cilën njeriu ka frikë në të ardhmen. Si pasojë, të bëhet vetëm istigfar, pa teube- (largohesh nga një e keqe, por nuk drejtohesh nga e mira; largohesh nga imoraliteti dhe i drejtohesh alkoolit), nuk do të ishte e plotë. Për të qenë pendimi i plotë duhet të largohesh nga harami dhe t'i drejtohesh të mirës, hallallit apo Allahut fuqiptotë .

Teubeja (pendimi) dhe istigfari (kërkimi i faljes) i bëhet vetëm Allahut dhe askujt tjetër. E kundërta e kësaj është doktrinë krishtere, ku falës i mëkateve është ndërmjetësi i Zotit, që lë të kuptosh se vjedh prej rolit të Zotit. Sipas doktrinës krishtere, njeriu lind me fajin e trashëguar, faj që bartet prej gjeneratës në gjeneratë, për shkak se, sipas tyre, babai i njerëzimit, Adami (Ademi a.s.) e ka bërë mëkatin në Xhenet dhe është hedhur në këtë botë dhe tani njerëzit brez pas brezi e trashëgojnë fajin/mëkatin e Adamit; derisa është dashur që “Zoti” (hasha) ta sakrifikojë vetveten nëpërmjet Jezu Krishtit dhe ta shlyejë mëkatin të cilin e ka bërë babai i njerëzimit (Adami).

DISPOZITAT PËR PRANIMIN E TEUBES

Për çdo punë ekzistojnë rregulla dhe në këtë rast, gjithsesi Allahu (xh.sh.), peygamberi (a.s.), por edhe peygamberët e tjerë gjatë historisë na i kanë treguar rregullat, rrugën ose mënyrën se si kemi mundësi t'i drejtohemi Krijuesit për falje dhe udhëzim. I Madhi Zot në Kuranin Famëllartë thotë: *“O ju që keni besuar, pendohuni te Allahu me një pendim të sinqertë, në mënyrë që Zoti juaj t'i largojë prej jush të këqijat, t'u shpjerë në xhenete, nën të cilat rrjedhin lumenj, Ditën kur Allahu nuk e turpëron Pejgamberin, e së bashku me të as ata që kanë besuar. Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: “Zoti*

ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve. Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send”. (Tahrim, 8). Në ajetin e lartpërmendur është përmendur fjala **en-nasuh** – i sinqertë, i pastër, i cili është në formën sipërore, duke pasur qëllim stërmadhimin e madhërimit, siç mund të themi: **shekkur** – falënderues i madh, apo **sabbur**-durimtar i madh. Rrënja e fjalës **nesaha** ka kuptimin: pastrimi dhe çlirimi i një gjëje prej mashtrimit dhe mbeturinave të ndryshme të padëshiruara. Me rrënjën kryesore të kësaj fjale lidhet gjithashtu fjala **khalesa** - i sinqertë, i pastër. Sinqeriteti është një realitet pa të cilin nuk plotësohet asnjë punë dhe as që arrihet ndonjë bekim nga ana e Allahut Fuqiptotë, nëse qëllimi nuk është i mirë dhe i pastër. Kështu, sinqeriteti në pendim, do të thotë: pastrimi dhe çlirimi i tij prej çdo lloj mashtrimit, mangësie apo kundërvajtjeje, si dhe prezantimi i tij në formën më të plotë.

*O ju që keni besuar,
pendohuni te Allahu me
një pendim të sinqertë,
në mënyrë që Zoti juaj t'i
largojë prej jush të këqijat,
t'u shpjerë në xhenete, nën
të cilat rrjedhin lumenj,
ditën kur Allahu nuk e
turpëron Pejgamberin, e së
bashku me të as ata
që kanë besuar...*

Në anën tjetër, edhe praktika e peygamberit lë të kuptosh se teubeja nuk duhet bërë vetëm me majë të gjuhës duke shqiptuar dy tri fjalë, por ajo është një veprim që duhet realizuar me vetëdije. Sikurse edhe çdo ibadet tjetër, edhe teubeja dhe istigfari duhet të bëhen me sinqeritet të plotë, dhe është shumë e rëndësishme që të mos hezitohet. Allahu i Madhëruar i posedon atributet si “Afuv”- shumë falës, “Gafur”- shumë faljedhures. Kur robi kërkon falje nga Zoti atëherë vijnë në shprehje këto cilësi të Allahut. E kush i pranon të gjitha ato gjynahe kur robi kërkon falje? Atë e bën

“Tevvabi”, Ai që pranon pendimin e robërve te Tij. Emri ka ardhur në formën Fe'al, që përdoret për të shprehur hipërbolizim, dhe në këtë rast, për të shprehur pranimin e shumtë të pendimit nga njerëzit. Peygamberi (a.s.), ka thënë: *“Nëse dikush bën ndonjë mëkat dhe pastaj merr abdest bukur, çohet e fal dy rekatë namaz dhe kërkon falje nga Allahu, Allahu me siguri do ta falë.”* Dhe si përforcim të këtij fakti, lexon ajetin: *“Ata të cilët, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun e i kërkojnë falje për gjynahet e tyre, e kush i fal gjynahet përveç Allahut?”* (Ali Imran, 135). Nga ky këndvështrim mund të përfundojmë se Allahu fuqiptotë, për të promovuar cilësinë e mëshirës, thotë: **Thuaj: “E kujt është e tërë kjo në qiej e tokë?” Thuaj: “Vetëm**

e Allahut". Ai ia bëri Vetes obligim mëshirën. Ai do t'ju tubojë në Ditën e Gjykimit, për të cilën gjë nuk ka dyshim. Ata që i shkaktuan humbje vetvetes, ata nuk besojnë." (En'am, 12), që le të kuptojmë se çdo punë e bën me mëshirë dhe se pranimit i pendesës bëhet me mëshirën e Tij të pakufishme.

Allahu (xh.sh.), robërve që i drejtohen Atij me teube dhe istigfar të singertë ua pranon teuben dhe kërkon që mos ta humbin shpresën për gabimet e bëra. Në Kuranin famëlartë u drejtohet robërve duke u thënë: **Thuaj: "O robërit e Mi të cilët e keni ngarkuar veten tuaj me shumë gabime, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që fal shumë dhe është mëshirues!"** (Zumer, 53). Ky ajet është shumë shpresëdhënëse për njeriun dhe shërben si ilaç për shërimin e plagës. Ky ajet thotë se sado që të kesh gjynahe, sado që të jetosh larg Zotit, nëse i drejtohesh Allahut dhe i thua: "O Zot, unë pendohem te Ti", Allahu të pranon dhe të fal. Posaçërisht shpresëdhënëse janë fjalët: **"O robërit e Mi"**, megjithëse Ai mund t'u drejtohej me fjalët: "O kriminelë ose o gjynahqarë." Në anën tjetër, shpresëdhënëse janë edhe fjalët: **"Që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe"**, sepse Allahu (xh.sh.), nuk i përmend gjynahet që janë bërë, nuk e përmend imoralitetin (zinanë), vjedhjen, ryshfetet, sharjet etj. dhe këtë e bën me të vetmin qëllim që të mos i trazojë ndjenjat e asnjërit nga robërit e Tij. Nuk ekziston ndonjë mëkat që Allahu nuk e fal dhe nuk ka ndonjë mëkatar që Allahu t'ia mbyllë derën e pendimit për shkak të madhësisë së mëkatit të tij, sepse falja dhe amnistia e Allahut (xh.sh.), është shumë e gjerë dhe e madhe.

PASTËRTIA PAS TEUBES

Duke u pastruar nga mëkatet nëpërmjet teubes, robi pothuajse kthehet prapë në pastërtinë esenciale dhe të lindur (fitër). Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Ai që pendohet nga mëkati, është si ai që nuk ka bërë mëkat." Teubeja e bërë me seriozitet dhe me keqardhje apo pendim të vërtetë, mundëson faljen e gjynaheve. Në lidhje me këtë Muhamedi (a.s.), ka thënë: "Allahu i lavdëruar dhe i madhërishtëm urdhëron: 'O robërit

e mi! Mëkatarë që keni ngelur jashtë atyre të cilët i kam falur. Kërkoni falje nga Unë, që t'ju fal mëkatet. Kush e njuh faljen Time dhe kërkon falje, atë do ta fal, çfarëdo qoftë gabimi i tij." Pastrimin e ndërgegjes nëpërmjet pendimit, Muhamedi (a.s.), e shpjegon me këtë krahasim të bukur: "Kur robi bën një gabim, në zemrën e tij shfaqet një pikë e zezë. Në rast se heq dorë nga mëkati, pra kërkon falje, pendohet dhe i kthehet Allahut, zemra i pastrohet. Por, në rast se (nuk vepron kështu) i kthehet përsëri mëkatit, pika e zezë rritet dhe përfundimisht ia kaplon tërë zemrën." Pikërisht ky është ndryshku për të cilin Allahu (xh.sh.), bën fjalë në Kuran kur thotë: "Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat." Në këtë kuadër, sa domethënëse është që të përkujtohet edhe shembulli/rasti

i Pejgamberit (a.s.), të cilit i ishin falur të gjitha mëkatet e së kaluarës dhe të së ardhmes, por megjithatë në jetën e përditshme ai shpeshherë bënte teube. Për të Dërguarin e Allahut, teubeja ishte një mjet për të vendosur lidhjet me Zotin (xh.sh.), sepse Allahu i madhërishtëm i do ata që pendohen shumë. Ashtu thoshte më i Dashuri ynë, Pejgamberi (a.s.): "Zoti ynë gëzohet shumë më tepër për pendesën tuaj, se ç'gëzohet dikush që ka humbur diçka me vlerë dhe e gjen atë pikërisht atëherë kur e ka humbur shpresën se do ta gjejë."

Allahu i madhërishtëm është i kënaqur kur njeriu, me vullnetin/dëshirën e tij të lirë, largohet nga mëkati dhe i drejtohet Atij duke i kërkuar falje. Në fakt, a nuk është lutja-duaja e tij, të kërkuarit falje dhe ndihmë prej Tij, ajo që i jep vlerë njeriut te Allahu? I Dërguari i Allahut, me hadithin në vijim, sikur i jep përgjigje kësaj pyetje: "Sikur ju të mos kishit bërë asnjë mëkat, Allahu do të kishte krijuar njerëz të tjerë në vend tuaj, ata do të bënin gjynahe, pastaj do të pendoheshin dhe Allahu do t'i falte." Nga Ebu Seid El-Hudëriu transmetohet se pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Nga ata që kanë qenë para jush, ka qenë një njeri që ka mbytur 99 veta. Pastaj e kërkoi njeriun më të ditur në sipërfaqe të tokës. Ata e drejtuan te një prift, të cilit i shkoi dhe e pyeti: 'A ka teube (pendim) për një njeri që ka mbytur 99 veta?' Ai u përgjigj: 'Jo', e ky e vrau edhe këtë dhe i plotësoi njëqind. Pastaj, prapë kërkoi njeriun më të



ditur në sipërfaqe të tokës. Atë e drejtuan te një njëri i ditur dhe e pyeti: A ka teube (pendim) për një njeri që ka mbytur 100 veta? Ai iu përgjigj: “Po, e kush mund ta ndajë atë nga teubeja (pendimi)?!”. Pastaj vazhdoi: “Shko në filan vend ku ka njerëz që i bëjnë ibadet Allahut dhe adhuro Allahun së bashku me ta, e mos u kthe në vendin tënd se ai është vend i fesatit/ngatërresave”. Mori rrugën dhe pasi e kaloi gjysmën e rrugës i erdhi vdekja. Atëherë ranë në dilemë melekët. Melekët e rahmetit thanë: “Ai u pendua dhe me zemrën e tij u drejtua kah Allahu”. Melekët e dënimit thanë: “Ai kurrë një punë të mirë s’e ka bërë”. Atëherë u erdhi një melek në formë të njeriut dhe e bënë ndërmjetësues të tyre. Ai u tha: “Mateni largësinë mes dy vendeve, dhe te cili është më afër, atij i takon”. Kur e matën e panë se është më afër vendit ku ka dashur të shkojë dhe atë e morën melekët e rahmetit (Xhenetit).”

Të gjithë peygamberët ftuan për pendim dhe kërkuan falje nga Allahu. Ademi (s.a.v.s.) dhe bashkëshortja e tij Hava, pasi e kuptuan fajin e tyre, menjëherë iu drejtuan Zotit dhe kërkuan falje prej Tij. Sipas asaj që lajmëron Kurani Fisnik, ata i luteshin Zotit në këtë mënyrë. **“Zoti ynë! Ne e kemi shtënë veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi prej të humburve.”** (Araf-23). Pra, Allahu i cili është pranues i pendimit, i fali dhe ua pranoi teuben. Edhe Nuhu (a.s.), pasi e humbi djalin e tij, i cili nuk e dëgjoi dhe nuk hyri në anije, iu drejtua Zotit me fjalët: **“(Nuhu) Tha: ‘Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërkoj prej Teje atë për të cilën nuk kam njohuri, e në qoftë se Ti nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron, do të jem i humbur!’**” (Hud, 47). Në anën tjetër, Ibrahim (a.s.), dhe i biri i tij Ismaili (a.s.), i ishin drejtuar Allahut duke kërkuar prej Tij që t’ua pranojë pendimin. Allahu këtë lutje në Kuranin Fisnik na e tregon në këtë mënyrë: **“Zoti ynë, na bëj ne të dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tonë dhe falna neve, vërtet Ti je që falë shumë, je mëshirues!”** (Bekare 128). Në këto ajete e shohim mëshirën dhe butësinë e Allahut (xh. sh.), ndaj robërve të tij, që nuk mjafton me falje të mëkateve, po edhe u tregon se si të pendohen. Kjo

është një kurajë dhe mbështetje shumë e madhe për besimtarët, që të mos turpërohen të pendohen (të bëjnë teube) për mëkatet e bëra.

KOHA E TEUBES

Krahas faktit që pendimi nuk është i kushtëzuar me ndonjë kohë, vend apo kusht tjetër, në Kuranin Fisnik lavdërohen ata të cilët pendohen në kohën e agimit (seher). I Dërguari i Allahut lajmëron se Allahu i madhërishëm e shfaq mëshirën e Tij natën, në qiellin më të afërt të botës, për t’i falur robërit e vet: **“Allahu (xh.sh.), çdo natë, pasi të kalojë një e treta e parë e natës, zbret në qiellin e dynjasë (pra sheh me syrin e mëshirës) dhe thërret: ‘A ka ndonjë që më lutet e t’ia pranoj lutjen? A ka ndonjë që kërkon prej Meje e t’i përgjigjem kërkesës së tij? A ka ndonjë që më kërkon falje e Unë ta fal?’**”. Përveç

këtyre kohëve të veçanta, nga njeriu, i cili në çdo moment ballafaqohet me rrezikun e rënies në mëkat, pritet që të ndërgjegjësohet në lidhje me mëkatin e vepruar dhe menjëherë të pendohet. Kjo, për arsye se ekziston një moment në të cilin nuk pranohen pendimet, dhe ky është çasti kur njeriut i vjen vdekja, pra çasti kur shpirti vjen në grykë, ndërsa vdekja nuk dihet se kur vjen.

FJALËT QË DUHEN PËRDORUR GJATË TEUBES

Gjatë teubes-istigfarit, njeriu mund t’i zgjedhë fjalët që i pëlqejnë, mjafton që ato të burojnë nga brendia e zemrës dhe të jenë të sinqerta. Mirëpo, nëse dëshirohet që ndjenja e pendesës dhe kërkimi i faljes të shprehet me fjalët më të bukura, atëherë duhet të merren parasysh fjalët e të Dashurit tonë, peygamberit (a.s.). Ja pra, nga gjuha e tij, fjalët më të bukura të “kërkimit më të lartë të faljes/sejjidu’l-istigfar”, gjegjësisht të teubes-istigfarit (të pendimit dhe të kërkimit të faljes) nga i Dërguari i Allahut: **“O Allah, Ti je Zoti ynë, përveç Teje nuk ka zot tjetër. Ti je Krijuesi im dhe unë jam robi yt. Unë, me gjithë fuqinë time, qëndroj në fjalën që të kam dhënë dhe jam plotësisht i sigurt dhe besoj në premtimin Tënd. Unë kërkojë strehim te Ti nga e keqja e asaj që kam vepruar. Pranoj se të gjitha mirësitë e dhuruara vijnë prej Teje. Edhe mëkatet e mia i pranoj. M’i falë gjynahet, sepse përveç Teje askush tjetër nuk mund t’i falë gjynahet!”**

*“O Allah,
Ti je Zoti ynë, përveç Teje
nuk ka zot tjetër. Ti je Krijuesi im
dhe unë jam robi yt. Unë, me gjithë
fuqinë time, qëndroj në fjalën që të
kam dhënë dhe jam plotësisht i sigurt
dhe besoj në premtimin Tënd. Unë
kërkojë strehim te Ti nga e keqja e
asaj që kam vepruar. Pranoj se të
gjitha mirësitë e dhuruara vijnë prej
Teje. Edhe mëkatet e mia i pranoj.
M’i falë gjynahet, sepse përveç
Teje askush tjetër nuk mund
t’i falë gjynahet!”*



TRE GABIME

Neslihan Nur Turk

Kur birit të njeriut i ndodh një e mirë, gëzohet duke pandehur se është meritë e tij. Por kur përballet me një situatë që e konsideron të keqe, fillon të kërkojë fajtorë të tjerë përveç vetes. Mirëpo, ai që i di kushtet e besimit islam e di edhe që, “Hajrihi ue sherrihi minallahi Teala!”. Pra edhe e mira, edhe e keqja janë prej Allahut të Madhëruar! Kjo është shumë e lehtë të mësohet teorikisht dhe të përsëritet me logjikën e të mësuarit përmendsh. Mirëpo, ta kuptosh siç duhet dhe të veprosh sipas saj, është një mirësi që e kanë pasur fat shumë pak njerëz...

Ja pra, ky është edhe shkak që në përgjithësi biri i njeriut i qesh të mirës dhe i vrenjtet së keqes. Kur pasurohet, rehatohet e begatohet, ai gëzohet. Por kur varfërohet, vështirësohet e ngushtohet, ai mërzitet. Pra, ai është i prirë të falënderojë për çdo gjë që e konsideron mirësi dhe të ankohet për çdo gjë që e sheh si të keqe. Ndërkohë, ai e harron se edhe e keqja është një mirësi po aq sa e mira, se tek e mira fshihet e keqja dhe tek e keqja fshihet e mira dhe se që të dyja ndodhin si shkak i një sprove.

Në këtë shkrim do të ndalemi veçanërisht mbi të këqijat dhe do ta trajtojmë këtë çështje duke përmbledhur tri situata që e ndjellin të keqen.

Është gjë e mirë të thuhet “u bëftë më e mira”, kur na bie ndonjë fatkeqësi në jetë, fëmijë apo pasuri. Por është edhe më mirë të vrasësh mendjen se për çfarë

arsyeje mund të ketë ndodhur kjo dhe të bësh një vetëllogari të ndërgjegjes nga këto tri pikëpamje:

E PARA: NAMAZI!

Allahu i Madhëruar nuk u premtom mbrojtje robërve të Vet që nuk e falin namazin. Ndërsa atyre që e falin namazin në mënyrën e duhur, u premtom se do t'i ruajë nga amoralitetet dhe veprat e shëmtuara. Pra, të gjithë ata që nuk i falin pesë kohët e namazit, i kanë hapur derën këtyre fatkeqësive.

Në këtë pikë, nëse dikush thotë: “Unë i fal pesë kohët e namazit, por prapë nuk më ndahen problemet”, në radhë të parë duhet t'i themi këtë: “Vallë, a e ka falur ai namazin me nijetin, edukatën, vetëdijen dhe përkushtimin e duhur? Apo ka falur një namaz pa dëshirë, sa për të kaluar radhën, vetëm sepse është urdhëruar?”

Por, nëse ai thotë: “Përpiqem ta fal namazin në mënyrën e duhur, aq sa kur filloj namazin, më duket se ndahem nga kjo botë dhe shkoj në një botë të mrekullueshme prej së cilës nuk dua të kthehem më pas”. Atëherë atij i themi se duhet t'i hedhë një sy pikës së dytë. Në fakt, nëse të godet ndonjë e keqe edhe pse e fal namazin në mënyrën e duhur, është e mundur që të bëhet ndonjë gabim në pikën e dytë.

E DYTA: KUFIJTË E LIGJIT ISLAM!

Allahu i Madhëruar, me anë të Kuranit, ia bën të

qartë njeriut se brenda cilëve kufij do të jetojë i qetë. Për ata që i respektojnë kriteret dhe kufijtë e Krijuesit, mundësohet lumturia e të dyja botëve. Por për ata që për çfarëdolloj shkak i anashkalojnë dhe i shkulin kufijtë e Allahut, hapet dera e vuajtjeve.

Atyre që thonë: “Ne po e falim namazin. Çfarë të bëjmë më tepër!?” , u themi menjëherë: Mos të përzihemi në kamatë, mos t’ia ngulim sytë haramit, të kujdesimi për mbulesën e trupit dhe të zemrës sonë, të respektojmë prindërit tanë, të mos i shkëpusim lidhjet farefisnore, t’i ruajmë të drejtat e fqinjësisë, të bindemi ndaj prijësit mysliman, të mos e ndajmë Kuranin nga Suneti i Profetit, të mos shpërdorojmë dhe të mos jemi të padurueshëm ndaj fatkeqësive që na bien.

Të jemi të kënaqur me mirësitë e Allahut, ta falënderojmë e ta përkujtojmë Atë. Të adhurojmë Allahun, ta njohim e të veprojmë me dituri. Të mos shkëlim të drejtën e dikujt dhe të mos e lejojmë të shkelet. Të meditojmë, ta çmojmë mirësinë, të duam e të duhemi. Të jemi të sigurt e të besojmë tek të tjerët. Por, edhe nëse duam e besojmë, të mos tregohemi naivë. Të mos bëjmë shitblerje pa marrëveshje dhe në kundërshtim me Sunetin e Profetit.

Të mbajmë pastër jo vetëm trupin dhe shtëpinë tonë, por edhe natyrën. Le të mendojmë, sa pemë kemi mbjellë? Duhet të qëndrojmë larg smirës, thashethemeve, përgojimeve dhe të afrohem tek sinqeriteti, dashuria dhe e vërteta. Dhe të mos mjaftohemi vetëm me kaq, por të bëhemi edhe vetë besimtarë të vërtetë. Ne nuk duhet të mjaftohemi as vetëm me leximin e Kuranit, por të jetojmë me dëshirën për të zbatuar çdo ajet të tij. Le të zhvishemi disi nga hallet e kësaj bote dhe shqetësimi për botën tjetër dhe të bëjmë adhurime vetëm për kënaqësinë e Allahut. Shkurtimisht, të jetojmë sipas Kuranit dhe Sunetit.

Tani, nëse ka dikush që thotë: “Unë jam duke i bërë këto, me lejen e Allahut! Largo hem prej harameve dhe mjaftohem me hallallet. Por edhe pse bëj ç’të mundem që të jem prej njerëzve të devotshëm, përsëri më ka rënë një fatkeqësi”, në radhë të parë duhet t’i pyesim: A e ke qëllimin e pastër? Po jeton për opinionin apo për Allahun?

Nëse ju bien fatkeqësi edhe pse thoni se: “Nuk kam asnjë hall tjetër përveç kënaqësisë së Allahut!”, atëherë le të shohim pikën e tretë. Ka mundësi që të ketë ndonjë gabim në pikën e tretë:

E TRETA: HAKU I ROBIT!

Allahu nuk e harron hakun e të shtypurit dhe të atij që i është bërë padrejtësi. Kushdo që i bën të tjerët të vuajnë duke u bërë padrejtësi apo u thyen zemrën, i ka hapur derën dënimit hyjnor.

Ai që u ha hakun punonjësve, që shpif ndaj një gruaje të ndershme pa të drejtë, që e nxjerr të metën

e një tjetri në shesh, jo për ta korrigjuar por për ta turpëruar atë, që e poshtëron dikë tjetër për shkak të të metave apo gjynaheve që bën, që i gjykon të tjerët pa i njohur, që flet para e mbrapsht mbi dikë apo mbi një ngjarje pa e ditur të vërtetën e saktë dhe të gjithë ata që e thyejnë një zemër me veprime të ngjashme, duhet të presin fatkeqësinë që do t’u vijë.

Në fakt, nuk ka nevojë fare për mallkimin e të shtypurit që fatkeqësia t’u trokasë në derë këtyre njerëzve. Kjo, sepse veç një rënkim i dalë nga thyerja e zemrës, është aq djegës dhe arrin aq shpejt tek Allahu, sa që zbret përgjigjja pa pasur nevojë për asgjë tjetër. Kjo ndonjëherë realizohet duke rënë në pozitën e atij që ka turpëruar për shkak të gabimit që ka bërë, ndonjëherë i shembet shtëpia, ndonjëherë i dëmtohet pasuria, ndonjëherë i ikën qetësia familjare dhe në shumë mënyra të tjera.

Çfarë duhet bërë? Duhet parë vetja në pasqyrën e ndërgjegjes dhe të kërkohet ku është bërë gabimi. Më pas, në vend që të qahet e të ankohet, duhet menduar për të gjetur mirësinë tek e keqja. Nëse ajo e keqe bëhet shkak i pendimit për ndonjë gjynah dhe evidentimit të një gabimi për ta korrigjuar, duhet buzëqeshur.

Në fakt, besimtari është një njeri që mendon urtësinë në çdo gjë për të cilën të tjerët qajnë. Ai arrin të falënderojë duke e kuptuar të fshehtë e ndodhive për të cilat të tjerët ankohen. Po ashtu, është njeriu që qëndron fuqishëm kur të tjerët dobësohen. Ai ia arrin kësaj duke e pranuar me dëshirë çdo gjë që vjen prej të Dashurit të tij. Në fund të fundit, të gjitha vështirësitë që përjetojnë për shkak të një gabimi, do ta fshijnë atë gabim.

Nëse të është shembur shtylla e shtëpisë, para se të fajësoh dikë, shiko se në cilën bankë ke tërhequr kredi me kamatë. Nëse ke rënë pre e ndonjë Zulejhaje, kujto sa mend ke shitur kur e pandehje veten Jusuf, kujto shikimet e tua përçmuese ndaj atyre që kanë rënë pre e dëshirave të egrove të veta. Nëse pasuria të është dëmtuar, shiko se kujt nuk ia ke dhënë hakun e vet.

Këto po i përmend unë. Ndërsa ti shtoji, zgjeroji, thelloji, por mos harro kurrë një gjë: Çfarëdo e keqe të të gjejë, dije se është paralajmërim prej Zotit! Ai nuk bën kurrë padrejtësi. Prandaj shiko se problemi është tek ti!

Në fakt edhe ata që falen rregullisht në mënyrën e duhur, i respektojnë kufijtë e Allahut dhe nuk i hyjnë askujt në hak, mund të sprovohen me vështirësi. Mirëpo, ata janë besimtarë të devotshëm, të cilët ndajnë kënaqësi prej çdo gjëje që vjen prej Allahut. Vështirësitë që përjetojnë ata, janë për të ngritur gradën e tyre të devotshmërisë.

O Allah bamirës e bujar! Mos na ndaj prej këtyre njerëzve të mirë dhe zemrave të tyre! Amin!



ANA SHPIRTËRORE E TRURIT

Universi është në një gjendje të ndërthurur, ku çdo gjë është e lidhur me tjetrën. Për shkak se njeriu është pjesë e një tërësie, ai nuk është i vetëm.

Megjithëse çdo qelizë në trupin e njeriut ndahet, qelizat nervore të cilat kanë një strukturë të veçantë, nuk ndahen. Mirëpo, me prodhimin e qelizave të reja nervore, ato arrijnë të bëjnë pjesë në rrjetin e fuqishëm të neuroneve. Kur rrjeti i neuroneve aktivizohet, formohen lidhje të reja. Aty ku aktivizohen qelizat nervore, rrjeti i neuroneve fuqizohet më shumë. Ndërsa detyrën e formimit të lidhjes së kryqëzimeve midis rrjeteve të neuroneve, e kanë përbërjet kimike.

Neuropeptidet si, serotonina, dopamina dhe neurodalinina, aktivizojnë me impulse rrjetet nervore që bartin ndjenja të ndryshme si, zemërimin, epshin, dashurinë ose urrejtjen.


Strukturën e rrjetit të trurit të njeriut dhe rrjetit të fuqishëm të neuroneve, mund t'i përngjasojmë me trafikun e një qyteti. Në atë lagje të qytetit ku bëhen investime, për shkak të kërkesës së lartë, ka më shumë zhvillim se në zonat e tjera. Edhe mendimet që prodhohen në trurin e njeriut, marrin formë sipas fushës sonë të interesit. Mendohet se në bazë të pasurisë së informacionit, një person prodhon mesatarisht 50 mijë deri në 100 mijë mendime në ditë. Në këtë mënyrë, rrjeti i neuroneve dhe i informacioneve të atij njeriu forcohen dhe formohen qarqe nervore. Tek personat me fiksime, përdoret gjithmonë e njëjta rrugë dhe nuk prodhohen qarqe nervore alternative. Kur qelizat nervore i nënshtrohen vazhdimisht bombardimit vetëm të një elementi kimik, prodhohen më shumë receptorë. Kjo gjendje është e domosdoshme për të plotësuar nevojat. Një shembull i mirë lidhur me këtë çështje, është varësia ndaj drogës. Nëse nuk arrihet të merret lëndë e drogës, trupi rri gjithmonë në pritje të asaj lënde të dëshiruar. Në të njëjtën mënyrë, edhe sjelljet dhe zakonet emocionale krijojnë varësi. Me qëllim që njeriu të kapë përsëri në trurin e tij emocionin që kërkon, ai vepron duke shfaqur sjellje të ndryshme.

Përdorimi i pilulave të drogës, në fakt mashtron qelizat nervore me kënaqësi të rreme.

TRURI PSIKON

Truri psikon, është emri që fizikanët kuantikë i kanë vënë trurit drejtues paralel i cili është ulur në kolltukun e shoferit të trurit tonë, i cili punon në formë kimike dhe elektro-fiziologjike. Mund të themi me siguri se përdorimi i emrit psikon për grimcën mbi fotonike nuk është i gabuar. Psikoni ka lidhje me tërheqjen e masës, më tepër se me tërheqjen elektromagnetike. Ky është një emër i propozuar për materien e ndërmjetme të quajtur "eter luminiferous", e cila siguron formimin e lidhjes së masave/materies me njëra-tjetrën në univers. Ndërsa thashethemet se kjo ka të bëjë me grimcat që nxjerrin në pah frekuencën dhe luhatjen, janë ende hipoteza.

Truri psikon, shpreh një mendje që nuk ka materie. Njësitë mendore që nuk janë materie, përbëhen



prej kodeve me frekuencë tredimensionale dhe përkufizohen si holografike. Fotonet e laserit sillen me ndjeshmëri ndaj njëra-tjetrës dhe mbajnë të njëjtin ritëm. Në këtë mënyrë eliminohet individualizmi dhe shtohet fuqia. Metoda e regjistrimit të imazheve holografike, përdoret edhe si etiketim. Në fakt, ajo që regjistrohet nuk është imazhi, por kodet e frekuencës. Përparimi i studimeve shkencore, na bën të mendojmë se së shpejti në vend të ekraneve, imazhet do të shfaqen në formë holografike tredimensionale.

TË KUPTOSH NJERIUN NËN DRITËN E FIZIKËS KUANTIKE

Memoria e vetëdijshme tek njeriu zë vend në komponentin hapësirë-kohë. Kjo lloj vetëdijeje, nuk është materie dhe nuk gjendet në tru, por është nën egon njerëzore. Ajo është një lloj aktivizimi shtytës elektromagnetik i llojit holografik, jashtë kohës dhe hapësirës.

Truri është pamja e jashtme në vitrinën e universit holografik. Psikoni, i cili nuk është i përbërë prej materies, stimulon nervin me anë të impulseve kuantike. Qëllimet dhe mendimet aktivizojnë psikonin, i cili me anë të dendronëve aktivizon qelizat e zgjedhura nervore. Për shembull, kur njeriu ka për qëllim të ngrëjë krahun, në mendjen e tij formohen një sërë mendimesh. Në momentin kur mendimet unifikohen, në qelizat nervore fillojnë të punojnë kanalet e joneve në varësi të voltazhit që marrin. Fizika klasike, nuk arrin ta shpjegojë “tërësinë” që është më e madhe se shumica e grimcave. Ndërsa fizika kuantike, ka për detyrë të prezantojë grimcat submaterie. Sub-materia ose anti-materia, formon një cilësi të bazuar në mekanikën kuantike.

Në sajë të qasjes kuantike, është bërë më i lehtë shpjegimi i “parandjenjës”. Ndërkohë që këto informacione të reja që janë në cilësinë e një revolucioni përpiqen të kuptojnë mendjen, elektrodinamika kuantike flet për një sistem që përfshin edhe njerëzit.

Truri njerëzor i ka të gjitha zgjedhjet alternative në një vend të vetëm. Kjo gjendje, mund të ndihmojë në shpjegimin se si formohet frymëzimi pas kërkimeve të gjata dhe të pasuksesshme. Për shkak se midis mendjes dhe materies nuk ka një ndarje të prerë, mendimi i përgjithshëm dhe inteligjenca kozmike, të cilën e quajmë dije, si rezultat i shpejtimit të funksionit të valëve gjatë përqendrimit shpirtëror dhe mendor, arrin arkivin e informacionit në sajë të kontaktit me një fluks universal që udhëton më shpejt se drita. Ky rezultat, është një manifestim i veçantë që tregon marrëdhënien e universit integral me aktivitetin nervor integral. Ndërkohë që zgjedhjet alternative të trurit gjenden të gjitha në një vend, ai vendos duke zgjedhur një prej stimuluesve që i përshtaten atij.

Sipas Herberit, kuantumi është si një kompani sigurimi. Llogaria totale është e qartë, por parashikimi individual është i vështirë. Edhe pse jetëgjatësia mesatare e njerëzve dihet, është e pamundur që një individ i t'i përcaktosh jetëgjatësinë. Pavarësisht prej mendimit dhe informacioneve të përgjithshme, cilësia e informacioneve që ndodhen në dosjen e një individ, të cilat janë arkivuar sipas zgjedhjeve të tij, bëhen definitive vetëm pas vdekjes. Në këtë pikë, vetëdija takohet në një fushë të përbashkët të filozofisë dhe fizikës. Realiteti i këtyre hipotezave mendore, të cilat mund të përkufizohen edhe si biopsikologji teorike, do të bëhen të qarta me kohën.



Mëshira e Muhamedit (a.s.) për krijesat e Zotit

Fjala “mëshirë” përmban mirësinë, dhembshurinë, dashurinë, miqësinë, lumturinë, përmirësimin, edukimin, udhëzimin etj. Allahu (xh.sh.), e filloi krijimin e gjithësisë me atë të mëshirës. Fjala e para që i tha njeriut ishte fjala “Mëshirë!” Librin e Tij që ia shpalli njerëzimit, e filloi me mëshirë. Të gjitha suret e Kuranit përveç sures Tevbe fillojnë me بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”

Emri i Zotit (xh.sh.), “Err-Rrahim në Kuranin famëlartë përmendet 114 herë, ndërsa emri “Err-Rrahman” përmendet 57 herë. (Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi. Viti, 2007, vëll, 34, f. 419.) Besimtari të paktën tridhjetë e katër herë në ditë, gjatë faljeve të detyruara, e përsërit këtë togfjalësh: “الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ”.

Njerëzimi, sidomos në ditët e sotme, ka nevojë të madhe për këtë cilësi madhështore që nxit në plotësimin e të drejtave të prindërve dhe të afërmve, në ndihmë të të dobtëve, jetimëve, si dhe në ruajtjen e të drejtave të çdokujt tjetër. Mëshira është cilësi e Allahut (xh.sh.), sepse mëshira e Tij i ka përfshirë të gjitha krijesat. **“Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe diturinë Tënde.”** (Gafır, 7)

Mëshira e përsos natyrën e njeriut dhe e bën atë të jetë i ndjeshëm ndaj dhimbjeve të krijesave. Aty ku ndodhet mëshira, ekziston paqja, respekti dhe marrëdhëniet e mira.

Shumë prej emrave të bukur të Allahut burojnë nga kuptimet e mëshirës, fisnikërisë, mirësisë faljes etj. Në një hadith kudsij thuhet: “Mëshira Ime e ka kaluar

hidhërimin Tim.” (Muslimi.) Në lidhje me hadithin e mësipërm, Ibnul Kajjimi thotë: “Mëshira është baza e emrave dhe cilësive të Allahut (xh.sh.). Kjo, për arsye se Allahu i Madhëruar është i Mëshirshëm dhe kjo është në natyrën e Tij, ashtu siç është dituria, fuqia, aftësia, dëgjimi, shikimi, mirësia etj.

Muslimani, i cili i kupton mësimet e Islamit, është i mëshirshëm, pasi ai e kupton se mëshira ndaj njerëzve në tokë do të bëjë që të zbresë mëshira e qiellit: **“Jini të mëshirshëm ndaj atyre që janë në tokë, që t’ju mëshirojë Ai që është në qiell.”** (Buhariu)

Muslimani ka mësuar nga kjo fe se: **“Kush nuk i mëshiron njerëzit, nuk do të mëshirohet nga Allahu.”** (Taberani.) **“Të mëshirshmeve do t’ju jepet mëshirë nga i Gjithëmëshirshmi.”** (Buhariu në el-Edeb el-Mufred.) **“Mëshira nuk largohet përveç nga njeriu fatkeq (i mjerë).”** (Tirmidhiu.)

Muslimani i vërtetë nuk e kufizon mëshirën e tij, vetëm ndaj familjes, fëmijëve dhe shokëve, por i mëshiron të gjithë njerëzit. Kjo është në pajtim me mësimet e të Dërguarit (a.s.), i cili përfshiu në mëshirën e tij të gjithë njerëzit dhe e bëri mëshirën kusht të besimit, siç transmeton Ebu Musa el-Esh’ariu (r.a.), nga i Dërguari (a.s.): **“Ju nuk keni besuar derisa të mos mëshironi njëri-tjetrin.”** Ata thanë: “O i Dërguar i Allahut, të gjithë ne jemi të mëshirshëm.” Ai tha: **“Nuk e kam fjalën për mëshirën tuaj ndaj shokut, mi-rëpo për mëshirën ndaj të gjithë njerëzve dhe mëshirën ndaj njerëzve të rëndomtë.”** (Taberani.)

I Dërguari (a.s.), ishte shembull i shkëlqyer i më-



shirës dhe i mishërimit të këtij virtyti aq shumë, saqë kur e udhëhiqte namazin, nëse e dëgjonte vajin e fëmijës, ai ndiente mëshirë ndaj nënës, e cila mund të shqetësohej nga të qarët e fëmijës. Kështu, ai e shkurtonte namazin, siç transmeton Enesi (r.a.): I Dërguari (a.s.), ka thënë: *“Vërtet unë ngrihem për namaz dhe dëshiroj të qëndroj gjatë në të, por kur dëgjoj vajin e fëmijës, e lehtësoj (shkurtoj) atë, duke mos pasur dëshirë që t’ia vështirësoj (punën) nënës së fëmijës.”*

(Buhariu dhe Muslimi.)

Ne duhet të jemi të mëshirshëm me fëmijët, dhe për këtë kemi shembull konkret të Dërguarin e Allahut, Muhamedin (a.s.). Transmetohet se: “Pejgamberi (a.s.), ishte duke i përqafuar nipat e tij të dashur, Hasanin dhe Husejnin, në prani të Akra Ibn Habis Et-Temimit.


El-Akra u çudit dhe i tha: “Unë kam dhjetë fëmijë, dhe asnjërin nuk e kam puthur asnjëherë!” Pejgamberi (a.s.), e shikoi dhe i tha: *“Ai i cili nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet.”* Kurse në një transmetim tjetër thuhet: *“Ç’të bëj me ty, në qoftë se Allahu e ka zhveshur zemrën tënde nga mëshira?”* (Buhariu dhe Muslimi.)

Omeri (r.a.), dëshironte ta caktonte një njeri në një pozitë, mirëpo e dëgjoi duke thënë diçka që e kishte thënë El-Akre ibn Habis, se nuk i puthte fëmijët e tij. Kështu Omeri e ndërroi mendjen dhe tha: “Nëse zemra jote nuk rrah me mëshirë ndaj fëmijëve

tuaj, si mendon të jesh i mëshirshëm ndaj njerëzve të tjerë?” Pasha Allahun, kurrë nuk do t’ju caktoj.” Pastaj e grisi kontratën, të cilën e kishte përgatitur për këtë njeri.

Muslimani është i mëshirshëm. Mëshira është pjesë e moralit të tij. Transmetohet se një herë, Zejnel Abidinin, të birin e Husejnit, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur ishte duke shkuar në xhami, e shau dikush. Shërbëtorët e tij u vërsulën të rrihnin ofenduesin, por ai, nga mëshira që ndjeu për atë njeri, i ndaloi. Pastaj i tha: “O njeri! Unë jam më i keq se ç’më the ti tani.

Ajo çka ti nuk di për mua është më e madhe se ajo që di, prandaj, nëse kërkon të dish më shumë, mjafton të më thuash!” Personi u turpërua kur dëgjoi këto fjalë, ndërsa Zejnel Abidini hoqi këmbishën e vet dhe ia fali atij, së bashku me një mijë derhemë. Kjo falje dhe bamirësi nuk ishin gjë tjetër, veçse shprehje e



mëshirës që ndodhej në zemrën e nipit të Profetit (a.s.). (Ebu Bekër el Xhezairi, "Minhaxh el Myslim" botimi i 2-të, Tiranë, 2006, f. 160.)

Mëshira islame ka vend dhe në luftë me armikun. Pejgamberi (a.s.), i këshillonte luftëtarët myslimanë para beteje, duke u thënë: *"O Myslimanë! Mos vrisni gratë e fëmijët, mos vrisni pleqtë. Në ato vende do të shihni murgjër, që adhurojnë Zotin sipas formës së tyre. Mos i prekni këta njerëz. Mos i digjni të mbjellat e tyre, mos i vrisni kafshët e tyre, mos i prisni pemët e tyre. Luftoni vetëm ata që ju luftojnë juve"*.

Pasi Zoti e shpërbleu profetin e tij me fitore në Bedër, myslimanët zunë shumë mekas robër. Robërit e kapur gjatë betejës së Bedrit ishin ndër armiqtë më të betuar të tij. Profeti Muhamed (a.s.), i shpërndau në shtëpitë e myslimanëve të cilët i porositi: *"I trajtoni mirë!"* Mes tyre ishte edhe Suhejl ibn Amr, një nga oratorët më të zjarrtë kundër Profetit (a.s.). Omer ibn Hattabi vajti tek Profeti (a.s.) dhe i tha: *"O i dërguar i Allahut! Më lejo t'ia shkul dhëmbët e parë Suhejlit. Kështu nuk do mund të të fyejë dhe ironizojë."* Suhejl njihej si orator dhe ironizonte myslimanët pa pushim. Profeti (a.s.), ia ktheu: *"Unë nuk gjymtoj. Përndryshe do më gjymtojë Zoti, edhe pse jam profet."* I tillë ishte profeti i mëshirës në sheshin e luftës.

Në momentet më të rënda, në luftën e Uhudit, kur idhujtarët u munduan ta vrisnin Pejgamberin (a.s.) dhe e detyruan atë të drejtohej drejt një kurthi, një grope të hapur. I rrethuar nga të gjithë anët me armiq Pejgamberi (a.s.), u plagos rëndë aq sa u dëmtua në fytyrën e bekuar që ia mbuloi gjaku dhe iu thyen dy dhëmbët e përparmë. Sahabët u zemëruan dhe i thanë: *"Lutu kundër tyre (idhujtarëve), o i Dërguar i Allahut"*, ndërsa ai iu përgjigj: *"Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por vetëm për mëshirë"*. Ai i ngriti duart nga qielli, dhe njerëzit që e panë duke vepruar ashtu menduan se Profeti do t'i mallkonte idhujtarët, ndërsa nga goja e tij e bekuar dolën fjalët: *"Zoti im! Fale, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë se ç'po veprojnë"*.

Banorët e Mekës përdorën të gjitha mënyrat për t'i shkaktuar vuajtje Profetit (a.s.), derisa përfundimisht e detyruan të emigronte në Medinë. Kur Ai hyri triumfues në Meke pas 23 vitesh, i fali të gjithë. Ai u tha: *"Shkoni se jeni të falur"*. (Bejhakui në Sunenul Kubra)

I Dërguari (a.s.), përveç mëshirës ndaj njerëzve, nxiti edhe për mëshirë ndaj kafshëve. Ebu Hurejra (r.a.), transmeton dhe thotë se i Dërguari (a.s.), ka thënë: *"Një njeri, duke udhëtuar e kishte lodhur etja e madhe, gjen një pus dhe zbret poshtë dhe shuan etjen. Kur del jashtë gjen një qen me gjuhë të nxjerrë jashtë, që hante dheun nga etja. Atëherë mendoi me vete: "Kjo krijesë ndihet e etur, ashtu siç ndihesha unë pak më parë." Atëherë zbret përsëri në pus, mbush këpucën e tij me ujë dhe ngjitet e ia jep qenit. Allahu për këtë e shpërbleu dhe ia fali gjynahet."* (Buhariu dhe Myslimi)


"Një grua u ndëshkua për shkak të një maceje. Ajo e mbylli atë derisa ngordhi nga uria. As nuk e ushqeu dhe as nuk e la të lirë të ushqehet vetë." (Buhariu dhe Myslimi)

Një herë një njeri ia kishte marrë vezën një zogu. Ai (a.s.), tha: *"Kush e ka shqetësuar atë duke ia marrë vezën?"* Njeriu i tha: *"O i Dërguar i Allahut, unë e kam marrë atë."* I Dërguari (a.s.), i tha: *"Ktheja nga mëshira ndaj saj."* (Buhariu në el-Edeb el-Mufred) Pejgamberi (a.s.), dëshiroi në këtë rast, të nguliste një ndjenjë të mëshirës gjithëpërfshirëse në ndërgjegjen e myslimanit, kështu që ata të bëhen të mëshirshëm nga natyra, madje edhe ndaj kafshëve, pasi kush ka zemër të mëshirshme ndaj kafshëve, nuk do të jetë i vrazhdë ndaj vëllait të tij.

Gjatë kthimit nga një fushatë ushtarake disa nga shokët e Profetit morën disa zogj nga një fole dhe filluan t'i përkëdhelnin. Pasi nëna e tyre u kthye dhe nuk i gjeti në fole, filloi të fluturonte përreth duke i kërkuar. Sapo dëgjoji për këtë, Profeti (a.s.), u nervozua dhe urdhëroi që zogjtë të ktheheshin në folenë e tyre. (Ebu Davudi)

Historianët thonë se kur Amr Ibnul As hyri në Egjipt, një pëllumb vendosi folenë në tendën e tij. Kur erdhi koha për t'u larguar, atij i erdhi keq t'ia prishte pëllumbit folenë dhe kështu nuk e prishi tendën. Ndaj dhe tenda nuk u prish, përkundrazi vendi filloi të popullohej dhe në këtë mënyrë lindi qyteti Fustat. (Dr. Jusuf Kardavi, "Besimi dhe jeta" Furkan 2010, f. 290-291)

Kur mëshira përhapet në tokë, nga qielli zbret mëshira hyjnore. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Mëshironi ata që janë në tokë, që t'ju mëshirojë Ai që është në qiell."* (Taberani)



UNIVERSET PARALELE DHE TEORIA E FIJEVE

— ❧ *Elsad Cukali* ❧ —

Përpiquni të fokusoni shikimin tuaj drejt një zone të caktuar në qiellin e pastër gjatë natës. A e dini se në atë moment keni drejtuar shikimin tuaj drejt miliona galaksive?

Universi është i stërmadh. Në të njëjtën kohë është i bukur dhe i mbushur plot e përplot me mistere që shumica akoma edhe në ditët e sotme nuk janë shpjeguar dot. Shpesh dëgjohet të flitet për universet paralele, por fillimisht le të përpiqemi të kuptojmë strukturën e universit tonë, pastaj ta lidhim atë me universet e tjera. Ne gjendemi në një hapësirë tredimensionale dhe një dimension shtesë që është koha. Disa përfundime matematikore sugjerojnë se në të vërtetë ne jetojmë në një univers njëmbëdhjetë dimensional, por në fakt vetëm katër prej tyre mund t'i perceptojmë, ndërsa shtatë dimensione të tjera janë të paperceptueshme nga ne, ndoshta për faktin se kemi mungesë shqisash t'i perceptojmë. Është e çuditshme sesi në dimensionin e kohës kemi mundësi të lëvizim vetëm në një drejtim, në krahasim me tre dimensionet e tjera. Arsyeja ka të bëjë me entropinë e universit ose siç quhet ndryshe “çrregullsia”. Nëse koha do lëvizte në drejtimin e kundërt do kishim ulje të “çrregullsisë” së universit, gjë e cila bie ndesh me ato çfarë vërejmë në jetën tonë të përditshme.

Hapësira dhe koha formojnë një strukturë katër-dimensionale, që quhet hapësirë-kohë. Në këtë ha-

pësirë ndodhen planetë, satelitë natyrorë, kometa, asteroide që sillen rreth yjeve të tyre përkatëse, dhe miliarda e miliarda yje grupohen në grupe të mëdha që quhen galaksi. Galaksitë grupohen në grupe edhe më të mëdha që quhen grumbuj galaksish, dhe këto grumbuj grupohen në grumbuj edhe më të mëdhenj, që quhen supergrumbuj galaksish. Kjo është gjithë struktura e materies së dukshme, por në fakt vërehet eksperimentalisht se e gjithë lënda e dukshme përbën vetëm 4% të të gjithë universit. Afërsisht 96% e materies në univers akoma nuk dihet se çfarë është, pasi nuk duket por vetëm ndihet efekti i saj gravitacional. Në vitin 1929 astronauti Edwin Hubble provoi se ne jetojmë në një univers që po zgjerohet. Kur flitet për fjalën zgjerim, nuk flitet se po zgjerohet distanca midis syve tuaj që po lexoni këtë tekst dhe vetë tekstit, por bëhet fjalë për galaksitë që po largohen nga njëra-tjetra. Të gjitha galaksitë po largohen nga njëra-tjetra me përjashtim të ndonjë galaksie si për shembull galaksia “Rruga e qumështit” e cila po i afrohet galaksisë Andromeda, dhe llogaritjet tregojnë se pas afërsisht katër miliardë vitesh të dy galaksitë do bashkohen në një të vetme. Ajo çfarë është më e çuditshme është fakti se universi ynë nuk ka ndonjë qendër, kudo që të shkosh në univers, ai është i njëjtë dhe të gjitha galaksitë largohen prej njëra-tjetrës. Kjo i ka bërë shkencëtarët të arrijnë në



përfundimin se universi ynë është i sheshtë dhe jo një sferë. Ky përfundim është vërtetuar edhe eksperimentalisht nga dy eksperimente, ku më i famshmi është ai i mbetjeve të rrezatimit kozmik që nga koha e Big Bang-ut. Fakti që temperatura në univers është kudo e njëjtë -270.45 °C tregon se universi është i sheshtë, dhe po të ishte i përkulur temperatura e universit nuk do ishte kudo e njëjtë.

Zgjerimi i universit i ka bërë shkencëtarët të propozojnë një teori e cila mundëson ekzistencën e universeve paralele, të cilat janë të panumërta. Si princip, çdo gjë që është fizikisht e mundshme mund të ndodhë në disa universe të tjera paralele me ne. Në një univers ju jeni president i Shteteve të Bashkuara, në një univers tjetër doktor e në një tjetër i papunë e kështu me radhë.

Të gjithë kozmologët janë të një mendimi se ajo çfarë ne shohim, në të vërtetë nuk është ajo çfarë është. Universet paralele janë të grupuara në katër nivele.

NIVELI I PARË I UNIVERSEVE PARALELE:

Është i pafund në përmasa dhe është grupi i universeve ku ndodhet universi ynë. Në këtë grup futen universet në të cilat ligjet e fizikës janë të njëjta me universin tonë. Teknikisht janë shumë metoda matematikore në të cilën universi mund të kuptohet si i pafund. Ai mund të jetë i pafund në përmasa por të mos harrojmë se akoma nuk përmendim një term që përdoret në kozmologji, përkulshmëria. Hapësira është lehtësisht e përkulshme, gjë të cilën do e shpjegojmë në serinë e ardhshme. Kjo hapësirë është e përkulur në vetveten e saj duke formuar një sferë katërdimensionale që quhet hipersferë. Për ta kuptuar këtë le ta demonstrojmë me një shembull. Të gjithë e dimë se toka është e rrumbullakët dhe e shtypur në pole. Mirëpo, në një fushë të gjerë neve na duket toka e sheshtë dhe sado të ecim kurrë nuk mundemi ta vërejmë se jemi duke ecur në një hapësirë të sheshtë dhe madje pasi t'i sillemi njëherë tokës, do arrijmë prapë aty ku ishim, duke mos arritur asnjëherë në ndonjë skaj. Ky është një shembull sesi universi është i sheshtë kudo dhe infinit. Të gjitha universet e këtij niveli janë aq larg nga njëri-tjetri, saqë është e pamundur të marrim ndonjë informacion prej tyre.

NIVELI I DYTË I UNIVERSEVE PARALELE:

Janë universet që ndodhen në të njëjtën hipersferë më ato të nivelit të parë në të cilat mund të ketë ligje të përbashkëta me universet e nivelit të parë, por konstante të tjera të ekuacioneve të këtyre ligjeve, pse jo edhe grimca dhe dimensione të ndryshme. Ajo çfarë e ndan nivelin e dytë nga ai i pari është vetëm struktura hapësirë-kohë, pra distanca nga niveli i parë, gjithmonë me kusht që të jenë në të njëjtën hipersferë.

NIVELI I TRETË I UNIVERSEVE PARALELE:

Ky nivel është kudo i pranishëm rreth nesh. Është në hapësirën dhe kohën tonë, por në dimensione të tjera, të cilat ne nuk mund t'i perceptojmë dot, pasi nuk kemi dot shqisa të mjaftueshme për këtë qëllim. Një prej rezultateve të fizikës kuantike është se elektroni mundet që në të njëjtën kohë të jetë në pozicione të ndryshme. Është njëllor si të ishit në këtë moment edhe duke lexuar këtë artikull, edhe duke shëtitur diku në park, edhe këtu edhe atje...

Duke u bazuar në këtë rezultat konkludojmë se ka mundësi që ne në një dimension jemi duke parë televizor në një dimension tjetër jemi duke luajtur futboll e ndërsa në një dimension tjetër jemi duke ecur rrugës. Vlen të theksohet se po flitet për të njëjtin person, por që mund të gjendet në pozicione ose në dimensione të ndryshme në të njëjtën kohë.

NIVELI I KATËRT I UNIVERSEVE PARALELE:

Në këtë nivel ndodhet grupi i universeve në të cilat ligjet e fizikës janë totalisht ndryshe nga ato që jemi mësuar ne. Ajo çfarë është e mundur matematikisht aplikohet fizikisht në këto grupe universesh. Në këtë nivel kemi të bëjmë me një lëndë të paperceptueshme nga ne si dhe ligje fizike të cilat nuk kanë asnjë lidhje me ligjet e natyrës që ndodhen në tre nivelet e tjera të sipërpërmendura.

TEORIA E FIJEVE

Një problem që vazhdon të qëndrojë edhe në ditët e sotme është fakti se formulat dhe ligjet që ekzistojnë në botën makroskopike, ligjet të cilat janë në strukturat kozmike janë krejtësisht të ndryshme nga ligjet dhe formulat që përdoren në botën atomike. Kjo i ka bërë fizikanët teorikë të gjejnë një sistem ligjesh dhe formulash të përbashkëta, pra të unifikojnë botën



makroskopike me atë mikroskopike, në një teori që quhet teoria e gjithçkasë.

Një teori që jep shpresa për arritjen e këtij qëllimi është “Teoria e fijeve” që u propozua diku nga vitet 1980. Lënda e dukshme përbëhet nga atomet, atomet nga protonet, elektronet dhe neutronet. Protonet përbëhen nga kuarket dhe të gjitha këto përbëhen edhe nga blloqe ndërtuese më të vogla që quhen fije. E gjithë logjika qëndron në bllokun ndërtues të çdo grimce, fijeve. Këto janë fije energjetike të cilat vibrojnë, pra universi dhe gjithçka na rrethon është një harmoni muzikore vibruese. Secila grimcë si elektronet, fotonet, kuarket (përbërëse të protoneve) etj., përbëhen nga këto fije. Ashtu siç prodhohen tinguj të ndryshëm nga telat e një violine nga mënyra se si vibrojnë, ashtu çdo grimcë fiton karakteristikat e saj nga mënyra se si vibrojnë këto fije. Karakteristikat e grimcave janë: ngarkesa elektrike, masa, spini (veti e brendshme e çdo grime) etj.

Këto fije janë aq të vogla, saqë ne nuk mund t'i shohim kurrë. Në mënyrë që matematika e kësaj teorie të funksionojë, kërkohet që universi ynë të ketë dimensione ekstra. Vallë ku janë këto dimensione ekstra? Për të pasur një ide mbi dimensionet ekstra le të marrim një shembull. Imagjinojmë se ndodhemi në një anije mbi sipërfaqen e një oqeani. E gjithë hapësira e oqeanit na duket dy dimensionale, mirëpo dimension i tretë, që është thellësia është i padukshëm nga ne dhe në fakt në këtë dimension ndodhet një botë e pasur me peshq dhe kafshë të ndryshme detare të cilat as që i dimë se ekzistojnë. E njëjta situatë ndodh dhe me dimensionet shtesë.

Më pas kanë dalë versione të ndryshme të kësaj teorie si teoria e superfijeve, teoria e supergravitetit etj., por në vitin 1995, vitin kur kam lindur unë, Edward Witten unifikoi të gjitha versionet e teorisë së superfijeve në një teori që sot quhet M-theory që shumica e fizikanëve mendojnë se është shkurtim i fjalës Membrane-theory. Thelbi i kësaj teorie qëndron në faktin se universet paralele janë pjesë e membranave, që janë paralele me njëra tjetrën. Secili univers mendohet si një flluskë, e zhytur në këto membrana. Në momentin kur këto membrana takohen me njëra tjetrën, një shpërthim gjigand ndodh, Big Bang. Në këtë mënyrë lindin flluska të reja, universe të reja ku energjia që merret nga membrana kthehet në materie dhe masë sipas ekuacionit të famshëm të Ajnshtajnit $E=mc^2$. Në këtë teori, ne jemi në gjendje

të kuptojmë se universi ynë nuk është i vetëm dhe se tashmë e kemi pak idenë se çfarë kishte përpara Big Bang. Mirëpo, akoma nuk e di kush se çfarë ndodhi në momentin e Big Bang pasi të gjitha ligjet e fizikës që njohim thyhen në atë moment.

Sidoqoftë, teoritë e sotme kanë nevojë për përmirësime dhe pse jo, edhe nga fakte eksperimentale, sepse vetëm faktet matematikore mund edhe të na e shpjegojnë universin jo në mënyrën sesi në të vërtetë është.

KURIOZITETE NGA FIZIKA MODERNE

Çdo ligj në univers është i tillë që ka ndikim thelbësor në jetën e gjithsecilit prej nesh. Sot fizika moderne na ka bërë të kuptojmë disa fakte që dikur njerëzve u dukeshin të parëndësishme.

- Duke marrë parasysh distancën Tokë-Diell jeta në Tokë do ishte e pamundur nëse masa e Diellit do ishte jashtë këtij intervali 1.6×10^{30} - 2.4×10^{30} kg

- Në qoftë se forca magnetike do ishte vetëm 4% më e dobët nga çfarë është tani, Dielli do kishte shpërthyer menjëherë.

- Në qoftë se forca magnetike do ishte pak më e fortë, atëherë nuk do ishin formuar atomet që ndërtojnë materien që njohim ne.

- Në qoftë se forca bërthamore e tipit të dobët do ishte sadopak më e vogël, atëherë nuk do gjendej fare Hidrogjen në univers, pasi do ishte shndërruar në Helium menjëherë pas Big Bang.

- Në qoftë se protonet do ishin 0.2% më të rënda sesa janë aktualisht, atëherë ato do ishin transformuar në neutrone dhe nuk do ekzistonin atomet.

- Raporti i masës së protonit me atë të elektronit është një konstante speciale me vlerën 1836.152.

Në qoftë se ky raport do kishte vlerë më të vogël, nuk do kishim yje të qëndrueshme dhe me jetë të gjatë në kozmos, dhe në qoftë se do kishte vlerë më të madhe nuk do mundeshin të formohen kristalet e rregullta të lëndës, madje nuk do ekzistonte as ADN-ja. Për pasojë nuk do kishim ekzistuar as ne.

PËRFUNDIM:

Nga gjithë këto kuriozitete që citova më sipër, nuk ka mundësi që kjo zgjedhje speciale e vlerave të disa konstanteve të disa ligjeve të natyrës të jenë zgjedhur rastësisht.



AKTIVITETI FIZIK, KYÇI I SUKSESIT PËR TË QENË I SHËNDETSHËM

Sa më shumë të reja zbulon shkencë për të jetuarit shëndetshëm, aq më shumë forcohet ideja se të jesh në formë, mendërisht e fizikisht, duhet të lëvizësh sa më shumë. Çka mund të jetë e vështirë në këto kohë kur shumë njerëz janë të detyruar të rrinë ulur në tryezën e punës gjatë gjithë ditës. Sipas një studimi të kohëve të fundit, edhe nëse qëndron në karrige për një kohë të gjatë, pak orë ecje në javë do të mjaftonin për të qëndruar në formë.

Shumë të punësuar në kohët e sotshme kalojnë një kohë të gjatë ulur. Ullur gjatë rrugës për në punë, pastaj gjatë vetë orarit të punës, pastaj kur kthehen në shtëpi, përsëri ulen... përpara televizorit..Nuk ka pra asnjë dyshim se gjithë kjo kohë ulur sjell pasoja negative në shëndet.

Por një studim i fundit nga shkencëtarë në Britaninë e Madhe dhe Australi ka bërë disa zbulime interesante. Pikë së pari, jo të gjitha mënyrat e të qëndruarit ulur sjellin të njëjtat pasoja. Emmanuel Stamatakis shkencëtar në Universitetin e Sidneit thotë:

“Ajo çka jemi duke bërë teksa jemi ulur është e rëndësishme për studimin, sepse njerëzit thuajse kurrë nuk rrinë thjesht ulur, por janë duke bërë diçka tjetër në të njëjtën kohë. Ulen për të punuar, për të parë televizor, për t'i dhënë makinës dhe deri në njëfarë pike, ndikimi që ka të qëndruarit ulur te shëndeti varet edhe nga ajo çka jemi duke bërë paralelisht.”

Për shumë kohë është menduar se ka një lidhje

midis të qëndruarit ulur, pa u marrë me asgjë tjetër, dhe diabetit të tipit 2 apo kancerit. Por këto studime tregojnë se të qenit i shëndetshëm ka më tepër lidhje me atë që bën pas një dite të gjatë ulur në karrige.

“Stili i të jetuarit ka shumë elemente, nuk është vetëm “të qëndruarit ulur”. Për ata që merrem me aktivitet fizik madje, ky është ndoshta një detaj i dorës së dytë. Por nuk duhet të harrojmë se realiteti dëshmon se jo shumë njerëz janë fizikisht aktivë. Pjesa dërrmuese ushtrohet pak dhe është pak aktive.”

Studimi doli në përfundimin se qoftë edhe pak minuta ushtrime në javë veprojnë si kundërpeshë ndaj të qëndruarit ulur gjithë ditën.

“Duhet të theksojmë se ata që morën pjesë në këtë studim ishin punonjës zyre shumë aktivë fizikisht, që bënë afërsisht 45 minuta ecje në ditë. Kjo është shumë dhe ndoshta është pikërisht ky nivel i lartë aktiviteti fizik që i ka mbrojtur ata nga diabeti. Në këto raste, të qëndruarit ulur për shumë kohë nuk përbën më një problem shqetësues.”

Grupi i shkencëtarëve doli pra në përfundimin se të ndenjurit ulur nuk është problemi i vërtetë, por është mungesa e aktivitetit fizik ajo që vret përafërsisht pesë milionë njerëz në vit. Ndaj, nëse do që të mbrosh shëndetin, sigurohu të lëvizësh në ato momente kur nuk je i detyruar të rrish ulur.



QEPËT E NJOMA



Qepët e njoma nuk duhet të mungojnë në tryezë, sidomos kur ato janë të stinës. Këto perime jo vetëm që i japin ushqimeve shumë shije, por janë të mbushura me vitamina dhe minerale. Qepët e njoma janë tepër efektive kundër të ftohtit, dhimbjeve të kokës, ndihmojnë tretjen dhe luftojnë pagjumësinë. Kokrra e bardhë e qepës së njomë dhe bishtat e saj të gjelbër kanë shumë veti mirëbërëse. Si mund ta përdorni qepën e njomë sidomos gjatë pranverës nëse keni fytyrë të acaruar, copëtoni qepën vendoseni në një copë pambuku dhe vendoseni mbi një tenxhere me ujë të nxehtë duke e kthyer atë në një kompresë të ngrohtë. Vendoseni kompresën në qafë, në kraharor, shpatull apo nën sqetull, në varësi të shqetësimit. Në mënyrë të tillë, kompresja do të përshpejtojë djersën, do të ulë temperaturën dhe dhimbjen. Nëse keni rrufë, shtypni dhe shtrydhni qepën e njomë. Nëse keni këmbët e fryra, zieni qepët e njoma për disa minuta. Më pas përziejini me ujë deri sa të bëhen një masë e qullët të cilën mund ta vendosni në pjesën e fryrë të këmbës. Për më tepër, nëse nuk arrini të flini dot vendosni qepë të njoma poshtë jastëkut dhe do të bëni një gjumë të qetë. Qepën e njomë mund ta përdorni edhe për të eliminuar aromën e padëshiruar të peshkut dhe mishit. Një njeri i shëndetshëm duhet të konsumojë të paktën 100-150 gramë qepë të njoma çdo ditë. - Qepa e njomë stimulon frymëmarrjen dhe pastron rrugët e frymëmarrjes - Përmban vajra esenciale që stimulojnë gjëndrat e djersës dhe si rrjedhojë shkaktojnë djersitje - Normalizon tensionin e gjakut - Rrit oreksin - Ul kolesterolin dhe rrezikun e disa sëmundjeve të kancerit - Lufton infeksionet dhe bakteret! Qepët e njoma përmbajnë shumë pak kalori. Sipas të dhënave 100 gramë qepë të njoma përmbajnë 31 kalori. Qepët e njoma janë të pasura

me antioksidantë. Këta të fundit janë elementë që luftojnë sëmundjet dhe largojnë toksinat nga trupi. Organizmi ka nevojë për antioksidantë që të ulen shanset e kapjes së ndonjë sëmundje, përfshirë ato që konsiderohen të rrezikshme. Qepët e njoma kanë nivel të lartë fibrash. Nëse do të mjaftoheshim me këtë fjali do ta nënvlerësonim këtë perime. Kjo për faktin se qepët e njoma kanë më shumë fibër se simotrat e saj të stinëve të tjera. Në 100 gramë qepë gjenden 2.6 gramë fibër që është e barazvlefshme me 7% të dozës ditore të fibrave të nevojshme. Qepët e njoma ulin kolesterolin dhe shkaktojnë një reagim enzimash që ulin prodhimin e kolesterolit veçanërisht në qelizat e mëlçisë. Alicina tek qepët e njoma arrin të zhblllokojë qelizat e gjakut. Kjo substancë kimike arrin të ulë tensionin e gjakut duke zhbllokuar enët e gjakut të cilat mund të shkaktojnë shumë probleme. Duke bërë këtë qepa e njomë është e rëndësishme në luftën kundër sëmundjeve koronare, ataku në zemër etj. Qepët e njoma janë të pasura me vitaminë A. Në 100 gramë qepë të njoma do të merrni 33% të dozës ditore të rekomanduara të vitaminës A. Qepët e njoma kanë edhe flavonoidë që shërbejnë si antioksidantë. Këto flavonoidë arrijnë të mbrojnë trupin ndaj problemeve të gojës dhe të mushkërive. Qepët e njoma kanë plot vitamina të tjera. Përveç vitaminës A, qepa e njomë ka edhe vitaminë C dhe K. Kërkimet e AgroEeb.org tregojnë që qepët e njoma janë perimet më të pasura me vitaminë K. Në 100 gram qepë të njoma mund të merrni 172% të dozës ditore të rekomanduara të vitaminës K. Kjo vitaminë është e rëndësishme për të garantuar shëndetin e kockave. Qepët e njoma mund t'i ruani në frigorifer për më shumë se një javë, nëse i ruani të palara dhe të mbështjella në një copë gazetë. Kujdesuni që qepa e blerë të jetë me kokë të bardhë dhe gjethe të gjelbra të ndezura e të drejta.



Nga morali shembullor
I TË DASHURVE TË
ALLAHUT

1-2



Arbëria Design



Të gjitha në një vend!

- Studio dizajni
- Shtypshkronjë
- Shtyp - sitë (screen printing)
- Shtypi në format të madh PVC • Tekstil • Billboard
- Reklama ndriçuese
- Organizimi i fushatave promovuese
- PR dhe Marketing

TETOVË - R. e Maqedonisë
Tel. +389 44 35 33 70
www.arberiadesign.com



N.T.P. MAHMUT-HOLDING

Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux
SPECIALIST IN PAINT
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR



NGJYRNA - LLAQE - PJESE TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN
BOYA - VERNIK - MOBILYA AKSESUARI VE MEDIJAPAN

Lagja Arbanë, Prizren-Kosovë
europancolor@hotmail.com

Tasim Taç - Mob :00377 44 339 452
Bayram Taç - Mob :00377 44 390 538
Fax :00381 29 247 405
Turk/Mob :0531 082 1583



Akfix

kastamonu

METAX

motorfan

DENLAKS
artenova

CAGBERK GROUP

HTS **ISIK**

KALE
SUNTA VIDASI

samet

kale
COLOR

KAPSAN

mitreapel

MEPA

yapaş

STRAX



Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



Emel 7303

Wooden frame & fabric set



Armchair	W: 102 cm	D: 90 cm	H: 107 cm
Three Seater	W: 230 cm	D: 90 cm	H: 110 cm
Coffee Table	W: 102 cm	D: 102 cm	H: 51 cm

Mobileria Elif 19



Ruglan

EXCELLENT plus

7327



Ruglan 7327

Wooden frame & fabric set



Armchair	W: 102 cm	D: 90 cm	H: 107 cm
Three Seater	W: 230 cm	D: 90 cm	H: 110 cm
Coffee Table	W: 102 cm	D: 102 cm	H: 51 cm



EXCELLENT plus

Emel

Wooden frame & fabric set


7303





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orndive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëpllaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

Mirësia
nuk është të drejtuarit
nga lindja e perëndimi,
por është besimi në
Allahun, Ditën e Fundit,
engjëjt, Librin
dhe profetët.
Dhënia me vullnet
nga pasuria për
të afërmit, jetimët,
të varfrit, udhëtarët
e mbetur rrugës,
lypësit dhe për lirim
e të robëruarve.
Falja e namazit,
dhënia e zeqatit,
plotësimi i premtimeve,
durimi në kohë
skamjeje, sëmundjeje
dhe lufte.
Pikërisht këto cilësi
janë të besimtarëve
të singertë dhe
të devotshëm.

(Bekare, 177)

